


KOMPETENCA THEMELORE PROFESIONALE

dhe

STANDARDE PËR BASHKËPUNËTORË PROFESIONAL



**KOMPETENCA
THEMELORE
PROFESIONALE**

dhe

**STANDARDE PËR
BASHKËPUNËTORË
PROFESIONAL**



Projekt për Zhvillim Profesional
dhe në Karrierë të Arsimitarëve



Botimi është përpiluar me mbështetje eksperte dhe financiare të Projektit të USAID-it për Zhvillim Profesional dhe në Karrierë të Arsimitarëve, i realizuar nga Qendra Maqedonase për Edukim Qytetar (QMEQ) në bashkëpunim me Byronë e Zhvillimit të Arsimit (BZHA).

Botimi është përpiluar nga grupi i punës i përbërë prej përfaqësuesve të: Byrosë për Zhvillimin e Arsimit, Qendrës për Edukim Profesional dhe Trajnim, fakulteteve, ekspertëve për arsimim, si dhe bashkëpunëtorë profesional dhe praktikues në shkollat fillore dhe të mesme në Republikën e Maqedonisë. Si partner i projektit është përfshirë edhe *Fondacioni për nisma arsimore dhe kulturore "Hap pas hapi"*.

Përmbajtja e dokumentit nuk i reflekton qëndrimet e Agjencisë së SHBA-ve për Zhvillim Ndërkombëtar ose të Qeverisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës.

Titulli

KOMPETENCA THEMELORE PROFESIONALE DHE STANDARDE PËR BASHKËPUNËTORË PROFESIONAL

Botues

Qendra Maqedonase për Edukim Qytetar (QMEQ)

Përkthimi

Enis Misini

Dizajn

KOMA

Shtypshkronja

Vinsent grafika

Tirazhi

630

CIP - Каталогизација во публикација

Национална и универзитетска библиотека «Св. Климент Охридски», Скопје

371.121:005.962.131

KOMPETENCA themelore profesionale dhe standarde për bashkëpunëtorë profesional / [përkthimi Enis Misini]. - Shkup : Qendra maqedonase për edukim qytetar (QMEQ), 2016. - 234 стр. : илустр. ; 30 см

Фусноти кон текстот

ISBN 978-608-4529-39-2

а) Стручни соработници - Компетентност

COBISS.MK-ID 101307146

PËRMBAJTJE

PARATHËNIE	7
Pikënisje themelore	8
Vlera profesionale	11



KOMPETENCA THEMELORE PROFESIONALE PËR BASHKËPUNËTORË PROFESIONAL	15
---	-----------

KOMPETENCA TË PËRBASHKËTA PËR BASHKËPUNËTORË PROFESIONAL.... 17

I. PUNË ME NXËNËS.....	17
II. PUNË ME ARSIMITARË	21
III. PUNË ME PRINDËR	27
IV. BASHKËPUNIM ME BASHKËSINË	31
V. ZHVILLIM PROFESIONAL DHE BASHKËPUNIM PROFESIONAL.....	35
VI. PUNË ANALITIKE-HULUMTUESE.....	39
VII.STRUKTURË, ORGANIZIM DHE KLIMË SHKOLLORE	43

KOMPETENCA SPECIFIKE PËR PEDAGOG..... 49

I. PUNË ME NXËNËS.....	49
II. PUNË ME ARSIMITARË	52
III. PUNË ME PRINDËR	55
IV. BASHKËPUNIM ME BASHKËSINË	56
V. ZHVILLIM PROFESIONAL DHE BASHKËPUNIM PROFESIONAL.....	57
VI. PUNË ANALITIKE-HULUMTUESE.....	58
VII.STRUKTURË, ORGANIZIM DHE KLIMË SHKOLLORE	59

KOMPETENCA SPECIFIKE PËR PSIKOLOG..... 61

I. PUNË ME NXËNËS.....	61
II. PUNË ME ARSIMITARË	65
III. PUNË ME PRINDËR	67
IV. BASHKËPUNIM ME BASHKËSINË	69
V. ZHVILLIM PROFESIONAL DHE BASHKËPUNIM PROFESIONAL.....	70
VI. PUNË ANALITIKE-HULUMTUESE.....	71
VII.STRUKTURË, ORGANIZIM DHE KLIMË SHKOLLORE	72

KOMPETENCA SPECIFIKE PËR SOCIOLOG 75

I. PUNË ME NXËNËS.....	75
II. PUNË ME ARSIMTARË	78
III. PUNË ME PRINDËR	79
IV. BASHKËPUNIM ME BASHKËSINË	81
V. ZHVILLIM PROFESIONAL DHE BASHKËPUNIM PROFESIONAL.....	82
VI. PUNË ANALITIKE-HULUMTUESE.....	83
VII.STRUKTURË, ORGANIZIM DHE KLIMË SHKOLLORE	84

KOMPETENCA SPECIFIKE PËR PUNËTOR SOCIAL 87

I. PUNË ME NXËNËS.....	87
II. PUNË ME ARSIMTARË	91
III. PUNË ME PRINDËR	93
IV. BASHKËPUNIM ME BASHKËSINË	95
VI. PUNË ANALITIKE-HULUMTUESE.....	97
VII.STRUKTURË, ORGANIZIM DHE KLIMË SHKOLLORE	98

KOMPETENCA SPECIFIKE PËR DEFEKTOLOG 101

I. PUNË ME NXËNËS.....	101
II. PUNË ME ARSIMTARË	104
III. PUNË ME PRINDËR	106
IV. BASHKËPUNIM ME BASHKËSINË	107
V. ZHVILLIM PROFESIONAL DHE BASHKËPUNIM PROFESIONAL.....	108
VI. PUNË ANALITIKE-HULUMTUESE.....	109
VII.STRUKTURË, ORGANIZIM DHE KLIMË SHKOLLORE	110

KOMPETENCA SPECIFIKE PËR BIBLIOTEKIST 113

I. PUNË ME NXËNËS.....	113
II. PUNË ME ARSIMTARË	117
III. PUNË ME PRINDËR	119
IV. BASHKËPUNIM ME BASHKËSINË	120
V. ZHVILLIM PROFESIONAL DHE BASHKËPUNIM PROFESIONAL.....	121
VII.STRUKTURË, ORGANIZIM DHE KLIMË SHKOLLORE	123



STANDARDE PROFESIONALE PËR BASHKËPUNËTOR PROFESIONAL - MENTOR.....127

KOMPETENCA TË PËRBASHKËTA PËR BASHKËPUNËTOR PROFESIONAL - MENTOR..... 129

PIKËNISJE THEMELORE	129
I. PUNË ME NXËNËS.....	131
II. PUNË ME ARSIMTARË	135
III. PUNË ME PRINDËR	139
IV. BASHKËPUNIM ME BASHKËSINË	143
V. ZHVILLIM PROFESIONAL DHE BASHKËPUNIM PROFESIONAL.....	145
VI. PUNË ANALITIKE-HULUMTUESE.....	149
VII.STRUKTURË, ORGANIZIM DHE KLIMË SHKOLLORE	151

KOMPETENCA SPECIFIKE PËR BASHKËPUNËTOR PROFESIONAL-MENTOR PEDAGOG..... 155

KOMPETENCA SPECIFIKE PËR BASHKËPUNËTOR PROFESIONAL-MENTOR PSIKOLOG 157

KOMPETENCA SPECIFIKE PËR BASHKËPUNËTOR PROFESIONAL-MENTOR SOCIOLOG 161

KOMPETENCA SPECIFIKE PËR BASHKËPUNËTOR PROFESIONAL-MENTOR DEFEKTOLOG..... 163

KOMPETENCA SPECIFIKE PËR BASHKËPUNËTOR PROFESIONAL-MENTOR BIBLIOTEKIST..... 167



STANDARDE PROFESIONALE PËR BASHKËPUNËTOR PROFESIONAL-KËSHILLTAR.....175

KOMPETENCA TË PËRBASHKËTA PËR BASHKËPUNËTOR PROFESIONAL-KËSHILLTAR..... 177

PIKËNISJE THEMELORE	177
I. PUNË ME NXËNËS.....	179
II. PUNË ME ARSIMTARË	183
III. PUNË ME PRINDËR	185

IV. BASHKËPUNIM ME BASHKËSINË	187
V. ZHVILLIM PROFESIONAL DHE BASHKËPUNIM PROFESIONAL.....	189
VI. PUNË ANALITIKE-HULUMTUESE.....	193
VII.STRUKTURË, ORGANIZIM DHE KLIMË SHKOLLORE	195

KOMPETENCA SPECIFIKE PËR BASHKËPUNËTOR PROFESIONAL-KËSHILLTAR PEDAGOG	199
--	------------

KOMPETENCA SPECIFIKE PËR BASHKËPUNËTOR PROFESIONAL-KËSHILLTAR PSIKOLOG	201
---	------------

KOMPETENCA SPECIFIKE PËR BASHKËPUNËTOR PROFESIONAL-KËSHILLTAR SOCIOLOG	205
---	------------

KOMPETENCA SPECIFIKE PËR BASHKËPUNËTOR PROFESIONAL-KËSHILLTAR DEFEKTOLOG	207
---	------------

KOMPETENCA SPECIFIKE PËR BASHKËPUNËTOR PROFESIONAL-KËSHILLTAR BIBLIOTEKIST	209
---	------------



KOMPETENCA PROFESIONALE PËR BASHKËPUNËTORË PROFESIONAL NË PROFESION NË SHKOLLAT E MESME	215
--	------------

PARATHËNIE.....	217
------------------------	------------

Vlera profesionale	218
--------------------------	-----

I. PUNË ME NXËNËS.....	219
II. PUNË ME ARSIMTARË	223
III. ZHVILLIM PROFESIONAL DHE BASHKËPUNIM PROFESIONAL.....	227
IV. STRUKTURË, ORGANIZIM DHE KLIMË SHKOLLORE	231

PARATHËNIE

Republika e Maqedonisë ka traditë të punësimit të bashkëpunëtorëve profesional në shkolla - pedagogë, psikologë, sociologë, punëtorë social, defektologë dhe bibliotekistë. Ata kanë pozicion unik në shkollë, nga i cili kanë qasje në punën e përgjithshme dhe mundësi që të identifikojnë nevojën dhe t'u ofrojnë mbështetje profesionale të gjithë atyre që janë të përfshirë në procesin edukativo-arsimor. Përveç pedagogëve, profilet tjera të bashkëpunëtorëve profesional nuk janë të shkolluar për punë në shkollë. Si rezultat i kësaj ishte e domosdoshme, si pjesë e aktiviteteve për përmirësimin e sistemit për zhvillim profesional dhe në karrierë të kuadrit edukativo-arsimor, të përkufizohen edhe kompetencat profesionale për secilin prej profileve të përmendura të bashkëpunëtorëve profesional.

Kompetencat themelore profesionale dhe standardet¹ për tituj të bashkëpunëtorëve profesional i përpiloi grupi punues i përbërë prej përfaqësuesve të këtyre profileve në shkolla, këshilltarëve të Byrosë për Zhvillimin e Arsimit dhe Qendrës për Arsim Profesional dhe Trajnim, si dhe profesorëve universitarë. Gjatë përpilimit të tyre janë marrë parasysh dokumente të ngjashme nga një numër i madh i vendeve, si dhe *Kompetencat themelore profesionale për arsimtarëve dhe Standardet për arsimtar-mentor dhe arsimtar-këshilltar*. Për versionin përfundimtar të dokumentit kontribuuan dukshëm edhe shoqatat profesionale dhe individët që u përfshinë në diskutimin publik.

Në *Kompetencat themelore profesionale për bashkëpunëtorë profesional dhe Standardet për bashkëpunëtor profesional-mentor dhe bashkëpunëtor profesional-këshilltar*, janë përkufizuar vlerat, njohuritë dhe shkathtësitë e bashkëpunëtorëve profesional-pedagog, psikolog, sociolog, punëtor social, defektolog dhe bibliotekist.

Pozicioni dhe puna e bashkëpunëtorëve profesional në profesion², e nga këtu edhe kompetencat e tyre profesionale, dallohen rëndësishëm nga kompetencat e bashkëpunëtorëve tjerë profesional. Sipas Ligjit për arsim fillor, edhe ata janë të përfshirë në kategorinë e bashkëpunëtorëve profesional. Prandaj, në fund të këtij publikimi, janë zhvendosur si pjesë e posaçme edhe *Kompetencat profesionale për bashkëpunëtorët profesional në profesion*.

Kompetencat themelore profesionale për bashkëpunëtorëve profesional kanë të bëjnë me kompetencat që bashkëpunëtorët profesional duhet t'i posedojnë nga momenti i përfundimit të stazhit të fillestarit dhe dhënies me sukses të provimit profesional, e deri në përfundimin e stazhit të punës. Me këtë rast, nëse bashkëpunëtori profesional dëshiron të avancohet në titull, përveç këtyre kompetencave themelore, duhet t'i përmbushë edhe standardet për bashkëpunëtor profesional-mentor, gjegjësisht këshilltar.

1 Me kompetenca nënkuptohet përmbledhja e diturisë, aftësisë, shkathtësive dhe vlerave të fituara profesionale, gjegjësisht aftësi e dëshmuar për shfrytëzimin e njohurive dhe shkathtësive në situatë të nxënies ose të punës. Me standard nënkuptohen kompetencat e nivelit më të lartë që duhet të posedohen për të marrë titull të caktuar gjatë avancimit në karrierë.

2 Në Ligjin për arsim fillor në grupin e bashkëpunëtorëve profesional përmenden laborantë dhe të tjerë që në këtë dokument mbajnë emër të përbashkët bashkëpunëtor profesional në profesion.

PIKËNISJE THEMELORE

Gjatë përpilimit të kompetencave themelore profesionale dhe standardet për tituj mentor dhe këshilltar i është kushtuar rëndësi përfshirjes së kompetencave që kanë të bëjnë me angazhimin e përgjithshëm profesional të bashkëpunëtorëve profesional, si punë me nxënës, arsimtarë, prindër dhe bashkësinë më të gjerë. Me këtë rast, roli i bashkëpunëtorit profesional është shqyrtuar më së shumti nga aspekti i sigurimit të mbështetjes për nxënësve, arsimtarëve dhe prindërve me qëllim të arritjes së funksionimit të suksesshëm të nxënësve në nivel akademik, emocional, social dhe bibehaviorist. Nga ana tjetër, ata kanë pozicion unik në shkollë nga i cili mund ta bëjnë lidhjen e teorisë me praktikën dhe t'i mbështesin të gjithë pjesëmarrësit në procesin edukativo-arsimor që të punojnë në arritjen e qëllimeve të shkollës dhe më gjerë të sistemit edukativo-arsimor. Prandaj, gjatë përkufizimit të kompetencave të nevojshme, veçanërisht është marrë parasysh roli i tyre në ndërtimin dhe zbatimin e strategjive zhvillimore dhe parandaluese në funksion të nxënies dhe zhvillimit të nxënësve.

Gjatë përpilimit të dokumentit lindi ideja për punë ekipore të bashkëpunëtorëve profesional në shkollë. Mirëpo, ndonëse ekzistojnë kompetenca të përgjithshme, të përbashkëta, nënkuptohet se te profile të ndryshme të bashkëpunëtorëve profesional ato nuk janë identike dhe se bashkëpunëtorët profesional do t'i shfrytëzojnë specifikat e profesionit personal gjatë punës në situata të caktuara dhe secili do t'i qaset punës nga aspekti i tij. Specifikat në qasjet e bashkëpunëtorëve profesional janë të veçuara nga kompetencat e përbashkëta dhe janë dhënë në pjesë të veçantë. Po ashtu, është e rëndësishme të përmendet se nëse në shkollë mungon ndonjë profil i bashkëpunëtorit profesional pritet që obligimet e tij, në pjesën e kompetencave të përbashkëta profesionale, të mund t'i marrin përsipër bashkëpunëtorët tjerë profesional. Nëse bashkëpunëtori ekzistues profesional nuk ndjehet i përgatitur sa duhet për veprim në kuadër të profilit të tij ose të kompetencave të arritura deri atëherë, pritet që ai të ndër marrë nisma në interesin më të mirë të nxënësit dhe të kërkojë ndihmë nga personat tjerë

kompetent. Gjatë punës ekipore duhet të angazhohet më së shumti ai profil i bashkëpunëtorit profesional që e kërkon problematika.

Për shkak të natyrës së angazhimit të tyre, bashkëpunëtorët mobil profesional do të punojnë më pak në aktivitete që kanë të bëjnë me punën analitike hulumtuese dhe punën sistimore në nivel të gjithë shkollës, ndërsa pritet që më shumë të jenë të orientuar drejt punës me nxënës, arsimtarë dhe prindër. Bibliotekistët, të cilët me një pjesë të orarit të punës janë arsimtarë pritet të angazhohen më pak në punën me nxënës në ngritjen e shkathësive të tyre hulumtuese dhe lexuese dhe të angazhohen më pak në ofrimin e mbështetjes profesionale të arsimtarëve për shfrytëzimin e resurseve të bibliotekës për realizimin e mësimdhënies.

Kompetencat e përgjithshme që janë të domosdoshme për shumicën e profesioneve në shekullin XXI, si për shembull shfrytëzimi i teknologjisë bashkëkohore, njohja e gjuhëve të huaja, etj. nuk janë përmendur meqë pritet që bashkëpunëtorët profesional t'i posedojnë deri në atë nivel që u mundëson shfrytëzim në punën e përditshme.

DEDIKIMI I KOMPETENCAVE PROFESIONALE DHE STANDARDEVE

Kompetencat themelore profesionale dhe standardet për tituj bashkëpunëtorë profesional-mentor dhe bashkëpunëtorë profesional-këshilltar kanë dhe duhet të shërbejnë për më shumë dedikime në zhvillimin profesional dhe në karrierë të bashkëpunëtorëve profesional.

MBËSHTETJE TË PUNËS SË BASHKËPUNËTORËVE PROFESIONAL

- Planifikim i stazhit të fillestarit për bashkëpunëtorët profesional dhe mbështetje me anë të mentorimit.
- Reflektim i efikasitetit dhe efektivitetit personal profesional.
- Përpilim i procedurave dhe instrumenteve për vëzhgimin e punës së bashkëpunëtorëve

profesional dhe ofrim i mbështetjes profesionale.

- Përpilim i kompetencave për bashkëpunëtorët profesional në shkolla të posaçme, konvikte të nxënësve dhe kopshte për fëmijë.
- Planifikim i zhvillimit profesional dhe në karrierë, si atij personal, ashtu edhe atij në nivel të shkollës, rajonit, shtetit.

MBËSHTETJE TË NDRYSHIMEVE NË SISTEMIN ARSIMOR

- Përkufizim i qartë i punës së bashkëpunëtorëve profesional në shkollat fillore dhe të mesme.
- Informim për dhe njohje me rolin e bashkëpunëtorëve profesional në shkolla.
- Harmonizim i arsimimit universitar me kompetencat e nevojshme për bashkëpunëtorë profesional.
- Sigurimi i programeve specifike të akredituara për trajnim për çdo profil të bashkëpunëtorëve profesional.
- Ripërkufizim i përbajtjes dhe mënyrës së dhënies së provimit profesional për bashkëpunëtorët profesional.
- Përmirësim i rregullores dhe akteve ligjore që kanë të bëjnë me bashkëpunimin profesional.
- Përmirësim i punës së institucioneve kompetente për ndjekjen, matjen dhe përmirësimin e cilësisë së punës së arsimtarëve dhe shkollave.

STRUKTURË E DOKUMENTIT

Kompetencat profesionale dhe standardet përfshijnë dy pjesë që janë të ndërlidhura mes vete:

Vlera profesionale. Vlerat profesionale janë parime udhëheqëse që bashkëpunëtorët profesional i kanë pranuar dhe manifestohen nëpër të gjitha aspektet e punës së tyre. Ato janë dhënë në fillim të këtij dokumenti për shkak se kanë të bëjnë me të gjithë bashkëpunëtorët profesional dhe të gjitha nivelet e kompetencës.

Njohuri dhe shkathtësi profesionale. Këto janë njohuri dhe shkathtësi që bashkëpunëtorët profesional i ka përvetësuar gjatë arsimit universitar dhe gjatë punës. Kompetencat themelore profesionale doemos duhet t'i posedojë deri në fund të karrierës si bashkëpunëtor profesional dhe t'i zhvillojë vazhdimisht. Me qëllim që të sqarohet më mirë manifestimi i kompetencave, janë paraqitur edhe shembuj të aktiviteteve të praktikës profesionale të bashkëpunëtorëve profesional.

Shembujt e praktikës profesionale janë tregues të mundshëm për posedimin e kompetencave dhe nuk paraqesin regjistrim të detyrave të punës të bashkëpunëtorëve profesional, por duhet të ndihmojnë në planifikimin e punës së bashkëpunëtorit profesional, me ç'rast do të merren parasysh nevojat e shkollës dhe numri i bashkëpunëtorëve profesional, si dhe profili specifik i bashkëpunëtorit profesional. Bashkëpunëtorët profesional, në punën e tij, duhet të udhëhiqet kryesisht nga interesi më i mirë i nxënësit.

Kompetencat që kanë të bëjnë me njohuritë dhe shkathtësitë profesionale janë grupuar në dy kategori: kompetenca të përbashkëta³ dhe kompetenca specifike për profile të caktuara të bashkëpunëtorëve profesional. Në kuadër të dy kategorive kompetencat janë organizuar në shtatë fusha, ndërsa secila fushë përbëhet prej disa nën-fushave. Me këtë rast, disa kompetenca të caktuara mund t'u takojnë disa fushave. Në raste të tilla kompetenca e caktuar e bashkëpunëtorit profesional-mentor është vendosur vetëm në një fushë, gjegjësisht, ajo që është përmendur një herë, nuk paraqitet sërish në fushë tjetër.

³ Kompetencat e përbashkëta kanë të bëjnë me bashkëpunëtorin profesional pedagog, psikolog, sociolog, punëtor social dhe defektolog. Ato s'kanë të bëjnë me bashkëpunëtorin profesional bibliotekist. Kompetencat specifike për bashkëpunëtor profesional bibliotekist janë në numër më të madh sesa ato për profilet tjera dhe e reflektojnë specifikën më të madhe në punën e bibliotekistit shkollor.

Njohuritë dhe shkathtësitë profesionale dhe shembujt e praktikës profesionale janë grupuar në fushat vijuese:

I. PUNË ME NXËNËS

- Mbështetje e nxënësve gjatë nxënies
- Vëzhgim dhe mbështetje e zhvillimit të nxënësve
- Orientim profesional dhe në karrierë i nxënësve

II. PUNË ME ARSIMTARË

- Mbështetje e arsimtarëve gjatë planifikimit dhe realizimit të procesit edukativo-arsimor dhe vetëvlerësimit
- Mbështetje e arsimtarëve gjatë punës me nxënës
- Mbështetje e arsimtarëve gjatë punës me prindër

III. PUNË ME PRINDËR

- Këshillime dhe konsultime individuale dhe grupore me prindër
- Edukim i prindërve
- Përfshirje e prindërve në jetën dhe punën e shkollës

IV. BASHKËPUNIM ME BASHKËSINË

- Bashkëpunim me bashkësinë lokale
- Bashkëpunim me institucionet dhe organizatat profesionale

V. ZHVILLIM PROFESIONAL DHE BASHKËPUNIM PROFESIONAL

- Zhvillim personal profesional.
- Mbështetje e zhvillimit profesional dhe bashkëpunimit në shkollë

VI. PUNË ANALITIKE HULUMTUESE⁴

- Analizë dhe vlerësim i punës edukativo-arsimore
- Hulimtim i punës edukativo-arsimore

VII. STRUKTURË, ORGANIZIM DHE KLIMË SHKOLLORE

- Strukturë dhe organizim shkollor
- Klimë shkollore, mjedis i sigurt dhe pjesëmarrje demokratike e nxënësve

Standardet për bashkëpunëtor profesional-mentor janë përpiluar ashtu që ndërtohen mbi Kompetencat themelore profesionale, ndërsa për bashkëpunëtor profesional-këshilltar ndërtohen mbi standardet për bashkëpunëtor profesional-mentor. Më konkretisht për bashkëpunëtor profesional-mentor duhet të posedohen kompetencat themelore profesionale dhe standardet për bashkëpunëtor profesional-mentor, ndërsa për bashkëpunëtor profesional-këshilltar duhet të posedohen kompetencat themelore profesionale, standardet për bashkëpunëtor profesional-mentor dhe standardet për bashkëpunëtor profesional-këshilltar.

Në këtë dokument, kompetencat dhe standardet janë të ndara vetëm teknikisht në tri pjesë:

- **KOMPETENCA THEMELORE PROFESIONALE PËR BASHKËPUNËTOR PROFESIONAL**
- **STANDARDE PROFESIONALE PËR BASHKËPUNËTOR PROFESIONAL-MENTOR**
- **STANDARDE PROFESIONALE PËR BASHKËPUNËTOR PROFESIONAL-KËSHILLTAR**

⁴ Fusha punë analitike hulimtumuese është anashkaluar në kompetencat themelore profesionale të bibliotekistëve, ndërsa disa kompetenca nga kjo fushë në standardet për bibliotekist mentor dhe bibliotekist këshilltar janë përfshirë në fushën 7. Strukturë, organizim dhe klimë shkollore.

VLERA PROFESIONALE

NXËNËSI ËSHTË MË I RËNDËSISHËM

Bashkëpunëtorët profesional janë të përkushtuar që të punojnë në interes të nxënësve dhe në plan të parë e vendosin nxënien e tyre, sjelljen dhe shëndetin mental. Ata besojnë se me punën e tyre në shkollë mund të kontribuojnë në zhvillimin maksimal të potencialeve të nxënësve dhe punojnë në mënyrë të përkushtuar për arritjen e këtij qëllimi. Besojnë se nxënësit të cilët janë të interesuar, motivuar, të sigurt në vetveten, të pranuar nga të punësuarit në shkollë dhe nga bashkënxënësit, ndjehen mirë në shkollë dhe duan të mësojnë, prandaj angazhohen që të gjithë nxënësit të ndjehen të mirëseardhur në shkollë. Janë të bindur se qasja demokratike ndaj nxënësve do t'i nxisë që në këta bashkëpunëtorë profesional të shikojnë dikë që ofron ndihmë dhe mbështetje. Duke e respektuar veçantinë dhe vlerën e personalitetit të secilit nxënës, në situata kur bien ndesh interesat e nxënësit me interesat e të tjerëve, bashkëpunëtorët profesional kryesisht udhëhiqen nga interesi i nxënësve.

INTEGRITET PROFESIONAL

Bashkëpunëtorët profesional udhëhiqen nga parimi se kompetenca, autonomia, përgjegjësia dhe bashkëpunimi profesional janë të domosdoshëm për punë të suksesshme. Ndonëse ndjeshmëria e profesionit dhe lidhshmëria me të gjitha segmentet e punës së shkollës i vendosë bashkëpunëtorët profesional në pozicionin që duhet të përgjigjen dhe reagojnë ndaj situatave të ndryshme, ata, të vetëdijshëm për kufijtë e njohurive dhe profesionalizmit të tyre dhe kufizimeve me të cilat përballen në punë, besojnë se janë të thirrur që të sigurojnë shërbime dhe përdorin teknika për të cilat kanë marrë kualifikime dhe nuk premtojnë zgjidhje të problemeve që nuk mund t'i zgjidhin. Në situata të tilla, bashkëpunimin profesional me persona ose institucione tjera kompetente e shikojnë si mënyrë për t'u ndihmuar nxënësve, arsimtarëve dhe prindërve. Besojnë se për

suksesin e nxënësve, kryesor është bashkëpunimi në mes kuadrit edukativo-arsimor në shkollë dhe synojnë që të njëjtin ta ngrenë në nivel të lartë. Ata janë të bindur se nëse veprojnë me respekt ndaj personalitetit të kolegëve të tyre dhe ndaj nevojave dhe obligimeve të tyre të posaçme (bashkëpunëtorët profesional, arsimtarët, kuadri udhëheqës) do të krijojnë kushte për punë efektive. Qasjen objektive, të ndershme dhe me përgjegjësi në punën hulumtuese, pa marrë parasysh njohurive deri te të cilat kanë arritur, e shikojnë si kusht për përmirësim dhe ndryshime pozitive.

BESUESHMËRI

Janë të vetëdijshëm se ndonjëherë gjatë punës vijnë deri te informacione të ndjeshme për nxënësit, arsimtarët dhe prindërit e tyre, që i bën të ndjeshme raportet e tyre. Për këtë arsye veçanërisht kanë kujdes që t'i ruajnë marrëdhëniet me të gjithë në nivel të lartë profesional. Mbajnë qëndrimin se besueshmëria e informacioneve nuk është vetëm kërkesë dhe obligim etik, por edhe parim i cili guxon të shkelet vetëm në kushte të jashtëzakonshme (p.sh. kur mos zbulimi i informacioneve mund të ketë pasoja në shëndetin fizik dhe psikik të nxënësve). Konsiderojnë se informacionet që janë relevante për përmirësimin e gjendjes së nxënësve, mund të jenë të dobishme, vetëm nëse transmetohen saktësisht dhe kuptueshëm për shfrytëzuesit, ndërsa brenga nga përdorimi i mundshëm joadekuat i informacioneve, bën që të jenë veçanërisht të kujdesshëm gjatë komunikimit të tyre.

BARAZI, INKLUZION (PËRFSHIRJE) DHE DREJTËSI SOCIALE

Duke e mbështetur punën e tyre në respektimin e të drejtave të njeriut, bashkëpunëtorët profesional janë të vetëdijshëm për dallimet e nxënësit dhe prindërit e tyre, angazhohen që të njëjtat të pranohen dhe respektohen nga të gjithë të punësuarit në shkollë. Besojnë se nxënësit duan të mësojnë dhe mësojnë nëse ndihen të pranuar dhe të respektuar në paralele/klasë dhe në shkollë, si dhe angazhohen për krijimin e një mjedisi në të cilin dallimet pranohen dhe respektohen. Besojnë se

përmes sigurimit të një mjedisi nxitës, do të sigurohet që secili të mësojë dhe ta shfrytëzojë dhe shprehë potencialin e tij deri në maksimum.

Besojnë në rëndësinë e respektimit të konventave dhe dokumenteve për mosdiskriminim, të drejtave të njeriut dhe të fëmijëve, si dhe parimeve të drejtësisë sociale. E shikojnë përmbajtjen ndaj këtyre parimeve si rrugë drejt transformimit të shkollës në një vend më të mirë për nxënie.

INICIATIVË DHE ZHVILLIM I VAZHDUESHËM

Besojnë se përmes integritetit të vet profesional dhe personal, vlerave të larta etike dhe sjelljes, e promovojnë profesionin e vet dhe kontribuojnë drejt formimit të qëndrimit pozitiv të opinionit publik ndaj profesionit. Konsiderojnë se ndryshimet në shoqëri duhet të përcillen me ndryshime në shkolla, prandaj angazhohen për përparim të vazhdueshëm të jetës dhe punës në shkollë. Veprojnë nga parimi se ndryshimet fillojnë nga individ, ndërsa vetveten e shikojnë si iniciues për ndryshime.

Në punën e zhvillimit personal dhe profesional të kuadrit arsimor, kontribuojnë që ai më shumë të jetë i orientuar drejt vizionit për mësimdhënie dhe nxënie bashkëkohore në shekullin 21, sesa drejt tejkalimit të dobësive rrjedhëse.



**KOMPETENCA
THEMELORE
PROFESIONALE**
për **BASHKËPUNËTORË
PROFESIONAL**

KOMPETENCA TË PËRBASHKËTA PËR BASHKËPUNËTORË PROFESIONAL

I . PUNË ME NXËNËS

Bashkëpunëtorët kompetent profesional e dinë se si fëmijët mësojnë dhe zhvillohen dhe u japin mbështetje të gjithë fëmijëve. E dinë se secili fëmijë mund ta arrijë maksimumin e tij, nëse i jepet mundësi përkatëse. Ndërmarrin aktivitete përkatëse për përfshirjen e të gjithë fëmijëve në procesin arsimor dhe për pranimin përkatës të tyre në kontekstin shkollor. Ata i trajtojnë nxënësit në mënyrë të barabartë dhe të drejtë, por i perceptojnë dallimet e tyre individuale dhe të njëjtat i marrin parasysh gjatë punës së tyre me ta. Me këtë rast, bashkëpunëtorët profesional e mbështesin punën në observimet dhe vlerësimet e vazhdueshme që kanë të bëjnë me interesin më të mirë të nxënësve, si dhe vlerësimin e vazhdueshëm të përparimit të njohurive të tyre, potencialeve të tyre, anëve të fuqishme, shkathtësive dhe rrethit familjar.

Bashkëpunëtorët profesional kanë njohuri dhe shkathtësi për punë individuale dhe grupe me nxënës, me qëllim që të nxitet dhe mbështetet zhvillimi intelektual dhe socio-emocional i nxënësit, njohuritë dhe përparimi i tij.

I. PUNË ME NXËNËS

Nën-fusha: MBËSHTETJE E NXËNËSVE GJATË NXËNIES

BASHKËPUNËTORI PROFESIONAL...



A. KUPTIME DHE NJOHURI PROFESIONALE	B. AFTËSI DHE SHKATHTËSI PROFESIONALE
1. Kupton konceptet për zhvillim kognitiv, nxënie dhe mësim, si dhe lidhshmërinë e tyre me mësimdhënien.	1.1 Vlerëson gatishmërinë e nxënësve për përfshirje dhe përparim në sistemin arsimor.
2. Kupton dallimet individuale gjatë nxënies të nxënësit dhe një strategji përkatëse për nxënie dhe mbështetje të nxënësve gjatë nxënies.	2.1 Është sensibil për nevojat e ndryshme arsimore të nxënësve, di t'i identifikojë dhe të sigurojë mbështetje përkatëse.
3. Njeh faktorët që ndikojnë në procesin e nxënies dhe motivimit të nxënësve.	3.1 Ndërton standarde të larta personale të nxënësit për sukses dhe qëndrim pozitiv ndaj nxënies. 3.2 Identifikon faktorë potencial që mund të rezultojnë me mospjesëmarrje, si dhe informon dhe jep rekomandime.
4. Njeh metoda dhe teknika për punë me nxënës dhe këshillimin e tyre të suksesshëm për nxënie.	4.1 Shfrytëzon qasje të ndryshme për të ndihmuar nxënësit gjatë nxënies në përputhje me nevojat e tyre.
5. Njeh koncepte dhe modele të ndryshme për zhvillimin e arsimit inkluziv (përfshirës).	5.1 Zgjedhë qasje përkatëse për inkluzion (përfshirje).
6. Ka njohuri për shfrytëzimin e teknologjisë ndihmëse ⁵ gjatë punës me nxënës me nevoja të posaçme arsimore.	6.1 Promovon shfrytëzimin e teknologjisë ndihmëse nga nxënësit.



SHEMBUJ TË PRAKTIKËS PROFESIONALE



- Shfrytëzon metoda dhe instrumente të ndryshme për shqyrtimin e gatishmërisë për përfshirje të nxënësve në nivelin përkatës të arsimit.
- Merr pjesë në komisionin për regjistrimin e nxënësve në shkollë.
- Merr pjesë në përgatitjen e dokumenteve (plane, procedura, udhëzime, rekomandime) për identifikimin e nevojave arsimore të nxënësve dhe për sigurimin e mbështetjes përkatëse.
- Organizon dhe realizon lloje të ndryshme të punës individuale dhe grupore me nxënësit për çështje që kanë të bëjnë me nxënien, suksesin, sistemin e vlerave.
- Inkurajon dhe mbështet nxënësit për të aplikuar në konkurse dhe gara.
- Mbledhë të dhëna për shkaqet e mospjesëmarrjes (bën shqyrtimin e tyre, intervista, diskutime në fokus grupe).
- Informon prindërit, arsimtarët dhe nxënësit dhe u jep rekomandime përkatëse.
- Shfrytëzon metoda dhe instrumente të ndryshme për identifikimin e nevojave për mbështetje gjatë nxënies dhe vetëvlerësimit.
- Planifikon dhe jep mbështetje të drejtpërdrejtë për nxënësit gjatë nxënies.
- Bën/merr pjesë në identifikimin e nxënësve me nevoja të posaçme arsimore.
- Koordinon/merr pjesë në punën e ekipit inkluziv (përfshirës) në shkollë.
- Merr pjesë në përpilimin e planit individual arsimor për nxënësit me nevoja të posaçme arsimore.
- I këshillon dhe inkurajon nxënësit që të shfrytëzojnë TIK-un adekuat dhe teknologjinë ndihmëse.

⁵ Me termin teknologji ndihmëse nënkuptohet çdo lëndë, pjesë e pajisjeve ose produkt, qoftë i furnizuar në shitore ose jo, i përshtatur ose përpunuar posaçërisht, që përdoret për të rritur, ruajtur ose përmirësuar aftësitë funksionale të individëve me aftësi të kufizuara.

I. PUNË ME NXËNËS

Nën-fusha: VËZHGIM DHE MBËSHTETJE
E ZHVILLIMIT TË NXËNËSVE

BASHKËPUNËTORI PROFESIONAL...




A. KUPTIME DHE NJOHURI PROFESIONALE	B. AFTËSI DHE SHKATHTËSI PROFESIONALE
<ol style="list-style-type: none">1. Kupton proceset e zhvillimit social dhe emocional dhe lidhshmërisë së tyre me sjelljen e nxënësve.2. Kupton sfidat në komunikimin dhe bashkëpunimin me pjesëtarët e kulturave të ndryshme, me vlera dhe përvoja të ndryshme.	<ol style="list-style-type: none">1.1 Nxitë dhe zhvillon vetëbesim dhe vetë respektim tek nxënësit.2.1 Komunikon me nxënësit në mënyrën që siguron mbështetje dhe besim.2.2 Komunikimin me nxënësit e mbështetë në respektin dhe kujdesin, duke i promovuar vlerat, qëndrimet dhe sjelljet pozitive që i pret edhe prej tyre.2.3 Gjatë punës individuale dhe grupore me nxënësit qasjen e përshtatë me situatën dhe llojin e problemit.



SHEMBUJ TË PRAKTIKËS PROFESIONALE



- Identifikon shkaqet për vetëbesimin, vetërespektin e ulët dhe organizon punëtori për rritjen e vetëbesimit dhe vetërespektit.
- Përfshin nxënësit në aktivitete që nxisin vetëbesimin dhe vetërespektin.
- Ka vendosur mekanizma që i mundësojnë nxënësit të marrë mbështetje nga bashkëpunëtori profesional gjithmonë kur i nevojitet (nxënësit janë të informuar për mundësitë për konsultim).
- Në mënyrë aktive i dëgjon dhe respekton qëndrimet, mendimet dhe interesat e nxënësve.
- Organizon aktivitete për zhvillimin e humanizmit, solidaritetit dhe bashkëpunimit ndëretnik.
- Shfrytëzon lloje të ndryshme të strategjive dhe qasjeve në komunikimin individual dhe grupor me nxënësit.



I. PUNË ME NXËNËS

Nën-fusha: ORIENTIM PROFESIONAL
DHE NË KARRIERË I NXËNËSVE

BASHKËPUNËTORI PROFESIONAL...



A. KUPTIME DHE NJOHURI PROFESIONALE	B. AFTËSI DHE SHKATHTËSI PROFESIONALE
<ol style="list-style-type: none">1. E di rëndësinë dhe parimet për orientim profesional dhe në karrierë të nxënësve.2. Njeh metodat për orientim profesional, këshillim dhe zhvillim në karrierë të nxënësve.3. Është i informuar për situatat në tregun e punës.4. Është i informuar për rrjetin e shkollave të mesme/ institucioneve të larta arsimore.5. E di rëndësinë e zgjedhjes së drejtë të profesionit.	<ol style="list-style-type: none">1.1 Zgjedhë dhe shfrytëzon metoda dhe instrumente përkatëse për orientim profesional dhe këshillim për zhvillim në karrierë të nxënësve.3.1 Mbështetë këshillimin profesional dhe në karrierë të nxënësve në interesat, aftësitë dhe mundësitë e përcaktuara shoqërore.



SHEMBUJ TË PRAKTIKËS PROFESIONALE



- Shqyrton nivelin e informimit dhe interesimin e nxënësve për arsim të mëtejshëm ose punësim.
- Shqyrton interesat profesionale.
- Sintetizon dhe interpreton të dhënat e fituara.
- Informon nxënësit për mundësitë dhe perspektivat e profesioneve.
- Informon nxënësit për rrjetin e shkollave të mesme/institucioneve të larta arsimore për profesionet që mësohen në kuadër të tyre dhe për kushtet për regjistrim.
- Organizon prezantime në të cilat shkollat e mesme/institucionet e larta arsimore, subjektet ekonomike prezantohen para nxënësve.
- Bën këshillime individuale dhe grupore me nxënës dhe prindër për zgjedhjen e drejtë të arsimimit të mëtejshëm ose profesionit.

II. PUNË ME ARSIMTARË

Njëra prej kompetencave kryesore të bashkëpunëtorit profesional në shkollat fillore dhe të mesme është mbështetja e arsimtarëve gjatë planifikimit dhe realizimit të punës edukativo-arsimore me qëllim të përmirësimit të mësimdhënies, e më këtë edhe të nxënies së nxënësve, gjegjësisht, përmirësimin e të arriturave të nxënësve. Pritet që bashkëpunëtori profesional të ketë njohuri më të gjera për sistemin e përgjithshëm edukativo-arsimor, e veçanërisht për inovacionet në të dhe të posedojë shkathtësi për mbështetjen e arsimtarëve në të gjitha komponentët e mësimdhënies, duke përfshirë edhe komponentin e saj edukativ.

Për të vendosur bashkëpunim përkatës në mes bashkëpunëtorit profesional dhe arsimtarit nevojitet që marrëdhëniet e ndërsjella t'u mbështeten në respekt, mirëkuptim dhe besim. Bashkëpunimi realizohet përmes trupave profesionale që ekzistojnë në shkollë, gjegjësisht aktiveve profesionale, këshillit të klasave, këshillit të arsimtarëve, takimeve individuale, e në forma tjera të planifikuara në programin vjetor për punë, p.sh.: vizitë në orë, punëtori, mentorim, shkëmbim të materialeve, etj., si dhe përmes ndihmës dhe bashkëpunimit joformal kolegjal.

Bashkëpunëtori profesional shumë shpesh i realizon aktivitetet për mbështetjen e arsimtarëve, përmes punës ekipore me bashkëpunëtorët tjerë profesional në shkollë. Kur punojnë në mënyrë ekipore, secili bashkëpunëtor ofron mbështetje për ato aspekte të punës së arsimtarit për të cilat bashkëpunëtori profesional është më kompetent.

II. PUNË ME ARSIMTARË

Nën-fusha: MBËSHTETJE E ARSIMTARËVE GJATË PLANIFIKIMIT DHE REALIZIMIT TË PROCESIT EDUKATIVO-ARSIMOR DHE VETËVLERËSIMIT

BASHKËPUNËTORI PROFESIONAL...



A. KUPTIME DHE NJOHURI PROFESIONALE	B. AFTËSI DHE SHKATHTËSI PROFESIONALE
1. Njeh dokumentet dhe standardet strategjike, konceptuale dhe programore për nënsistemin e arsimit në të cilin punon.	1.1 U ofron mbështetje profesionale arsimtarëve gjatë kuptimit dhe zbatimit të dokumenteve programore dhe konceptuale.
2. Njeh programet dhe qasjet aktuale (p.sh. <i>Arsim për shkathtësi jetësore, Inovacione dhe veprimtari sipërmarrëse, Punë projektuese</i> , etj.) që duhet të shfrytëzohen në shkollë.	
3. Njeh parimet për përpilimin e PIA-së/e di rëndësinë e PIA-së për nxënësit me nevoja të posaçme arsimore.	3.1 Ofron mbështetje profesionale gjatë përpilimit të planit individual arsimor.
4. Njeh taksonomi për qëllime edukativo-arsimore.	4.1 Ofron mbështetje profesionale gjatë planifikimit të mësimdhënies.
5. Njeh llojet e planifikimeve të punës edukativo-arsimore.	
6. Njeh karakteristikat dhe nevojat individuale të qasjeve zhvillimore të nxënësit.	6.1 Te arsimtarët nxitë pritje të larta për zhvillimin dhe të arriturat e nxënësve.
7. Kupton se në çfarë mënyre mjedisi e nxitë dhe mundëson nxënien.	7.1 Promovon krijimin dhe mirëmbajtjen e mjedisit të hapur dhe stimulues që nxitë hulumtim, nxënie dhe pavarësi.
8. Njeh parimet e vendosjes së klimës pozitive socio-emocionale në klasë.	8.1 Ofron mbështetje profesionale për sigurimin e klimës pozitive socio-emocionale në klasë.
9. E di se qëllimi parësor i notimit është avancimi i të arriturave të nxënësve.	9.1 Udhëzon arsimtarët se si t'i shfrytëzojnë rezultatet e notimit për përmirësimin e procesit të mësimdhënies dhe nxënies.
10. Njeh kodeksin etik gjatë notimit.	10.1 Zbaton parimet e kodeksit etik gjatë notimit
11. Njeh potencialet e burimeve të ndryshme të njohurive.	11.1 U ofron mbështetje profesionale arsimtarëve për shfrytëzimin e burimeve të ndryshme të njohurive.
12. Njeh projektet në nivel të shtetit për përmirësimin e cilësisë së mësimin.	12.1 Ofron mbështetje në realizimin e aktiviteteve projektuese me të cilat përmirësohet cilësia e mësimdhënies.
13. Kupton rolin e kujdestarit të paraleles/klasës.	13.1 Ofron ndihmë profesionale për aktivitetet që duhet t'i realizojë kujdestari i paraleles.



SHEMBUJ TË PRAKTIKËS PROFESIONALE

- Organizon dhe realizon aktivitete (ligjërata, punëtori), për analizimin e dokumenteve konceptuese.
- Organizon dhe realizon aktivitete (ligjërata, punëtori), për programet dhe qasjet aktuale në mësimdhënie.
- Vëzhgon mësimdhënien dhe u jep informacion kthyes (me shkrim ose gojor) arsimtarëve për aspektet e ndryshme që janë vëzhguar.
- Merr pjesë në punën e ekipit për përpilimin e PIA-së.
- Shqyrton cilësinë e planifikimeve për mësimdhënien dhe konsultohet me arsimtarët për përmirësimin e të njëjtave.
- Organizon dhe realizon aktivitete (punëtori, konsultime individuale) me arsimtarët për planifikimin e mësimit (p.sh. operacionalizim i qëllimeve, përgatitje e orës/aktivitetit, përzgjedhje e formave, metodave dhe mjeteve, organizim të punës, individualizim, diferencim, etj.).
- Ndihmon arsimtarët që t'i marrin parasysh karakteristikat dhe nevojat individuale të periudhave zhvillimore gjatë planifikimit dhe realizimit të mësimdhënies.
- Udhëzon për planifikimin e aktiviteteve gjatë orës mësimore për nxënësit me vështirësi në zotërimin e përmbajtjeve mësimore.
- Realizon aktivitete (punëtori, prezantime, shembuj të praktikës së mirë, konsultime individuale me arsimtarë) për krijimin e mjedisit stimulues për nxënie.
- Vëzhgon sjelljen e nxënësve të paraleles gjatë mësimdhënies dhe pushimit dhe i jep informacion kthyes arsimtarit për përmirësimin e klimës socio-emocionale në klasë.
- Udhëzon arsimtarët se si t'i marrin parasysh rezultatet e notimit gjatë planifikimeve të ardhshme.
- Mbështet arsimtarët që të notojnë në mënyrë korrekte dhe objektive.
- U ndihmon arsimtarëve që të përballen me presionet që kanë të bëjnë me notimin
- Tregon mënyrat e përzgjedhjes dhe shfrytëzimit të burimeve të ndryshme të nxënies (organizon punëtori, jep këshilla individuale, etj.).
- Organizon dhe realizon takime informative për ngjarjet aktuale dhe inovacionet në mësimdhënie.
- Shpërndan informacione për projekte rrjedhëse.
- Merr pjesë në ekipe për punë në projekte.
- Mbështet dhe bashkëpunon me kujdestarinë e paraleles/klasës për planifikimin e aktiviteteve (përzgjedhje e përmbajtjeve dhe metodave).
- Udhëzon kujdestarët e paraleles/klasës për punë me bashkësinë e nxënësve të paraleles.

II. PUNË ME ARSIMTARË

Nën-fusha: MBËSHTETJE E ARSIMTARËVE GJATË PUNËS ME NXËNËS

BASHKËPUNËTORI PROFESIONAL...



A. KUPTIME DHE NJOHURI PROFESIONALE	B. AFTËSI DHE SHKATHTËSI PROFESIONALE
1. Kkupton ndikimin e faktorëve social dhe kulturor në arsim, si dhe kontributin e arsimit për kohezion social.	1.1 Promovon respektimin e dallimeve dhe vlerave demokratike. 1.2 Angazhohet për respektimin e personalitetit të secilit nxënës dhe identifikimin dhe zhvillimin e anëve të fuqishme të tij.
2. E di rëndësinë e përshtatjes së mësimit me karakteristikat e nxënësve.	2.1 Mbështetë arsimtarët në individualizimin e mësimit të detyrueshëm, shtesë dhe plotësues, aktiviteteve të lira të nxënësve dhe garave.
3. I di parimet e komunikimit të mirë mes nxënësve dhe arsimtarëve dhe nxënësve ndërmjet vete.	3.1 U ofron mbështetje profesionale arsimtarëve për vendosjen e komunikimit të mirë mes nxënësve dhe arsimtarëve dhe nxënësve ndërmjet vete.
4. I di problemet e mundshme në sjelljen e nxënësve dhe mënyrat e zgjidhjes së tyre.	4.1 Ndhmon arsimtarin gjatë përbaljes me dhe zgjidhjen e problemeve lidhur me sjelljen e nxënësve.



SHEMBUJ TË PRAKTIKËS PROFESIONALE



- Ofron udhëzime specifike për punë me grupe të caktuara dhe nxënës të caktuar.
- I sqaron arsimtarit llojin dhe specifikat e vështirësive të identifikuara te një nxënës i caktuar dhe e udhëzon drejt qasjeve dhe mënyrave të punës me të.
- Përpilon procedura me arsimtarin për përgatitje dhe punë me paralelen në të cilën ka nxënës të kategorive të ndjeshme.
- Njofton arsimtarët me mënyrat e ndryshme e të nxënësve të nxënësve.
- Njofton arsimtarët me karakteristikat e nxënësve të sapo regjistruar.
- Paraqet model pozitiv për arsimtarët gjatë zbatimit të shkathtësive komunikuese.
- Realizon punëtori për përvetësimin e shkathtësive komunikuese
- Këshillon arsimtarët për komunikim me grup të caktuar të nxënësve
- Vëzhgon komunikimin në klasë dhe i jep informacion kthyes arsimtarit.
- Ndhmon arsimtarin që t'i shqyrtojë shkaqet për sjelljen e papërshtatshme, propozon strategji për tejkalim e saj dhe bashkë me arsimtarin i vëzhgon efektet nga aktivitetet e ndërmarra.

II. PUNË ME ARSIMTARË

Nën-fusha: MBËSHTETJE E ARSIMTARËVE GJATË PUNËS ME PRINDËR

BASHKËPUNËTORI PROFESIONAL...




A. KUPTIME DHE NJOHURI PROFESIONALE	B. AFTËSI DHE SHKATHTËSI PROFESIONALE
1. E di rëndësinë e bashkëpunimit të arsimtarëve dhe prindërve. 2. I di metodat për bashkëpunim arsimtar-prind.	1.1 Promovon kulturën e bashkëpunimit arsimtar-prind. 2.1 Ndhmon arsimtarët në përzgjedhjen e metodave dhe përmbajtjeve përkatëse për bashkëpunim me prindër.



SHEMBUJ TË PRAKTIKËS PROFESIONALE



- Udhëzon arsimtarët drejt komunikimit dhe bashkëpunimit më efektiv me prindër.
- Bashkë me arsimtarët ndërton strategji për bashkëpunim me grupe të caktuara të prindërve ose individëve.
- Propozon përmbajtje për mbledhje prindërore përkatëse për vite të caktuara të arsimit, profesione, situata, etj.
- Merr pjesë në disa nga mbledhjet prindërore (të përgjithshme ose të paraleles sipas nevojës).





III . PUNË ME PRINDËR⁶

Për prindërit është i rëndësishëm mjedisi ku e kalon kohën fëmija i tyre derisa është në shkollë dhe ata me kompetencat e tyre të ndryshme mund të kontribuojnë për përmirësimin e jetës dhe punës në shkollë. Pozicioni që e kanë bashkëpunëtorët profesional u mundëson që të ndikojnë në përfshirjen e prindërve në aktivitetet e ndryshme në shkollë. Nga ana tjetër, prindërit shpesh përballen me çështje dhe situata që kanë të bëjnë me nxënien e fëmijës së tyre, të cilave nuk dinë t'u përgjigjen në mënyrë adekuate. Prandaj, edukimi dhe konsultimi i prindërve janë veçanërisht të rëndësishme gjatë zhvillimit të kompetencave prindërore dhe krijimit të vetëdijes se qëndrimi dhe qasja prindërore janë kyçe në zhvillimin psikofizik dhe përparimin në nxënie të fëmijëve. Për këtë qëllim, bashkëpunëtorët profesional punojnë me prindërit përmes konsultimeve individuale, grupore dhe formave të ndryshme të edukimit, varësisht nga nevojat e tyre dhe lloji i problematikës. Me këtë rast, me rëndësi të veçantë është qasja dhe mënyra e komunikimit që bashkëpunëtori profesional e realizon në kontaktet me prindërit. Bashkëpunëtori profesional është i ndjeshëm, sillet me respekt dhe mirëkuptim dhe paraqet një personalitet në të cilin prindërit kanë besim dhe konsiderojnë se mund t'i drejtohen lirisht dhe ta ndajnë gjithë atë për çka presin mbështetje dhe ndihmë lidhur me fëmijët e tyre. Bashkëpunëtorët profesional me prindërit e nxënësve shkëmbejnë informacione për situatat dhe ndryshimet që i kanë perceptuar te fëmijët e tyre. Një pjesë e informacioneve që bashkëpunëtorët profesional i marrin nga prindërit janë veçanërisht të ndjeshme dhe të natyrës së besueshme, ndaj si rezultat i kësaj, bashkëpunëtorët profesional e dinë se cilat informacione, në çfarë mënyre dhe me kë mund t'i ndajnë, e me cilat duhet vepruar në mënyrë të besueshme.

6 Me prind nënkuptohet edhe përfaqësuesi ligjor, kujdestar.

III. PUNË ME PRINDËR

Nën-fusha: KËSHILLIME DHE KONSULTIME INDIVIDUALE
DHE GRUPORE ME PRINDËR

BASHKËPUNËTORI PROFESIONAL...



A. KUPTIME DHE NJOHURI PROFESIONALE	B. AFTËSI DHE SHKATHTËSI PROFESIONALE
1. Kupton se si familja ndikon në funksionimin kognitiv, emocional dhe social të nxënësve.	1.1 Identifikon situatat potenciale të krizës në familje që e prekin zhvillimin dhe nxënien e nxënësve dhe i ofron mbështetje përkatëse familjes.
2. Posedon njohuri për komunikim me prindërit e fëmijëve.	2.1 Përshtatë komunikimin varësisht nga situata dhe personaliteti i prindit.



SHEMBUJ TË PRAKTIKËS PROFESIONALE



- Ndhmon prindërit të dallojnë se si situata e krizës në familje është e ndërlidhur me nxënien dhe zhvillimin e nxënësve, dhe i këshillon se si të reagojnë në situata të caktuara.
- Informacionet për nxënien dhe sjelljen e nxënësit i ndan në mënyrë përkatëse me prindërit.
- Realizon konsultime individuale dhe grupore për mbështetjen e prindërve (mënyrë e komunikimit, mbështetje gjatë nxënies, motivim për nxënie dhe ngjashëm).

III. PUNË ME PRINDËR

Nën-fusha: EDUKIM I PRINDËRVE

BASHKËPUNËTORI PROFESIONAL...



A. KUPTIME DHE NJOHURI PROFESIONALE	B. AFTËSI DHE SHKATHTËSI PROFESIONALE
1. Njeh karakteristikat e nxënies së të rriturve dhe metodat dhe format e edukimit të të rriturve.	1.1 Njohuritë nga fusha e tij profesionale ua prezanton prindërve në mënyrë përkatëse.
2. Kupton nevojën e forcimit të kompetencave prindërore për zhvillim më të suksesshëm dhe përparim të fëmijëve.	2.1 Ndhmon prindërit që të zhvillojnë shkathtësi që nxisin në mënyrë më cilësore zhvillimin dhe nxënien e fëmijës së tyre.





SHEMBUJ TË PRAKTIKËS PROFESIONALE

- Merr pjesë në përpilimin e materialeve për edukim të prindërve (prezantime, broshura, fletushka, materiale të shkruara).
- Informon prindërit për shërbimet që shkolla dhe bashkëpunëtorët profesionalë i ofrojnë për mbështetjen e nxënësve.
- Identifikon nevojat e prindërve për edukim që ka të bëjë me rolin e tyre prindëror dhe mënyrat e komunikimit me fëmijët kur ju ofrojnë ndihmë gjatë nxënies.
- Organizon takime dhe/ose punëtori edukative me prindër (p.sh. lidhur me karakteristikat zhvillimore të fëmijëve, karakteristikat e nxënies, përballje me sjellje të rrezikshme të nxënësve, dhunë elektronike, motivim për nxënie, zhvillim dhe forcim të vetëbesimit, etj.)

III. PUNË ME PRINDËR

Nën-fusha: PËRFSHIRJE E PRINDËRVE NË JETËN DHE PUNËN E SHKOLLËS

BASHKËPUNËTORI PROFESIONAL...



A. KUPTIME DHE NJOHURI PROFESIONALE	B. AFTËSI DHE SHKATHTËSI PROFESIONALE
1. I di mënyrat e bashkëpunimit me familjen dhe mundësitë për pjesëmarrjen e tyre në jetën dhe punën e shkollës.	1.1 Promovon mirëbesim dhe mirëkuptim për ndërtimin e partneriteteve me familjet. 1.2 Motivon prindërit që të përfshihen në aktivitete të shkollës. 1.3 Zhvillon bashkëpunim efektiv me familjet.



SHEMBUJ TË PRAKTIKËS PROFESIONALE

- Planifikon dhe mundëson përfshirjen e prindërve në segmente të caktuara nga procesi edukativo-arsimor (mbrojtje shëndetësore, respektim dhe pranim i dallimeve, orientim profesional, veprimtari publike dhe kulturore, sipërmarrësi, etj.).
- Bashkëpunon me këshillin e prindërve me qëllim të përfshirjes më të madhe të prindërve në jetën dhe punën e shkollës.



IV. BASHKËPUNIM ME BASHKËSINË

Bashkëpunimi i bashkëpunëtorëve profesionalë me faktorët kryesorë nga bashkësia lokale kontribuon drejt përmirësimit të punës së shkollës, nga njëra anë, si dhe drejt përmirësimit të jetës në bashkësinë lokale, nga ana tjetër. Për bashkëpunim të suksesshëm është me rëndësi që bashkësia të jetë e informuar për punën e shkollës, rezultatet e arritura dhe nevojat e shkollës. Bashkëpunëtorët profesional duhet të jenë kompetentë për t'i përfshirë prindërit dhe komunitetin e biznesit, si më të interesuarit për të arritura më të larta të nxënësve, që të bashkëpunojnë me institucionet tjera edukativo-arsimore dhe institucionet nga sfera e kulturës, artit, shëndetësisë, që mund të kontribuojnë për ngritjen e cilësisë së punës së shkollës, për shëndetin, sigurinë dhe zhvillimin mental të nxënësve. Ata duhet t'i njohin mundësitë dhe potencialet që i ofron bashkësia lokale, të dinë të vlerësojnë se kur, pse dhe çfarë bashkëpunimi të vendosin, të krijojnë procedura dhe mekanizma për përfshirje, e gjithë kjo me qëllim që të përmirësohen dhe pasurohen programet për punën e shkollës. Për këtë qëllim, ndërtojnë partneritet me bashkësinë lokale, zhvillojnë ndjenjën për përkatësi, promovojnë reciprocitet, mirëbesim, respekt, mirëkuptim dhe profesionalizëm.

IV. BASHKËPUNIM ME BASHKËSINË

Nën-fusha: BASHKËPUNIM ME BASHKËSINË LOKALE

BASHKËPUNËTORI PROFESIONAL...



A. KUPTIME DHE NJOHURI PROFESIONALE	B. AFTËSI DHE SHKATHTËSI PROFESIONALE
1. Njeh mënyrat e bashkëpunimit me bashkësinë lokale dhe mundësitë për pjesëmarrjen e saj në jetën e shkollës. 2. I di potencialet e bashkësisë lokale për mbështetjen e shkollës.	1.1 Promovon bashkëpunim me bashkësinë lokale. 1.2 Kontribuon që vlerat e kulturave në bashkësi të reflektohen në të gjitha aspektet e punës së shkollës.



SHEMBUJ TË PRAKTIKËS PROFESIONALE



- Merr pjesë në planifikimin, realizimin dhe ndjekjen e aktiviteteve mes shkollës dhe bashkësisë me të cilat përmirësohen të arriturat e nxënësve (vizita, realizimi i aktiviteteve mësimore dhe jashtëmësimore).
- Prezanton dhe promovon punën e shkollës.
- Informon bashkësinë për nevojat dhe të arriturat e shkollës.
- Përfshihet në organizimin dhe realizimin e aktiviteteve parandaluese, humanitare dhe kulturore të bashkësisë lokale.
- Bashkëpunon me bashkësinë lokale gjatë përballjes me situata të krizës që prekin shkollën dhe bashkësinë lokale (fatkeqësi, epidemi, dhunë, dukuri kriminale dhe ngjashëm).
- Merr pjesë në planifikimin, realizimin dhe ndjekjen e aktiviteteve që promovojnë arsimin ndërkulturor.



IV. BASHKËPUNIM ME BASHKËSINË

Nën-fusha: BASHKËPUNIM ME INSTITUCIONE
DHE ORGANIZATA PROFESIONALE

BASHKËPUNËTORI PROFESIONAL...



A. KUPTIME DHE NJOHURI PROFESIONALE	B. AFTËSI DHE SHKATHTËSI PROFESIONALE
1. Kupton rëndësinë e bashkëpunimit me institucionet profesionale.	1.1 Zhvillon dhe shfrytëzon mënyra përkatëse për bashkëpunim me institucionet profesionale.
2. I di veprimtaritë e institucioneve të rëndësishme për punën në shkollë.	1.2 Promovon profesionalizëm, besim dhe respekt në ndërtimin e partneriteteve me institucionet profesionale.
3. Është i informuar për programe aktuale për të rinj që i realizon sektori joqeveritar.	2.1 Identifikon institucione relevante për bashkëpunim në fusha të caktuara.
	3.1 Identifikon dhe propozon fusha për bashkëpunimin të përbashkët me shoqata nga rrethi.



SHEMBUJ TË PRAKTIKËS PROFESIONALE



- Konsulton institucione gjatë punës me grup të caktuar të nxënësve, arsimtarëve, prindërve dhe për punën personale dhe i merr parasysh rekomandimet e tyre.
- Planifikon dhe realizon bashkëpunim me shkollat nga rajoni dhe më gjerë.
- Zhvillon projekte për zhvillimin e praktikës inkluzive (përfshirëse) në shkollë, në bashkëpunim me shoqatat e qytetarëve dhe institucionet qeveritare.
- Njofton dhe udhëzon nxënësit, arsimtarët dhe prindërit në institucione përkatëse për zgjidhjen e një problemi të caktuar.
- Bashkëpunon me shoqata të qytetarëve që realizojnë programe për fëmijë dhe të rinj.



V. ZHVILLIM PROFESIONAL DHE BASHKËPUNIM PROFESIONAL

Zhvillimi profesional dhe në karrierë i bashkëpunëtorëve profesional në praktikën edukativo-arsimore paraqet pjesën integrale të punës së tyre. Ata, vazhdimisht i zhvillojnë njohuritë pedagogjike-psikologjike, sociologjike, defektologjike dhe sociale për t'i zbatuar në punën e tyre dhe për të kontribuar për zhvillimin profesional të kuadrit tjetër edukativo-arsimor. Bashkëpunëtorët profesional punojnë në mënyrë aktive në zhvillim personal, i dinë të drejtat, përgjegjësitë dhe kodeksin etik të profesionit, zhvillojnë dhe realizojnë shkathtësi refleksive për analizimin dhe përmirësimin e praktikës personale, planifikojnë zhvillimin personal profesional dhe marrin pjesë në forma të ndryshme të zhvillimit profesional në dhe jashtë shkollës, mbajnë evidencë për zhvillimin personal profesional. Janë anëtarë dhe marrin pjesë në punën dhe aktivitetet e shoqatave profesionale.

Bashkëpunëtorët profesional kanë rol të rëndësishëm në mbështetjen e zhvillimit profesional në nivel të shkollës, veçanërisht në identifikimin e nevojave të arsimtarëve, planifikimin dhe organizimin e formave të ndryshme të zhvillimit profesional në shkollë dhe vëzhgimin e efekteve.

V. ZHVILLIM PROFESIONAL DHE BASHKËPUNIM PROFESIONAL

Nën-fusha: ZHVILLIMI PERSONAL PROFESIONAL

BASHKËPUNËTORI PROFESIONAL...



A. KUPTIME DHE NJOHURI PROFESIONALE	B. AFTËSI DHE SHKATHTËSI PROFESIONALE
1. Kupton ndërlíkueshmërinë e profesionit bashkëpunëtor profesional, si dhe të drejtat dhe përgjegjësitë që i sjellë ai.	1.1 Njohuritë e fituara përmes zhvillimit profesional (arsimi dhe nxënia formale, joformale dhe informale) i shfrytëzon për avancimin e praktikës personale.
2. Kupton rëndësinë e zhvillimit personal profesional.	2.1 Identifikon nevojat për zhvillim personal profesional duke i shfrytëzuar standardet dhe rezultatet nga vetëreflektimi i punës personale.
3. Njeh kompetencat dhe standardet për bashkëpunëtorët profesional.	
4. Di si të përpilojë plan personal për zhvillim profesional.	
5. I di mënyrat dhe mundësitë efektive për zhvillim personal dhe profesional.	5.1 Zhvillon dhe zbaton shkathtësi refleksive për analizim, vetëvlerësim dhe përmirësim të praktikës personale.
6. Kupton dhe respekton filozofinë e nxënies së përgjeshme.	6.1 Ndryshimet dhe risitë në profesionin personal i zbaton në punë.
7. Është i informuar për shoqatat profesionale të bashkëpunëtorëve profesional.	7.1 Bashkëpunon me bashkëpunëtorët profesional dhe me shoqatat profesionale në dhe jashtë shkollës.
8. Njeh kodeksin etik të profesionit.	



SHEMBUJ TË PRAKTIKËS PROFESIONALE



- Vendosë risi në punën personale dhe bën vlerësimin e efektivitetit të tyre.
- Planifikon, mban evidencë dhe posedon dëshmi (plan personal, certifikata, trajnime të vizituara dhe realizuara, shënime nga vetëreflektimi dhe ngjashëm) për zhvillimin personal profesional.
- Merr pjesë në forma të ndryshme të zhvillimit profesional në dhe jashtë shkollës.
- Ndjekë literaturën profesionale dhe informacionet e rëndësishme për arsimin dhe edukimin.
- Merr pjesë në aktivitete të ndryshme të shoqatave profesionale, rrjeteve dhe forumeve sociale me qëllim që ta përmirësojë punën e tij.
- Sillet në pajtim me kodeksin etik të profesionit.

V. ZHVILLIM PROFESIONAL DHE BASHKËPUNIM PROFESIONAL

Nën-fusha: MBËSHTETJE E ZHVILLIMIT
DHE BASHKËPUNIMIT PROFESIONAL NË SHKOLLË

BASHKËPUNËTORI PROFESIONAL...




A. KUPTIME DHE NJOHURI PROFESIONALE	B. AFTËSI DHE SHKATHTËSI PROFESIONALE
1. Kupton rëndësinë e zhvillimit profesional për përmirësimin e punës në shkollë.	1.1 Promovon në mënyrë aktive marrëdhënie profesionale dhe kolegjinale dhe bashkëpunon me kolegët. 1.2 Kontribuon për zhvillimin profesional të kuadrit edukativo-arsimor në shkollë.
2. Është i informuar për ngjarjet profesionale në arsim.	2.1 Motivon arsimtarët që të zhvillohen në mënyrë profesionale dhe krijojnë mjedis nxitës në të cilin mësojnë të gjithë.
3. Njeh metodat dhe format e zhvillimit profesional.	3.1 Planifikon zhvillimin profesional në bazë të analizimit të nevojave të arsimtarëve.
4. Di si planifikohet zhvillimi profesional i arsimtarëve.	4.1 Realizon forma të ndryshme të edukimit me kuadrin edukativo-arsimor.



SHEMBUJ TË PRAKTIKËS PROFESIONALE



- Merr pjesë në punën e ekipit për zhvillim profesional në shkollë.
- Merr pjesë në realizimin e pjesëve të programit për arsimtarë të cilët kanë nevojë për përkrahje.
- Informon dhe bën diseminimin e njohurive dhe shkathtësive të fituara nga trajnimet e ndjekura.
- Ndihmon aktivet profesionale në përgatitjen dhe realizimin e përmbytjeve të caktuara të punës së tyre.
- Shkëmbejnë materiale profesionale me kolegët.
- Udhëzon arsimtarët që të shfrytëzojnë resurse të ndryshme për modernizimin e procesit mësimor.
- Bashkëpunon me profesionistë dhe ekspertë për shkak të ngritjes së njohurive profesionale për arsimtarët.
- Përgatitë instrumente, grumbullon të dhëna, analizon nevojat për zhvillim profesional të arsimtarëve.
- Propozon tema për trajnim në shkollë.
- Ndihmon arsimtarët që t'i identifikojnë nevojat e tyre dhe të përpilojnë plan personal për zhvillim profesional.
- Shkëmbejnë përvoja dhe shfrytëzojnë këshilla për përmirësimin e punës së tij.
- Realizon forma të ndryshme të zhvillimit intern profesional me arsimtarët (ligjërata, punëtori, etj.) për përmbytje që janë specifike për fushën e tij më të ngushtë profesionale.



VI. PUNË ANALITIKE-HULUMTUESE

Bashkëpunëtorët profesional promovojnë avancimin e punës edukativo-arsimore që është mbështetur në njohuri shkencore dhe në të dhëna nga analizat dhe hulumtimet e situatave në një shkollë konkrete. Bashkëpunëtorët kompetentë profesional posedojnë njohuri dhe shkathtësi për punë analitike-hulumtuese e cila përfshin: grumbullim të rregullt të të dhënave, vlerësim dhe analizë të të gjitha segmenteve dhe subjekteve në procesin edukativo-arsimor. hulumtim të disa dukurive të caktuara që paraqiten si faktorë lëvizës ose faktorë që pengojnë cilësinë e punës, si dhe vlerësim të vazhdueshëm të procesit dhe të arriturve për shkak të avancimit të punës.

Ata dinë të identifikojnë çështje relevante për shkollën që duhet të jenë të analizuar dhe hulumtuara, ndërsa njohin edhe metoda dhe teknika përkatëse për grumbullimin e të dhënave për matjen e efekteve nga aktivitetet e ndërmarra. Puna analitike-hulumtuese është fushë në veprimtarinë e bashkëpunëtorëve profesional, ku vijnë në shprehje aftësitë e tyre për analizë dhe sintezë, aftësitë organizative dhe aftësia për punë ekipore. Gjatë vëzhgimit, mbledhjes dhe ruajtjes së të dhënave, vlerësimit dhe analizës, ata u përmbahen parimeve ligjore, shkencore dhe etike për raport të përgjegjshëm ndaj të dhënave dhe ndaj shfrytëzimit të tyre.

Bashkëpunëtorët profesional në pajtim me kompetencat e tyre bëjnë vëzhgimin objektiv, mbledhjen dhe klasifikimin sistematik të të dhënave, vëzhgimin dhe analizimin sistematik të procesit edukativo-arsimor, por me status, detyra, forma dhe nivele të ndryshme të pjesëmarrjes dhe angazhimit. Në të shumtën e rasteve ata janë koordinatorë të analizave të rregullta që bëhen në nivel të shkollës, iniciues dhe bartës të hulumtimeve sistemore dhe vepruese, ndërsa bashkëpunëtorë ose pjesëmarrës në hulumtime të kryesuara prej institucioneve profesionale/shkencore.

Bashkëpunëtorët profesional në punën analitike-hulumtuese në të shumtën e rasteve punojnë në mënyrë ekipore dhe në bashkëpunim me arsimtarët, ndërsa angazhimi i tyre është i përcaktuar nga profesionalizmi i tyre më i ngushtë.

VI. PUNË ANALITIKE-HULUMTUESE

Nën-fusha: ANALIZË DHE VLERËSIM I PUNËS
EDUKATIVO-ARSIMORE

BASHKËPUNËTORI PROFESIONAL...



A. KUPTIME DHE NJOHURI PROFESIONALE	B. AFTËSI DHE SHKATHTËSI PROFESIONALE
1. Di se çfarë dokumentacioni për punën edukativo-arsimore udhëhiqet në shkollën.	1.1 Kontribuon që të vendoset sistem për analiza të rregullta të çështjeve të caktuara edukativo-arsimore në shkollë.
2. Njeh metodologjinë për analizën e dokumentacionit.	1.2 Angazhohet që rezultatet nga analizat të shfrytëzohen për avancimin e procesit edukativo-arsimor.
3. Njeh mënyrat për interpretimin dhe informimin e rezultateve nga analiza.	2.1 Ndërlidhë, përpunon dhe analizon të dhëna të ndryshme për punën edukativo-arsimore dhe nxjerrë konstatime nga analizat.



SHEMBUJ TË PRAKTIKËS PROFESIONALE

- Merr pjesë në përpilimin e instrumenteve (protokoll, lista evidentimi, formularë) për mbledhjen e të dhënave.
- Shpërndan/prezanton informacionet e fituara nga vlerësimi dhe analiza me/e të punësuar-it/ve, prindërit, bashkësinë, organet dhe trupat profesionale, institucionet kompetente.
- Bën analiza dhe raporte, në mënyrë individuale ose në bashkëpunim me kolegët, për situatat në fusha të ndryshme të punës edukativo-arsimore.
- Bën kontrolle, analiza (krahasuese, të tendencave) dhe raporte për suksesin, sjelljen, rregullsinë, përfshirjen dhe përparimin e nxënësve, gjendjen sociale dhe nevojat e nxënësve, etj.
- Shkruan raporte të qarta, analiza, shqyrtime dhe materiale tjera profesionale dhe në mënyrë përkatëse i integron dhe sintetizon njohuritë e fituara.



VI. PUNË ANALITIKE-HULUMTUESE

Nën-fusha: HULUMTIM I PUNËS EDUKATIVO-ARSIMORE

BASHKËPUNËTORI PROFESIONAL...




A. KUPTIME DHE NJOHURI PROFESIONALE	B. AFTËSI DHE SHKATHTËSI PROFESIONALE
1. Ka njohuri themelore nga metodologjia e hulumtimit në arsimin dhe bazat e statistikës deskriptive.	1.1 Angazhohet që përparimi i punës edukativo-arsimore të mbështetet në hulumtime dhe fakte. 1.2 Analizon dhe interpreton të dhëna nga hulumtimet e realizuara. 1.3 Shfrytëzon rezultatet e hulumtimeve në praktikën personale.
2. Njeh teknika të ndryshme për mbledhjen e informacioneve për praktikën edukativo-arsimore.	2.1 Realizon hulumtime të çështjeve aktuale për shkollën.
3. Njeh metodat për analizë sasiore dhe cilësore të të dhënave.	3.1 Analizon të dhënat e hulumtimeve sasiore dhe cilësore. 3.2 Shfrytëzon programe për përpunimin statistikor të të dhënave.
4. I di mënyrat e interpretimit dhe informimit përkatës për rezultatet e hulumtimit.	4.1 Interpreton të dhëna prej llojeve të ndryshme të hulumtimeve.



SHEMBUJ TË PRAKTIKËS PROFESIONALE

- Identifikon probleme për zgjidhjen e të cilave nevojiten të dhëna të fituara me hulumtim.
- Shpërndan/prezanton njohuritë e fituara nga hulumtimet para shfrytëzuesve të ndryshëm (të punësuarve, prindërve, bashkësisë, organeve dhe trupave profesionale, institucioneve kompetente).
- Ofron propozime dhe sugjerime për përmirësimin e praktikës në bazë të njohurive nga hulumtimet.
- Përpilon projekte dhe plane për hulumtim.
- Përzgjedhë metoda dhe përzgjedhë/përpilon instrumente përkatëse për problemin që hulumtohet.
- Realizon intervista, anketime, testime të njohurive, vëzhgime sistematike.
- Bën përpunimin, analizën statistikore të të dhënave dhe interpretimin e rezultateve.
- Harton raport nga hulumtimi i realizuar.



VII. STRUKTURË, ORGANIZIM DHE KLIMË SHKOLLORE

Bashkëpunëtorët kompetent profesional posedojnë njohuri dhe kuptime për sistemin e arsimit dhe për sistemin e shkollës, kanë njohuri të gjera për zhvillimin fizik, social, emocional dhe kognitiv të fëmijëve dhe i vëzhgojnë hulumtimet dhe të arriturat më të reja në fushën e tyre.

Për shkak të pozicionit dhe mundësisë për të pasur shqyrtim në punën e përgjithshme të shkollës, ata janë të përfshirë dhe intervenojnë në thuajse të gjitha segmentet e punës së shkollës, bashkojnë të gjithë faktorët në punën edukativo-arsimore në shkollë drejt realizimit të qëllimeve të përbashkëta, vëzhgojnë proceset që ndodhin, ofrojnë këshilla dhe rekomandime për punë më të suksesshme dhe marrin pjesë në ndërtimin, zhvillimin dhe vlerësimin e programeve, procedurave dhe praktikave që mundësojnë funksionim dhe zhvillim të mirë të shkollës.

Pjesëmarrja e tyre në punën e shkollës vërehet veçanërisht në pjesën e ndërtimit të klimës pozitive dhe krijimin e mjedisit të sigurt, stimulues dhe efektiv për nxënie dhe zhvillim të nxënësve dhe pjesëmarrjen e tyre demokratike në punën dhe jetën e shkollës. Në punën e tyre, respektojnë dhe realizojnë parimet e mosdiskriminimit, barazisë dhe drejtësisë ndaj të gjithë nxënësve. Synojnë zhvillimin dhe realizimin e politikës inkluzive (përfshirëse) në mjedisin e tyre punues, si dhe respektim të multikulturalizmit si bazë për respektin e ndërsjellë.

Paraqesin model për nxënësit dhe arsimtarët me mënyrën e tyre të komunikimit, sjelljen etike, tolerancën, bashkëpunimin me tjerët dhe përkushtimin në punë.

VII. STRUKTURË, ORGANIZIM DHE KLIMË SHKOLLORE

**Nën-fusha: STRUKTURË DHE ORGANIZIM SHKOLLOR
(PLANIFIKIM, VËZHGIM I PUNËS EDUKATIVO-ARSIMORE,
EVIDENCË DHE DOKUMENTACION PEDAGOGJIK, EVALVIM)**

BASHKËPUNËTORI PROFESIONAL...



A. KUPTIME DHE NJOHURI PROFESIONALE	B. AFTËSI DHE SHKATHTËSI PROFESIONALE
1. Njeh sistemin arsimor, veçanërisht nënsistemin e arsimit në të cilin punon, si dhe aktet me të cilat është rregulluar.	1.1 Udhëhiqet sipas parimeve të përgjithshme të sistemit të edukatës dhe arsimit.
	1.2 Evalvon dhe vlerëson punën e shkollës.
2. Kupton tendencat bashkëkohore arsimore.	2.1 Vëzhgon procesin edukativo-arsimor dhe propozon masa për përparim.
3. Është i informuar për zhvillimet aktuale në arsimin në vend.	3.1 Promovon inovacione/risi në punën edukativo-arsimore në përputhje me parimet e mësimdhënies dhe nxënies të shekullit 21.
4. E di sistemin e organizmit dhe funksionimit të shkollës.	4.1 Promovon veprim sistematik dhe përgjegjësi në punën e shkollës.
5. Njeh dokumentet me të cilat është rregulluar puna e shkollës.	
6. I di nevojat dhe prioritetet e shkollës.	



SHEMBUJ TË PRAKTIKËS PROFESIONALE



- Është i përfshirë në procesin e vetëvlerësimit të shkollës.
- Merr pjesë në përpilimin e instrumenteve për vetëvlerësim të shkollës dhe punës personale.
- Përpilon dhe arsyeton nisma për modernizimin e punës edukativo-arsimore.
- Merr pjesë në përpilimin e programit zhvillimor për punën e shkollës.
- Merr pjesë në organizimin e punës në shkollë (orar, kalendar, shpërndarje e nxënësve, planifikim dhe programim, etj.).
- Merr pjesë në punën e organeve dhe trupave profesionale në shkollë.
- Mban evidencë për punën me nxënësit dhe prindërit dhe e ruan në vend të sigurt.

VII. STRUKTURË, ORGANIZIM DHE KLIMË SHKOLLORE

Nën-fusha: KLIMË SHKOLLORE, MJEDIS I SIGURT DHE PJESËMARRJE DEMOKRATIKE E NXËNËSVE

BASHKËPUNËTORI PROFESIONAL...



A. KUPTIME DHE NJOHURI PROFESIONALE	B. AFTËSI DHE SHKATHTËSI PROFESIONALE
1. Njeh parimet për krijimin e klimës pozitive në shkollë.	1.1 Nxitë bashkëpunim në mes të gjithë faktorëve në shkollë për krijimin e mjedisit të sigurt dhe klimës pozitive. 1.2 Zhvillon ndjenjën për përkatësi, respekt të ndërsjellë dhe kontribut ndaj bashkësisë shkollore.
2. E di rëndësinë e përfshirjes së të gjithë nxënësve në procesin arsimor.	2.1 Kontribuon për klimë inkluzive (përfshirëse) në shkollë.
3. I di konventat për të drejtat e fëmijëve dhe kundër diskriminimit.	3.1 Promovon vlera që kanë të bëjnë me pranimin e diversitetit, tolerancës dhe sjelljes së padhunshme.
4. I di mundësitë e paraqitjes dhe rreziqet nga diskriminimi në të gjitha bazat.	4.1 Krijon klimë të pranimit dhe mosdiskriminimit.
5. I di mundësitë e paraqitjes dhe rreziqet nga qasja jo e balancuar gjinore ndaj nxënësve dhe nxënësve.	
6. I di kërcënimet e mundshme për sigurinë fizike dhe psikike të nxënësve.	6.1 Identifikon kërcënimet e mundshme për sigurinë që janë specifike për shkollën dhe për popullatën konkrete në shkollë.
7. E di rëndësinë e pjesëmarrjes së nxënësve në marrjen e vendimeve që janë në interes të jetës së tyre në shkollë.	7.1 Nxitë ndjenjën e përgjegjësisë dhe angazhimit të nxënësit.
8. Kupton rëndësinë e sigurimit të atmosferës dhe kushteve përkatëse për shprehje të lirë konstruktive të mendimit të nxënësve për jetën në shkollë.	8.1 Siguron atmosferë dhe kushte përkatëse për pjesëmarrje demokratike të nxënësve në jetën e shkollës.
	8.2 Ndhmon nxënësit në proceset e informimit, formimit dhe shprehjes së mendimit, marrjes së vendimeve dhe ndërmarrjes së veprimit përkatës, për çështje që për ta janë relevante nga jeta në shkollë, e që janë në interes të tyre.
9. I di parimet dhe mekanizmat për pjesëmarrje demokratike të nxënësve në jetën e shkollës, si dhe për formimin e bashkësisë shkollore të mbështetur në baza demokratike.	9.1 Ndhmon nxënësit dhe arsimtarët në formimin e bashkësisë së nxënësve në baza demokratike
	9.2 Promovon vlera që kanë të bëjnë me sigurinë personale dhe sigurinë e tjerëve.





SHEMBUJ TË PRAKTIKËS PROFESIONALE

- Inicion dhe realizon aktivitete për promovimin e të arriturave të të punësuarve dhe nxënësve.
- Është anëtar i ekipit për parandalimin e dhunës në shkollë.
- Organizon nxënësit në aktivitete të përbashkëta ku vjen në shprehje bashkëpunimi mes moshatarëve.
- Zhvillon programe që kanë të bëjnë me përfshirjen sociale dhe arsimore.
- Merr pjesë në organizmin e aksioneve humanitare për t'u ndihmuar nxënësve nga kategoritë e ndjeshme sociale.
- Identifikon rastet e diskriminimit dhe pabarazisë në shkollë dhe ndërmerr veprim përkatës.
- Parandalon raste të diskriminimit në shkollë.
- Sensibilizon arsimtarët dhe nxënësit për barazinë gjinore.
- Ndërmerr aktivitete për mënjanimin e kërcënimeve të mundshme (propozon masa sistemore, parandalon, këshillon, etj.).
- Planifikon dhe organizon aktivitete për pjesëmarrje demokratike të nxënësve në jetën e shkollës dhe i prezanton efektet nga to.
- Merr pjesë në punën e organizatave dhe klubeve të nxënësve.
- Sensibilizon shkollën përmes prezantimit të njohurive shkencore për efektet pozitive nga shprehja e lirë e mendimit në zhvillimin e nxënësve.
- Bën analiza dhe jep sugjerime për shfrytëzimin e mundësive të ndryshme për pjesëmarrje të nxënësve.
- Organizon debate, diskutime, etj. në temën pjesëmarrja demokratike e nxënësve.
- Punon me individë dhe grupe të nxënësve në tejkalimin e barrierave për shprehje të mendimit dhe pjesëmarrje.
- Merr pjesë në organizmin dhe realizimin e aktiviteteve sociale në shkollë.
- Punon me bashkësitë e nxënësve në nivel të shkollës.
- Merr pjesë në punën e organizatave dhe klubeve të nxënësve.
- Ofron ndihmë përkatëse këshillëdhënëse në situata të kërcënimeve ose rrezikimit të shëndetit ose sigurisë së nxënësve.

KOMPETENCA SPECIFIKE PËR PEDAGOG

| PUNË ME ■ NXËNËS

PEDAGOGU kryesisht vepron në drejtim të krijimit të praktikës efektive arsimore dhe zhvillimit të teknikave dhe metodave përkatëse për përmirësimin e procesit të nxënies. Duke respektuar nevojat dhe karakteristikat individuale të nxënësve, pedagogu i këshillon, edukon dhe u ndihmon atyre që të përmirësojnë mënyrën e nxënies dhe sjelljes. Ai praktikon metoda dhe mjete për punë edukative me nxënësit. Zbaton modele bashkëkohore të udhëheqjes pedagogjike në situata të ndryshme edukative në shkollë. Realizon punë edukativo-këshillëdhënëse me nxënësit për tejkalimin e arsyeve për problemet në nxënie dhe sjellje. U ndihmon nxënësve në përzgjedhjen e aktiviteteve të lira në përputhje me interesat e tyre.

I. PUNË ME NXËNËS

Nën-fusha: MBËSHTETJE E NXËNËSVE GJATË NXËNIES

PEDAGOGU...



A. KUPTIME DHE NJOHURI PROFESIONALE	B. AFTËSI DHE SHKATHTËSI PROFESIONALE
1. Njeh parimet e punës në punëtori.	1.1 Ka shkathtësi për moderimin e punëtorive pedagogjike.
2. Njeh teknikat efektive për nxënie.	2.1 Ndhmon nxënësit që t'i zhvillojnë shkathtësitë për nxënie të pavarur.
3. Njeh strategji përkatëse për mësimdhënie.	3.1 Përzgjedh dhe zbaton shkathtësitë e duhura për mësimdhënie.



SHEMBUJ TË PRAKTIKËS PROFESIONALE



- Realizon punëtori për përmirësimin e nxënies së nxënësve (p.sh. Stilet e nxënies, teknikat e nxënies, etj.).
- Mëson nxënësit si të mësojnë në mënyrë individuale dhe/ose grupe.
- Përgatitë, përshtatë, propozon dhe zbaton strategji përkatëse për mësimdhënie.
- Merr pjesë në përshtatjen e përmbajtjeve mësimore për nxënës konkret në pajtim me nevojat dhe mundësitë e tyre.

I. PUNË ME NXËNËS

Nën-fusha: VËZHGIM DHE MBËSHTETJE E ZHVILLIMIT TË NXËNËSVE

PEDAGOGU... 

A. KUPTIME DHE NJOHURI PROFESIONALE	B. AFTËSI DHE SHKATHTËSI PROFESIONALE
1. E di se ç 'janë kriza zhvillimore dhe të situatave, si dhe njeh mënyrat e përbaljes me të njëjtat.	1.1 Identifikon dhe reagon në mënyrë përkatëse ndaj situatave të krizës të nxënësve. 1.2 Shfrytëzon strategji për t'u përballur me sjelljen joadekuate të nxënësve.
2. I di parimet, modelet dhe format për shfrytëzimin e kohës së lirë të nxënësve në shkollë.	2.1 Ofron mbështetje në organizmin dhe realizimin e aktiviteteve jashtëmësimore të nxënësve në shkollë.
3. I di parimet, metodat dhe mjetet e punës edukative.	3.1 Ka shkathtësi për zgjidhjen e situatave edukative me zbatimin e modeleve bashkëkohore për udhëheqje pedagogjike.



SHEMBUJ TË PRAKTIKËS PROFESIONALE



- Ndihmon nxënësit për tu përballuar me situata të krizës (sëmundje, vdekje, shkurorëzim, dhuna në familje, etj.).
- Mbledhë të dhëna për zhvillimin personal dhe social të nxënësve (përmes vëzhgimit, intervistave, anketimit, fokus grupeve).
- Mbledhë informacione për punën dhe sjelljen e nxënësve përmes vëzhgimit të mësimdhënies.
- Realizon punëtori dhe aktivitete tjera me nxënës për parandalimin e temave të ndryshme që kanë të bëjnë me shëndetin fizik dhe mental (p.sh. varshmëri, dieta, përbalje me stres, përbalje me dhunë, sjellje asociiale, përbalje me diskriminim, shtatzëni e padëshiruar, etj.).
- Intervenon gjatë sjelljes së papërshtatshme të nxënësve.
- Informon nxënësit për aktivitetet jashtëmësimore në shkollë.
- Merr pjesë dhe ofron mbështetje në identifikimin e dëshirave dhe interesave specifike të nxënësve për realizimin e aktiviteteve të lira në shkollë.
- Merr pjesë në identifikimin e dëshirave dhe interesave specifike të nxënësve për pjesëmarrje në aktivitete jashtëmësimore.
- Merr pjesë në realizimin e një pjese të aktiviteteve jashtëmësimore.
- Realizon aktivitete për praktikimin e demokracisë në shkollë.
- Këshillon dhe vëzhgon nxënësit përmes nxitjes, parandalimit, bindjes, sigurimit dhe bisedës
- Shfrytëzon restitucionin gjatë punës edukative.

II. PUNË ME ARSIMTARË

PEDAGOGU u ndihmon veçanërisht arsimtarëve gjatë: planifikimit të aktiviteteve mësimore dhe jashtëmësimore me ç'rast i merr si bazë planifikimet paraprake dhe rezultatet e të arriturave të nxënësve, realizimin e mësimit me shfrytëzimin e metodave, formave, aktiviteteve, mjeteve/resurseve përkatëse bashkëkohore, notimin e nxënësve me qëllim që të mbështetet nxënia, udhëheqjen e evidencës dhe dokumentacionit pedagogjik, organizimin e mbledhjeve prindërore dhe vetëvlerësimin e punës së arsimtarëve.

II. PUNË ME ARSIMTARË

Nën-fusha: MBËSHTETJE E ARSIMTARËVE GJATË PLANIFIKIMIT DHE REALIZIMIT TË PROCESIT EDUKATIVO-ARSIMOR DHE VETËVLERËSIMIT

PEDAGOGU...




A. KUPTIME DHE NJOHURI PROFESIONALE	B. AFTËSI DHE SHKATHTËSI PROFESIONALE
1. I di parimet dhe metodat e mësimit efektiv.	1.1 Ofron ndihmë profesionale në përgatitjen dhe realizimin e mësimit interaktiv.
2. Posedon njohuri për kontrollin ekstern dhe intern e të arriturave të nxënësve.	2.1 Ofron ndihmë profesionale në përgatitjen dhe realizimin e kontrollit ekstern dhe intern të të arriturave të nxënësve.
3. I di metodat bashkëkohore dhe të ndryshme të vëzhgimit dhe notimit, si dhe mundësitë dhe kufizimet e tyre.	3.1 Ndhmon arsimtarët që të përzgjedhin dhe përgatisin instrumente për vlerësimin dhe vetëvlerësimin e të arriturave të nxënësve dhe t'i shfrytëzojnë ato në mënyrë përkatëse.
4. Njeh standardet e parashikuara për notim formativ dhe sumativ.	
5. Njeh metodologjinë për vlerësimin e librave shkollor.	5.1 Vlerëson aspektet pedagogjike të librave shkollorë.
6. Njeh qasje të reja në mësimdhënie.	6.1 Promovon qasje inovative në mësim.
7. Njeh metoda dhe teknika për mbështetjen e arsimtarëve gjatë vetëvlerësimit të punës mësimore.	7.1 Promovon kulturë të vetëvlerësimit si bazë për avancimin e mësimit.



SHEMBUJ TË PRAKTIKËS PROFESIONALE

- Realizon punëtori dhe konsultime individuale për sigurimin e pjesëmarrjes aktive të nxënësve në mësim (p.sh. Parashtrim të pyetjeve, hulumtime, respektim të interesave të nxënësve, etj.).
- Informon arsimtarët për lloje të ndryshme të testimeve eksterne (qëllime, lloje të detyrave, mënyra të realizimit).
- Ndhmon arsimtarët të sigurohen që nxënësit të përvetësojnë përvoja për llojet e ndryshme të provimeve (gojore, teste, praktike).
- Jep udhëzime për dokumentimin e të arriturve të nxënësve (konsultime grupore ose individuale).
- Realizon punëtori për notim cilësor.
- Jep udhëzime për përzgjedhjen e metodave përkatëse dhe për përpilimin dhe shfrytëzimin e instrumenteve për notimin e të arriturve të nxënësve.
- Merr pjesë në grupe punuese për përzgjedhjen e librave shkollor dhe burimeve tjera të njohurisë.
- Udhëzon arsimtarët për mënyrat e shfrytëzimit të instrumenteve dhe procedurave për vlerësimin e librave shkollor.
- Përgatitë dhe realizon orë të hapura, me qëllim të demonstrimit të formave dhe organizmit bashkëkohor të mësimin dhe nxënies, metodave dhe mjeteve të punës.
- Përpilon instrumente për vetëvlerësim në mësim.
- Ndhmon dhe mbështetë arsimtarët në procesin e vetëvlerësimit në mësimdhënie.
- Udhëzon arsimtarët se si t'i përdorin rezultatet nga vetëvlerësimi i mësimdhënies.



II. PUNË ME ARSIMTARË

Nën-fusha: MBËSHTETJE E ARSIMTARËVE GJATË PUNËS ME NXËNËS

PEDAGOGU... 


A. KUPTIME DHE NJOHURI PROFESIONALE	B. AFTËSI DHE SHKATHTËSI PROFESIONALE
1. I di procedurat për identifikimin e nxënësve të talentuar. 2. I di mënyrat e punës me nxënës me karakteristika të ndryshme personale.	1.1 Ndërlidhë karakteristikat e nxënësve me mënyrat përkatëse të punës me nxënës.



SHEMBUJ TË PRAKTIKËS PROFESIONALE



- Këshillon arsimtarët se si t'i identifikojnë nxënësit e talentuar.
- Propozon ose bashkë me arsimtarin përpilon mënyra të nxitjes së aftësive të posaçme të nxënësve të talentuar dhe motivimit të nxënësve për pjesëmarrje në gara dhe konkurse me karakter të ndryshëm.
- Sqaron dhe demonstroi mënyrat në të cilat mund t'i jepet ndihmë nxënësve për shfrytëzimin e qasjeve të ndryshme në nxënie.



III. PUNË ME PRINDËR

PEDAGOGU u ndihmon veçanërisht prindërve lidhur me llojin dhe mënyrat e mbështetjes që duhet t'ia sigurojnë fëmijës në procesin e nxënies, me qëllim që ai të arrijë potencialin e vet, si dhe në raport me edukimin e fëmijëve në shtëpi (shprehi për nxënie, shfrytëzim të kohës së lirë, mënyra të komunikimit me fëmijët).

III. PUNË ME PRINDËR

Nën-fusha: KËSHILLIME DHE KONSULTIME INDIVIDUALE DHE GRUPORE ME PRINDËR

PEDAGOGU...



A. KUPTIME DHE NJOHURI PROFESIONALE	B. AFTËSI DHE SHKATHTËSI PROFESIONALE
1. I di mënyrat e mbështetjes së prindërve gjatë punës me fëmijë me nevoja të posaçme arsimore.	1.1 Ndhmon prindërit e fëmijëve me nevoja të posaçme arsimore që ta kuptojnë gjendjen e fëmijëve të tyre dhe t'ua ofrojnë ndihmën dhe mbështetjen e nevojshme.
2. I di format dhe metodat për konsultim efektiv të prindërve.	2.1 Shfrytëzon metoda të ndryshme për konsultime individuale dhe grupe të prindërve.



SHEMBUJ TË PRAKTIKËS PROFESIONALE



- Informon prindërit e fëmijëve me nevoja të posaçme arsimore për të drejtat, obligimet dhe ndihmën që mund të marrin dhe i udhëzon drejt institucioneve relevante për ndihmë.
- Realizon konsultime individuale me prindërit për mbështetjen e fëmijëve me nevoja të posaçme arsimore.
- Organizon dhe realizon konsultime grupe dhe individuale me prindërit, fëmijët e të cilëve përballen me mospajtim gjatë nxënies, ndjekje të parregullt të mësimin dhe sjellje të papërshtatshme.

IV. BASHKËPUNIM ME BASHKËSINË

PEDAGOGU i ka në fokusin e bashkëpunimit institucionet arsimore, shëndetësore, sociale, shkencore, kulturore dhe institucionet tjera që mund të kontribuojnë në nxënien dhe zhvillimin më cilësor të nxënësve. Bashkëpunon me institucionet shkencore dhe arsimore në hulumtime dhe vendosje të qasjeve inovative në punën edukativo-arsimore.

IV. BASHKËPUNIM ME BASHKËSINË

Nën-fusha: **BASHKËPUNIM ME BASHKËSINË LOKALE**

PEDAGOGU...



A. KUPTIME DHE NJOHURI PROFESIONALE	B. AFTËSI DHE SHKATHTËSI PROFESIONALE
1. Është i informuar për ndërmarrjet përkatëse në të cilat mund të realizohet mësimi praktik.	1.1 Ndërlidhë karakteristika e nxënësve me format e mësimi praktik.



SHEMBUJ TË PRAKTIKËS PROFESIONALE



- Përfshihet në procesin e planifikimit, organizimit dhe ndjekjes së mësimi praktik në shkollat e mesme profesionale.

V. ZHVILLIM PROFESIONAL DHE BASHKËPUNIM PROFESIONAL

PEDAGOGU ka rol të posaçëm në përpilimin e programit për punë të arsimtarëve fillestar dhe në procesin e mentorimit të tyre. Pedagogët, po ashtu, vëzhgojnë efektet dhe mbajnë dokumentacion për zhvillimin profesional të kuadrit edukativo-arsimor.

V. ZHVILLIM PROFESIONAL DHE BASHKËPUNIM PROFESIONAL

Nën-fusha: MBËSHTETJE E ZHVILLIMIT DHE BASHKËPUNIMIT PROFESIONAL NË SHKOLLË

PEDAGOGU...



A.	KUPTIME DHE NJOHURI PROFESIONALE	B.	AFTËSI DHE SHKATHTËSI PROFESIONALE
1.	Njeh kompetencat themelore profesionale për arsimtarë.	1.1	Format dhe përmbajtjet e zhvillimit profesional i ndërlidhë me kompetencat e nevojshme të arsimtarëve.



▶	SHEMBUJ TË PRAKTIKËS PROFESIONALE
	- Udhëheqë dokumentacion për zhvillimin profesional të arsimtarëve.

VI. PUNË ANALITIKE-HULUMTUESE

PEDAGOGU vëzhgon, analizon dhe hulumton kryesisht procesin edukativo-arsimor në aspekt më të gjerë dhe në bazë të njohurive nga analizat dhe hulumtimet propozon masa për avancimin e mësimit dhe forma tjera të punës edukativo-arsimore në institucionin.

VI. PUNË ANALITIKE-HULUMTUESE

Nën-fusha: HULUMTIM I PUNËS EDUKATIVO-ARSIMORE

PEDAGOGU...



A. KUPTIME DHE NJOHURI PROFESIONALE	B. AFTËSI DHE SHKATHTËSI PROFESIONALE
1. Njeh procedurat për realizimin e hulumtimit veprues në mësimdhënie.	1.1 Realizon hulumtime vepruese për përmirësimin e mësimdhënies.



SHEMBUJ TË PRAKTIKËS PROFESIONALE



- Propozon hulumtime vepruese për rritjen e efektivitetit të mësimit.
- Merr pjesë në hulumtime vepruese në mësim.
- Interpretin njohuritë nga hulumtimet vepruese dhe propozon aktivitete të ardhshme.

VII. STRUKTURË, ORGANIZIM DHE KLIMË SHKOLLORE

PEDAGOGU ka rol të posaçëm në ndjekjen dhe përparimin e mësimdhënies, mënyrën e udhëheqjes së dokumentacionit pedagogjik, punën me bashkësinë e nxënësve, organizatat dhe klubet e nxënësve.

VII. STRUKTURË, ORGANIZIM DHE KLIMË SHKOLLORE

Nën-fusha: STRUKTURË DHE ORGANIZIM SHKOLLOR (PLANIFIKIM DHE VËZHGIM I PUNËS EDUKATIVO-ARSIMORE, EVIDENCË DHE DOKUMENTACION PEDAGOGJIK, EVALVIM)

PEDAGOGU...



A. KUPTIME DHE NJOHURI PROFESIONALE	B. AFTËSI DHE SHKATHTËSI PROFESIONALE
1. Di si duhet të zhvillohet procesi mësimor.	1.1 Shfrytëzon instrumente për vëzhgim dhe interpreton njohuritë e fituara për orën e radhës. zhvillon strategji për përmirësimin e mësimin.
2. I di strukturat e evidencës dhe dokumentacionit pedagogjik dhe mënyrat e udhëheqjes së tij.	2.1 Organizon dhe /ose realizon vëzhgim periodik të evidencës dhe dokumentacionit pedagogjik. 2.2 Merr pjesë në procesin e përfshirjes së fëmijëve që në mënyrë obligative duhet të shkojnë në shkollë dhe në formimin e paraleleve.



SHEMBUJ TË PRAKTIKËS PROFESIONALE



- Vëzhgon orë mësimore, i analizon njohuritë dhe propozon masa relevante për gjithë shkollën.
- Vëzhgon mënyrën e udhëheqjes së evidencës pedagogjike dhe propozon masa për përmirësim.
- Vendosë procedura për evidencë dhe sigurim të përfshirjes së nxënësve.


KOMPETENCA SPECIFIKE PËR PSIKOLOG

1. PUNË ME NXËNËS

PSIKOLOGU punon kryesisht me nxënësit në zhvillimin e tyre emocional, si dhe në mbështetjen dhe zhvillimin e karakteristikave të tyre personale pozitive dhe anëve të fuqishme. Ai i dallon, identifikon dhe punon me nxënës të cilët kanë vështirësi emocionale, probleme në sjelljen dhe në përshtatjen me mjedisin, e po ashtu, i dallon, identifikon dhe punon me nxënës që kanë dhunti dhe talent. Për realizimin e këtyre qëllimeve, konkretisht për shkak të identifikimit më të mirë të karakteristikave psikologjike të nxënësve, psikologu shfrytëzon teste të vlefshme dhe të standardizuara. Psikologët i zbatojnë testet sipas Ligjit për veprimtari psikologjike. Me këtë rast, ata janë të udhëhequr nga interesi më i mirë i nxënësve, ndërsa me informacionet e fituara nga testimet veprojnë në mënyrë të besueshme dhe i ruajnë në mënyrë të sigurt. Në funksion të zhvillimit optimal psiko-social të nxënësve, psikologët organizojnë punëtori të orientuara drejt zhvillimit të vetëbesimit, pranimit të përgjegjësisë për veprimet personale dhe përballjes me situata të ndryshme të krizës.

I. PUNË ME NXËNËS

Nën-fusha: MBËSHTETJE E NXËNËSVE GJATË NXËNIES

PSIKOLOGU... 

A. KUPTIME DHE NJOHURI PROFESIONALE	B. AFTËSI DHE SHKATHTËSI PROFESIONALE
1. Njeh teknika dhe strategji të vërtetuara për vlerësimin dhe nxitjen e zhvillimit kognitiv. 2. Njeh teknika të këshillimit. 3. Njeh parimet e punës në punëtori.	1.1 Ndhmon nxënësit që të bëhen të vetëdijshëm për procesin e nxënies personale dhe t'i zhvillojnë shkathtësitë për nxënie të pavarur. 2.1 Shfrytëzon qasje në këshillimin e nxënësve të mbështetura në identifikimin e anëve të tyre të fuqishme, zhvillimin e potencialit të tyre dhe i ndjekë efektet e këshillimeve. 3.1 Ka shkathtësi për udhëheqjen e punëtorive psikologjike.




SHEMBUJ TË PRAKTIKËS PROFESIONALE



- Bën vlerësimin e potencialeve kognitive të nxënësve.
- Bën vlerësimin e shkaqeve psiko-sociale për mosp sukses në nxënie.
- Merr pjesë në vlerësimin e gatishmërisë së nxënësve për përparim të shpejtuar.
- Realizon punëtori dhe konsultime individuale për nxënie, etj.
- Realizon takime individuale dhe grupore këshillëdhënëse me nxënësit që përballen me mosp sukses në nxënie.
- Realizon punëtori që janë relevante për përmirësimin e nxënies së nxënësve (p.sh. motivimi për nxënie, mendimi kritik, mendimi kreativ, zgjidhje të problemeve, etj.).

I. PUNË ME NXËNËS

Nën-fusha: VËZHGIM DHE MBËSHTETJE E ZHVILLIMIT TË NXËNËSVE

PSIKOLOGU... 

A. KUPTIME DHE NJOHURI PROFESIONALE	B. AFTËSI DHE SHKATHTËSI PROFESIONALE
1. E di se ç'janë kriza zhvillimore dhe të situatave, si dhe njeh mënyra për t'u përballur me të njëjtat.	1.1 Identifikon dhe reagon në mënyrë përkatëse ndaj situatave të krizës të nxënësve. 1.2 Shfrytëzon strategji për t'u përballur me sjelljen joadekuatë të nxënësve.
2. I di taktikat dhe strategjitë e vërtetuara për vlerësim dhe përmirësim të funksionimit socio-emocional të nxënësve dhe shëndetit të tyre mental.	2.1 Vlerëson dhe vëzhgon zhvillimin social dhe personal të nxënësve dhe ofron mbështetje për zhvillimin e tyre harmonik. 2.2 Kontribuon në rritjen dhe zhvillimin personal dhe social të nxënësve.
3. E di se si medikamentet dhe droga (substancat kimike) ndikojnë në gjendjen psikofizike dhe sjelljen.	3.1 Kontribuon në parandalimin e sëmundjeve të varshmërisë.



SHEMBUJ TË PRAKTIKËS PROFESIONALE



- U ndihmon nxënësve që të përballen me situata të krizës (sëmundje, vdekje, shkurorëzim, dhunë në familje dhe ngjashëm).
- Mbledhë të dhëna për zhvillimin personal dhe social të nxënësve (përmes vëzhgimit, intervistave, anketimit, fokus grupeve).
- Mbledhë informacione për punën dhe sjelljen e nxënësve përmes vëzhgimit të mësimdhënies.
- Realizon punëtori dhe aktivitete tjera me nxënës për parandalimin e temave të ndryshme që kanë të bëjnë me shëndetin fizik dhe mental (p.sh. varshmëri, dieta, përballje me stres, përballje me dhunë, sjellje asociatë, përballje me diskriminim, shtatzëni e padëshiruar, etj.).
- Intervenon gjatë sjelljes së papërshtatshme të nxënësve.
- Zhvillon strategji për mbështetjen e zhvillimit psikik të nxënësve, të përshtatur me veçoritë e vetë nxënësve dhe shkollës.
- Shfrytëzon teste për vlerësimin e personalitetit.
- Planifikon, organizon dhe realizon punëtori për rritje dhe zhvillim personal (për shembull: vetëdije për veten, vetëbesim, vetëdije për të drejtat dhe përgjegjësitë, dallim dhe përballje me emocione, etj.).
- Planifikon, organizon dhe realizon punëtori për shkathtësi psiko-sociale (për shembull: shkathtësi komunikuese, zgjidhje të konflikteve, dallim të problemeve, përballje me to, etj.).
- Planifikon, organizon dhe realizon punëtori parandaluese.
- Identifikon dhe këshillon nxënësit që përdorin substanca psiko-tropike ku të kërkojnë ndihmë përkatëse dhe i informon prindërit dhe shërbimet përkatëse.

I. PUNË ME NXËNËS

Nën-fusha: ORIENTIM PROFESIONAL DHE NË KARRIERË I NXËNËSVE

PSIKOLOGU...



A. KUPTIME DHE NJOHURI PROFESIONALE	B. AFTËSI DHE SHKATHTËSI PROFESIONALE
1. Një instrumente matëse psikologjike që përdoren gjatë orientimit profesional.	1.1 Bën kontrollimin e aftësive të përgjithshme dhe specifike, si dhe interesave profesionale të nxënësve. 1.2 Sintetizon informacionet e fituara.



SHEMBUJ TË PRAKTIKËS PROFESIONALE



- Shfrytëzon teste për interesa profesionale.
- Shfrytëzon teste për aftësi të përgjithshme dhe të veçanta.
- Prezanton informacionet në mënyrën të kapshme për nxënësit.

II. PUNË ME ARSIMTARË

PSIKOLOGU u ndihmon veçanërisht arsimtarëve në: punën me nxënësit me qëllim që ata të përparojnë sipas potencialeve personale, krijimin e atmosferës përkatëse për punë, si dhe për vendosjen e komunikimit efikas me nxënësit dhe në mes nxënësve në procesin e mësimit dhe nxënies.

II. PUNË ME ARSIMTARË

Nën-fusha: MBËSHTETJE E ARSIMTARËVE GJATË PLANIFIKIMIT DHE REALIZIMIT TË PROCESIT EDUKATIVO-ARSIMOR DHE VETËVLERËSIMIT

PSIKOLOGU...



A. KUPTIME DHE NJOHURI PROFESIONALE	B. AFTËSI DHE SHKATHTËSI PROFESIONALE
1. I di parimet dhe metodat e mësimit efektiv.	1.1 Ofron ndihmë profesionale në përgatitjen dhe realizimin e mësimit interaktiv.
2. Posedon njohuri për kontrollin ekstern dhe intern e të arriturave të nxënësve.	2.1 Ofron ndihmë profesionale në përgatitjen dhe realizimin e kontrollit ekstern dhe intern të të arriturave të nxënësve.
3. I di metodat bashkëkohore dhe të ndryshme të vëzhgimit dhe notimit, mundësitë dhe kufizimet e tyre.	3.1 Ndihmon arsimtarët që të përzgjedhin dhe përgatisin instrumente për vlerësimin dhe vetëvlerësimin e të arriturave të nxënësve dhe t'i shfrytëzojnë ato në mënyrë përkatëse.
4. Njeh standardet e parashikuara për notim formativ dhe sumativ.	
5. Posedon njohuri nga psikometria.	5.1 Bën analizë psiko-metrike të testeve të njohurive.





SHEMBUJ TË PRAKTIKËS PROFESIONALE

- Realizon punëtori dhe konsultime individuale për sigurimin e pjesëmarrjes aktive të nxënësve në mësim (p.sh. parashtrim të pyetjeve, hulumtime, respektim të interesave të nxënësve, etj.).
- Informon arsimtarët për lloje të ndryshme të testeve eksterne (qëllime, lloje të detyrave, mënyra të realizimit).
- Ndihmon arsimtarët të sigurojnë që nxënësit të përvetësojnë përvoja për llojet e ndryshme të provimeve (gojore, teste, praktike).
- Jep udhëzime për dokumentimin e të arriturave të nxënësve (konsultimeve grupore ose individuale).
- Realizon punëtori për notim cilësor.
- Jep udhëzime për përzgjedhjen e metodave përkatëse dhe për përpilimin dhe shfrytëzimin e instrumenteve për notimin e të arriturave të nxënësve.
- Jep udhëzime (konsultime individuale ose grupore) për përmirësimin e testeve në bazë të analizës psikometrike.

II. PUNË ME ARSIMTARË

Nën-fusha: MBËSHTETJE E ARSIMTARËVE GJATË PUNËS ME NXËNËS

PSIKOLOGU...

A. KUPTIME DHE NJOHURI PROFESIONALE	B. AFTËSI DHE SHKATHTËSI PROFESIONALE
1. I di procedurat për identifikimin e nxënësve të talentuar. 2. I di mënyrat e punës me nxënës me karakteristika të ndryshme personale.	1.1 Ndërlidhë karakteristikat e nxënësve me mënyrat përkatëse të punës me nxënës. 1.2 Sintetizon informacionet e fituara.



SHEMBUJ TË PRAKTIKËS PROFESIONALE

- Këshillon arsimtarët se si t'i identifikojnë nxënësit e talentuar.
- Propozon ose bashkë me arsimtarin përpilon mënyra për nxitjen e aftësive të posaçme të nxënësve të talentuar dhe motivimin e nxënësve për pjesëmarrje në gara dhe konkurse me karakter të ndryshëm.
- Sqaron dhe demonstroi mënyrat në të cilat mund t'i jepet ndihmë nxënësve për shfrytëzimin e qasjeve të ndryshme në nxënie.

III. PUNË ME PRINDËR

PSIKOLOGU u ndihmon veçanërisht prindërve që t'i dallojnë dhe kuptojnë nevojat zhvillimore dhe individuale të fëmijës së tyre, krizat gjatë nxënies dhe sjelljes me të cilat përballet fëmija, i këshillon se si t'i zhvillojnë shkathtësitë dhe mënyrat e nevojshme të komunikimit me fëmijët dhe i udhëzon në llojin dhe mënyrën e ofrimit të mbështetjes në zhvillimin psikosocial.

III. PUNË ME PRINDËR

Nën-fusha: KËSHILLIME DHE KONSULTIME INDIVIDUALE DHE GRUPORE ME PRINDËR

PSIKOLOGU... 

A. KUPTIME DHE NJOHURI PROFESIONALE	B. AFTËSI DHE SHKATHTËSI PROFESIONALE
1. I di mënyrat e mbështetjes së prindërve gjatë punës me fëmijë me nevoja të posaçme arsimore. 2. I di format dhe metodat për konsultim efektiv të prindërve.	1.1 Ndhmon prindërit e fëmijëve me nevoja të posaçme arsimore që ta kuptojnë gjendjen e fëmijëve të tyre dhe t'ua ofrojnë ndihmën dhe mbështetjen e nevojshme. 2.1 Shfrytëzon metoda të ndryshme për konsultime individuale dhe grupe të prindërve.



SHEMBUJ TË PRAKTIKËS PROFESIONALE



- Informon prindërit e fëmijëve me nevoja të posaçme arsimore për të drejtat, obligimet dhe ndihmën që mund të marrin dhe i udhëzon për ndihmë drejt institucioneve relevante.
- Realizon konsultime individuale me prindërit për mbështetjen e fëmijëve me nevoja të posaçme arsimore.
- Organizon dhe realizon konsultime grupe dhe individuale me prindërit, fëmijët e të cilëve përballen me mospajtim gjatë nxënies, ndjekje të parregullt të mësimin dhe sjellje të papërshtatshme.

III. PUNË ME PRINDËR

Nën-fusha: PËRFSHIRJE E PRINDËRVE NË JETËN DHE PUNËN E SHKOLLËS

PSIKOLOGU...



A. KUPTIME DHE NJOHURI PROFESIONALE

1. Kupton rëndësinë e bashkëpunimit me familjen për parandalimin e efekteve negative te të rinjtë.

B. AFTËSI DHE SHKATHTËSI PROFESIONALE

- 1.1 Zhvillon strategji për parandalimin e ndikimit potencial negativ të mjedisit te të rinjtë.



SHEMBUJ TË PRAKTIKËS PROFESIONALE

- Me prindërit ndërmer masa parandaluese për parandalimin e ndikimit negativ të mjedisit tek të rinjtë dhe për tejkalimin e vështirësive të shprehura, etj.

IV. BASHKËPUNIM ME BASHKËSINË

PSIKOLOGU në fokusin e bashkëpunimit i ka institucionet arsimore, shëndetësore, sociale, shkencore, kulturore dhe institucione tjera që mund të kontribuojnë në nxënien dhe zhvillimin më cilësor të nxënësve. Bashkëpunon me institucionet shkencore dhe arsimore në hulumtime dhe vendosje të qasjeve inovative në punën edukativo-arsimore.

IV. BASHKËPUNIM ME BASHKËSINË

Nën-fusha: **BASHKËPUNIM ME BASHKËSINË LOKALE**

PSIKOLOGU... 

A. KUPTIME DHE NJOHURI PROFESIONALE	B. AFTËSI DHE SHKATHTËSI PROFESIONALE
1. Është i informuar për ndërmarrjet përkatëse në të cilat mund të realizohet mësimi praktik.	1.1 Ndërlidhë karakteristikat e nxënësve me format e mësimit praktik.



SHEMBUJ TË PRAKTIKËS PROFESIONALE



- Përfshihet në procesin e planifikimit, organizmit dhe vëzhgimit të mësimit praktik në shkollat e mesme profesionale.

V. ZHVILLIM PROFESIONAL DHE BASHKËPUNIM PROFESIONAL

PSIKOLOGU ka rol të posaçëm në përpilimin e programit për punë të arsimtarëve fillestar dhe në procesin e mentorimit të tyre. Psikologët, po ashtu, vëzhgojnë efektet dhe mbajnë dokumentacion për zhvillimin profesional të kuadrit edukativo-arsimor.

V. ZHVILLIM PROFESIONAL DHE BASHKËPUNIM PROFESIONAL

Nën-fusha: MBËSHTETJE E ZHVILLIMIT DHE BASHKËPUNIMIT PROFESIONAL NË SHKOLLË

PSIKOLOGU...



A. KUPTIME DHE NJOHURI PROFESIONALE	B. AFTËSI DHE SHKATHTËSI PROFESIONALE
1. Njeh kompetencat themelore profesionale për arsimtarë.	1.1 Ndërlidhë format dhe përmbajtjet e zhvillimit profesional me kompetencat e nevojshme të arsimtarëve.



SHEMBUJ TË PRAKTIKËS PROFESIONALE



- Mban dokumentacion për zhvillimin profesional të arsimtarëve.

VI. PUNË ANALITIKE-HULUMTUESE

PSIKOLOGU analizon dhe hulumton klimën në institucion, vëzhgon dhe analizon zhvillimin e nxënësve dhe bën vlerësim për shkak të mirëkuptimit më të mirë të tyre dhe ndërmarrjes së masave përkatëse. Me këtë rast, shpesh shfrytëzon instrumente dhe procedura të standardizuara psikologjike matëse për vlerësimin e aftësive dhe veçorive tjera të personalitetit të nxënësve.

VI. PUNË ANALITIKE-HULUMTUESE

Nën-fusha: **HULUMTIM I PUNËS EDUKATIVO-ARSIMORE**

PSIKOLOGU...



A. KUPTIME DHE NJOHURI PROFESIONALE	B. AFTËSI DHE SHKATHTËSI PROFESIONALE
1. Njeh mundësitë dhe kufizimet e testeve të ndryshme të personalitetit dhe testeve të njohurive.	1.1 Shfrytëzon drejt testet psikologjike dhe i interpreton rezultatet e testimeve.
2. Njeh standardet psiko-metrike.	2.1 Respekton standardet psiko-metrike gjatë përzgjedhjes dhe përpilimit të instrumenteve matëse.
3. Njeh procedurat për realizimin e hulumtimit veprues në arsim.	3.1 Realizon hulumtime vepruese gjatë përpilimit të programeve për përmirësimin e nxënies dhe shëndetit mental të nxënësve.



SHEMBUJ TË PRAKTIKËS PROFESIONALE



- Bën matjen e karakteristikave psikologjike të nxënësve për hulumtimin e lidhshmërisë me nxënien dhe sjelljen e nxënësve.
- Identifikon dhe propozon hulumtime vepruese për përmirësimin e nxënies dhe shëndetit mental të nxënësve.
- Realizon dhe/ose merr pjesë në hulumtime vepruese.
- Interpretin njohuritë nga hulumtimet vepruese dhe propozon programe/aktivitete përkatëse.

VII. STRUKTURË, ORGANIZIM DHE KLIMË SHKOLLORE

PSIKOLOGU ka rol parësor në: ndërtimin e programeve parandaluese me të cilat promovohet shëndeti mental dhe fizik i nxënësve dhe pjesëmarrja demokratike e tyre në shkollë, intervenimi në situata të krizës në shkollë, për sigurimin e mbështetjes psiko-sociale dhe emocionale të të gjithë atyre që janë të përfshirë në procesin edukativo-arsimor.

VII. STRUKTURË, ORGANIZIM DHE KLIMË SHKOLLORE

Nën-fusha: STRUKTURË DHE ORGANIZIM SHKOLLOR (PLANIFIKIM, VËZHGIM I PUNËS EDUKATIVO-ARSIMORE, EVIDENCË DHE DOKUMENTACION PEDAGOGJIK, EVALVIM)

PSIKOLOGU...



A. KUPTIME DHE NJOHURI PROFESIONALE	B. AFTËSI DHE SHKATHTËSI PROFESIONALE
1. Di si duhet të zhvillohet procesi mësimor.	1.1 Shfrytëzon instrumente për ndjekje dhe i interpreton njohuritë e fituara për orën e radhës. 1.2 Zhvillon strategji për përmirësimin e mësimin.
2. Di të shfrytëzojë instrumente psiko-diagnostike në mënyrë të drejtë.	2.1 Përzgjedhë dhe shfrytëzon ato instrumente psiko-diagnostike që janë përkatëse për punën në shkollë.



SHEMBUJ TË PRAKTIKËS PROFESIONALE



- Vëzhgon orë mësimore, analizon njohuritë dhe propozon masa relevante për gjithë shkollën.
- Testet psikologjike dhe rezultatet e tyre i ruan në mënyrë të sigurt.

VII. STRUKTURË, ORGANIZIM DHE KLIMË SHKOLLORE

Nën-fusha: KLIMË SHKOLLORE, MJEDIS I SIGURT
DHE PJESËMARRJE DEMOKRATIKE E NXËNËSVE

PSIKOLOGU... 


A. KUPTIME DHE NJOHURI PROFESIONALE	B. AFTËSI DHE SHKATHTËSI PROFESIONALE
1. Njeh mënyra të ndryshme për t'u përballur me situata të krizës në shkollë.	1.1 Shfrytëzon mekanizma, teknika dhe strategji për intervenim në rast të krizës në shkollë. 1.2 Shfrytëzon shkathhtësi për zgjidhjen e konflikteve dhe i zhvillon të njëjtat te nxënësit.



SHEMBUJ TË PRAKTIKËS PROFESIONALE



- Merr pjesë në zhvillimin e programeve parandaluese (p.sh. forcim të vetëbesimit dhe vetërespektit, parandalim të llojeve të padëshiruara të sjelljes, nxënie të shkathhtësive sociale, motivim për nxënie, etj.) për të gjithë nxënësit, veçanërisht për ata nga grupet e ndjeshme.
- Realizon punëtori me arsimtarë dhe nxënës për barazinë gjinore.
- U siguron nxënësve ndihmë përkatëse këshillëdhënëse dhe mbështetje psiko-emocionale dhe emocionale në situata të kërcënimeve ose rrezikimit të shëndetit ose sigurisë së tyre.
- Tregon mënyrat dhe intervenon në zgjidhjen e situatave të konflikteve.




KOMPETENCA SPECIFIKE PËR SOCIOLOG

PUNË ME NXËNËS

SOCIOLOGU punon kryesisht me nxënës në drejtim të shoqërizimit të tyre, shoqërimin dhe zhvillimit të vlerave pozitive të ata. Ai i vëzhgon, identifikon dhe punon me nxënësit që kanë probleme me përshtatjen dhe pranimin e mjedisit, shfrytëzimin e drejtë të kohës së lirë dhe me përshtatjen me normat e sjelljes. Sociologu u ndihmon nxënësve të kenë dhe të tregojnë ndjeshmëri më të madhe ndaj dallimeve kulturore në shkollë, e kjo shpie drejt zvogëlimit të etno-centrizmit dhe rritjen e mirëkuptimit të ndërsjellë. Sociologu u ndihmon nxënësve në bashkëveprimin e ndërsjellë, më saktësisht, u ndihmon të zhvillojnë komunikim të suksesshëm mes vete, si dhe komunikim mes nxënësit dhe arsimtarit. Sociologu, në kuadër të hulumtimeve të tij për realitetin, i përfshin nxënësit me qëllim që të ata t'i zhvillojë aftësitë e tyre për punë ekipore dhe me këtë rast ta dallojnë ndërlíkueshmërinë e shoqërisë dhe dukurive shoqërore. Për këtë qëllim, sociologu për nxënësit organizon këshillime profesionale në tema të cilat janë relevante për zhvillimin e tyre (si për shembull, këshillime për dallimet kulturore, për shkaqet dhe pasojat e varshmërisë, kriminalitetin nga teknologjia moderne, dhunën, etj.). Ai organizon aktivitete shoqërore të nxënësve në shkollë dhe jashtë saj, punon në përmirësimin e marrëdhënieve ndërmjet nxënësve të komuniteteve të ndryshme dhe grupeve të marginalizuara, si dhe në forcimin e tolerancës dhe bashkëpunimit mes nxënësve.

I. PUNË ME NXËNËS

Nën-fusha: MBËSHTETJE E NXËNËSVE GJATË NXËNIES

SOCIOLOGU... 

A. KUPTIME DHE NJOHURI PROFESIONALE	B. AFTËSI DHE SHKATHTËSI PROFESIONALE
1. Njeh faktorët social që ndikojnë në nxënien dhe suksesin e nxënësve. 2. I di dukuritë socio-patologjike midis të rinjve.	1.1 Identifikon nxënësit nga kategoritë e ndjeshme sociale dhe u siguron mbështetje gjatë nxënies. 2.1 Identifikon dhe vlerëson nxënësit me sjellje socio-patologjike në shkollë dhe u siguron mbështetje përkatëse.




SHEMBUJ TË PRAKTIKËS PROFESIONALE



- Organizon forma të ndryshme për shoqërimin e nxënësve (p.sh. aktivitete jashtëmësimore për shoqërim).
- Informon nxënësit për dukuri të caktuara nga jeta shoqërore dhe i udhëzon drejt informacioneve dhe burimeve të mirëfillta për to.
- Vëzhgon, identifikon dhe punon me nxënës që kanë probleme me planifikimin e kohës së lirë, me përshtatjen dhe shoqërimin.
- Përgatit dhe realizon programe për ndihmë nxënësve me sjelljes asociiale dhe devijuese.

I. PUNË ME NXËNËS

Nën-fusha: VËZHGIM DHE MBËSHTETJE TË ZHVILLIMIT TË NXËNËSVE

SOCIOLOGU... 

A. KUPTIME DHE NJOHURI PROFESIONALE	B. AFTËSI DHE SHKATHTËSI PROFESIONALE
1. E di se çka janë kriza zhvillimore dhe të situatave dhe njeh mënyra për përballje me të njëjtat.	1.1 Identifikon dhe reagon në mënyrë përkatëse ndaj situatave të krizës të nxënësve. 1.2 Shfrytëzon strategji për përballje me sjellje joadekuate të nxënësve.
2. Di parime, modele dhe forma për shfrytëzimin e kohës së lirë të nxënësve në dhe jashtë shkollës.	2.1 Ofron mbështetje në organizmin dhe realizimin e aktiviteteve jashtëmësimore të nxënësve në shkollë.
3. E di rëndësinë e strukturimit të kohës së lirë për zhvillim pozitiv të personalitetit.	3.1 Motivon nxënësit për shfrytëzimin aktiv të kohës së lirë.
4. Di parime, modele dhe forma për shfrytëzimin e kohës së lirë të nxënësve në dhe jashtë shkollës.	4.1 Ofron mbështetje në organizmin dhe realizimin e aktiviteteve jashtëmësimore të nxënësve në dhe jashtë shkollës.

SHEMBUJ TË PRAKTIKËS PROFESIONALE

- Ndhmon nxënësit që të përballen me situata të krizës (sëmundje, vdekje, shkurorëzim, dhunë në familje dhe ngjashëm).
- Mbledhë të dhëna për zhvillimin personal dhe social të nxënësve (përmes vëzhgimit, intervistës, anketimit, fokus grupeve).
- Mbledhë informacione për punën dhe sjelljen e nxënësve përmes vëzhgimit të mësimt.
- Realizon punëtori dhe aktivitete tjera me nxënës për parandalimin e temave të ndryshme që kanë të bëjnë me shëndetin fizik dhe mental (p.sh. varshmëri, dieta, përballje me stres, përballje me dhunë, sjelljes asociate, përballje me diskriminim, shtatzëni të padëshiruar, etj.).
- Intervenon gjatë sjelljes së papërshtatshme të nxënësve.
- Informon nxënësit për aktivitetet jashtëmësimore, në shkollë.
- Merr pjesë dhe ofron mbështetje në identifikimin e dëshirave dhe interesave specifike të nxënësve për realizimin e aktiviteteve të lira, në shkollë.
- Merr pjesë në identifikimin e dëshirave dhe interesave specifike të nxënësve për pjesëmarrje në aktivitet jashtëmësimore, në shkollë.
- Merr pjesë në realizimin e një pjese të aktiviteteve jashtëmësimore.
- U ndihmon nxënësve në planifikimin dhe shfrytëzimin efektiv të kohës së lirë.
- Organizon forma të ndryshme për shoqërim të nxënësve (aktivitete jashtëmësimore për shoqërim).
- Informon nxënësit për aktivitetet jashtëmësimore, në dhe jashtë shkollës.
- Merr pjesë dhe ofron mbështetje në identifikimin e dëshirave dhe interesave specifike të nxënësve për realizimin e aktiviteteve të lira, në dhe jashtë shkollës.
- Merr pjesë në identifikimin e dëshirave dhe interesave specifike të nxënësve për pjesëmarrje në aktivitete jashtëmësimore, në dhe jashtë shkollës.
- Merr pjesë në realizimin e një pjese të aktiviteteve jashtëmësimore, në dhe jashtë shkollës.

II. PUNË ME ARSIMTARË

SOCIOLOGU kontribuon veçanërisht në: përmirësimin e punës së arsimtarëve gjatë: planifikimit dhe organizmit të aktiviteteve jashtëmësimore, punës me organizatat shoqërore (fëmijërore, rinore, Kryqit të Kuq, skautë, praktikë feriale), bashkëpunimin me bashkësinë lokale, punën prodhuese dhe punën tjetër shoqërore të dobishme në shkollë dhe jashtë saj, bashkëpunimin me subjektet ekonomike, mbështetjen e punës së bashkësisë së nxënësve, bashkëpunimin me prindër, etj.

II. PUNË ME ARSIMTARË

Nën-fusha: MBËSHTETJE E ARSIMTARËVE GJATË PLANIFIKIMIT DHE REALIZIMIT TË PROCESIT EDUKATIVO-ARSIMOR DHE VETËVLERËSIMIT

SOCIOLOGU...



A. KUPTIME DHE NJOHURI PROFESIONALE	B. AFTËSI DHE SHKATHTËSI PROFESIONALE
1. I di potencialet dhe rreziqet gjatë nxënies së nxënësve me prejardhje të ndryshme socio-kulturore.	1.1 Ndhmon arsimtarët që gjatë planifikimit t'u kushtojnë kujdes karakteristikave sociale dhe kulturore të mjedisit dhe familjeve të nxënësve.
2. I di potencialet e llojeve të ndryshme të aktiviteteve jashtëmësimore.	2.1 Ndhmon arsimtarët gjatë planifikimit dhe organizmit të aktiviteteve mësimore dhe jashtëmësimore, organizatave shoqërore, bashkëpunimit me bashkësinë lokale, funksionit social dhe funksionimit të bashkësisë së shkollës, bashkëpunimit me prindërit, etj.



SHEMBUJ TË PRAKTIKËS PROFESIONALE



- Realizon punëtori ose u ofron ndihmë individuale arsimtarëve për mënyrat e ndryshme të mbledhjes së të dhënave për gjendjen sociale të nxënësit (kushtet e jetesës, nxënies, mundësi për përparim).
- Përpilon me arsimtarët programe për aktivitete jashtëmësimore, organizata shoqërore, bashkëpunim me prindër.
- Merr pjesë në organizmin e aktiviteteve jashtëmësimore.
- Përpilon instrumente për vëzhgimin dhe notimin e punës gjatë aktiviteteve mësimore dhe jashtëmësimore, ato shoqërore, të bashkësisë së shkollës, bashkëpunimit me prindër.

III. PUNË ME PRINDËR

SOCIOLOGU punon veçanërisht me prindërit e nxënësve që kanë probleme me shoqërizimin, sjellje devijuese, raporte të prishura me nxënësit dhe arsimtarët, si dhe këshillon prindërit për mënyrat përkatëse të përbaljes me dukuritë dhe për bashkëpunim me shkollën dhe institucionet relevante.

III. PUNË ME PRINDËR

Nën-fusha: KËSHILLIME DHE KONSULTIME INDIVIDUALE DHE GRUPORE ME PRINDËR

SOCIOLOGU...



A. KUPTIME DHE NJOHURI PROFESIONALE	B. AFTËSI DHE SHKATHTËSI PROFESIONALE
1. Di si ta shqyrtojë dhe vlerësojë mjedisin familjar të fëmijës.	1.1 Ndhmon prindërit në identifikimin, vëzhgimin dhe tejkalimin e dukurive socio-patologjike të fëmijëve të tyre. 1.2 Promovon stil të shëndoshë të jetesës në familje.



SHEMBUJ TË PRAKTIKËS PROFESIONALE



- Vëzhgon dhe evidenton situatat në familje që janë të rrezikshme (të pavolitshme) për zhvillimin e tyre.
- Këshillon prindërit për mënyrat e mundshme të zgjidhjes së dukurive socio-patologjike.
- Ndërmerr masa parandaluese me prindërit për pengimin e ndikimit negativ të bashkësisë të rinjtë dhe për tejkalimin e vështirësive të shprehura.

III. PUNË ME PRINDËR

Nën-fusha: PËRFSHIRJE E PRINDËRVE NË JETËN DHE PUNËN E SHKOLLËS

SOCIOLOGU...



A. KUPTIME DHE NJOHURI PROFESIONALE

1. Kupton rëndësinë e bashkëpunimit me familjen për parandalimin e efekteve negative të rinjtë.

B. AFTËSI DHE SHKATHTËSI PROFESIONALE

- 1.1 Zhvillon strategji për parandalimin e ndikimit potencial negativ të mjedisit të rinjtë.



SHEMBUJ TË PRAKTIKËS PROFESIONALE



- Ndërmerr masa parandaluese me prindërit për parandalimin e ndikimit negativ të mjedisit të rinjtë dhe për tejkalimin e vështirësive të shprehura, etj.



IV. BASHKËPUNIM ME BASHKËSINË

SOCIOLOGU bashkëpunon kryesisht me persona tjerë profesional, institucione arsimore, qendra për punë sociale, polici, institucione shëndetësore, shtëpi për fëmijë dhe të rinj, organizata sportive, humanitare, joqeveritare dhe të tjera, me zyrat për të rinjtë dhe shoqata tjera të qytetarëve, si dhe organizata që merren me organizmin e kohës së lirë të të rinjve, sëmundje të varshmërisë, parandalim dhe luftim të dukurive devijuese (alkool, drogë, vjedhje, prostitucion, etj.).

IV. BASHKËPUNIM ME BASHKËSINË

Nën-fusha: BASHKËPUNIM ME BASHKËSINË LOKALE

SOCIOLOGU... 

A.	KUPTIME DHE NJOHURI PROFESIONALE	B.	AFTËSI DHE SHKATHTËSI PROFESIONALE
1.	I di marrëdhëniet funksionale dhe konfliktet e shkollës dhe bashkësisë.	1.1	Shqyrton ndikimin e shtëpisë dhe bashkësisë te nxënësit dhe në shkollë.



SHEMBUJ TË PRAKTIKËS PROFESIONALE

- Bashkëpunon me institucione relevante për parandalimin e dukurive devijuese në shkollë.
- Bashkëpunon me bashkësinë lokale për shfrytëzimin e organizuar të kohës së lirë.

V. ZHVILLIM PROFESIONAL DHE BASHKËPUNIM PROFESIONAL

V. ZHVILLIM PROFESIONAL DHE BASHKËPUNIM PROFESIONAL

Nën-fusha: MBËSHTETJE E ZHVILLIMIT
DHE BASHKËPUNIMIT PROFESIONAL NË SHKOLLË

SOCIOLOGU... 

A. KUPTIME DHE NJOHURI PROFESIONALE	B. AFTËSI DHE SHKATHTËSI PROFESIONALE
1. Njeh kompetencat themelore profesionale për arsimtarë.	1.1 Ndërlidhë format dhe përmbajtjet e zhvillimit profesional me kompetencat e nevojshme të arsimtarëve.



SHEMBUJ TË PRAKTIKËS PROFESIONALE



- Mban dokumentacion për zhvillimin profesional të arsimtarëve.

VI. PUNË ANALITIKE-HULUMTUESE

SOCIOLOGU grumbullon dhe analizon të dhëna përmes të cilave i shqyrton vështirësitë dhe konfliktet tipike të situatave të krizës në mjedisin shkollor, arsyet sociologjike për mospjesëmarrjen e nxënësve, vështirësitë në përshtatjen e nxënësve, shqyrton dhe hulumton paragjykimet dhe stereotipat, mendimin publik në shkollë, ndikimin e mediave, shqyrton nevojat socio-kulturore të nxënësve, përmbajtjet e aktiviteteve të nxënësve gjatë kohës së lirë dhe dukuritë tjera sociologjike që janë relevante për jetën dhe punën në shkollë.

VI. PUNË ANALITIKE-HULUMTUESE

Nën-fusha: HULUMTIM I PUNËS EDUKATIVO-ARSIMORE

SOCIOLOGU...



A. KUPTIME DHE NJOHURI PROFESIONALE	B. AFTËSI DHE SHKATHTËSI PROFESIONALE
1. Është i njohur me metodologjinë e hulumtimeve sociologjike në arsim.	1.1 Identifikon çështjet relevante për shkollën dhe hulumton ato. 1.2 Shfrytëzon rezultatet e hulumtimit sociologjik në praktikën e tij.



SHEMBUJ TË PRAKTIKËS PROFESIONALE



- Bën hulumtime për pozitën e individit në kolektiv, kryen hulumtime të veprimeve, hulumton arsyet për marrëdhënie të ndërprera komunikimi nxënës-nxënës, nxënës-arsimtarë, arsimtarë-prind, hulumton shkaqet e sjelljes së dhunshme, ndikimin negativ të masmediave, etj.

VII. STRUKTURË, ORGANIZIM DHE KLIMË SHKOLLORE

SOCIOLOGU ka rol të rëndësishëm në ndërtimin e ndjenjës së përkatësisë ndaj shkollës dhe kontribuon për autoritetin e saj përmes aktiviteteve të tij dhe forcimit të klimës shkollore.

VII. STRUKTURË, ORGANIZIM DHE KLIMË SHKOLLORE

Nën-fusha: STRUKTURË DHE ORGANIZIM SHKOLLOR (PLANIFIKIM, NDJEKJE E PUNËS EDUKATIVO-ARSIMORE, EVIDENCË DHE DOKUMENTACION PEDAGOGJIK, EVALVIM)

SOCIOLOGU... 

A. KUPTIME DHE NJOHURI PROFESIONALE	B. AFTËSI DHE SHKATHTËSI PROFESIONALE
1. I di strukturat e evidencës dhe dokumentacionit pedagogjik dhe mënyrat e mbajtjes së tij.	1.1 Organizon dhe /ose realizon vëzhgim periodik të evidencës dhe dokumentacionit pedagogjik. 1.2 Merr pjesë në procesin e përfshirjes së obliguesve shkollore dhe formimin e paraleleve.



SHEMBUJ TË PRAKTIKËS PROFESIONALE



- Vëzhgon mënyrën e mbajtjes së evidencës pedagogjike dhe propozon masa për përmirësim.
- Vendorsë procedura për evidencë dhe sigurim të përfshirjes së nxënësve.

VII. STRUKTURË, ORGANIZIM DHE KLIMË SHKOLLORE

Nën-fusha: KLIMË SHKOLLORE, MJEDIS I SIGURT DHE PJESËMARRJE DEMOKRATIKE E NXËNËSVE

SOCIOLOGU... 


A. KUPTIME DHE NJOHURI PROFESIONALE	B. AFTËSI DHE SHKATHTËSI PROFESIONALE
1. Di rëndësinë e përfshirjes së të gjithë nxënësve në procesin arsimor.	1.1 Kujdeset për përfshirjen e nxënësve me sjellje devijuese në aktivitetet në dhe jashtë shkollës.



SHEMBUJ TË PRAKTIKËS PROFESIONALE



- Informon dhe këshillon nxënësit e kategorive të ndjeshme sociale se si të përfshihen në punën e bashkësive të nxënësve.
- Ndhmon bashkësitë e nxënësve të përkujdesen që në punën e tyre të jenë të përfshirë nxënës që e përfaqësojnë përbërjen e nxënësve (etnike, sociale, etj.).



KOMPETENCA SPECIFIKE PËR PUNËTOR SOCIAL

PUNË ME NXËNËS

PUNËTORI SOCIAL është i orientuar kryesisht drejt punës me nxënës nga kategoritë e ndjeshme sociale për t'i mbështetur dhe ndihmuar ata drejt integritimit në mjedisin shkollor dhe në bashkësinë më të gjerë. Punëtori social punon në zbulimin/identifikimin e nxënësve të cilët kushtet e pavolitshme sociale të mjedisit ku jetojnë, reflektohen në të arriturat arsimore, si dhe punon në tejkalimin e tyre. Ai zbaton punë individuale dhe grupore sociale me nxënës që janë në kategoritë e ndjeshme sociale dhe me probleme sociale, si dhe punë sociale në bashkësinë lokale për sigurimin e mbështetjes së domosdoshme dhe resurseve për këta nxënës dhe familjet e tyre. Njëherësh, krijon dhe realizon programe për parandalim social në nivel primar, sekondar dhe terciar, për parandalimin e paraqitjes së problemeve sociale të nxënësit. Vepron edhe si bashkëpunëtor dhe këshilltar në ekipin profesional dhe administratën shkollore, me qëllim të plotësimin të nevojave sociale të nxënësve.

I. PUNË ME NXËNËS

Nën-fusha: MBËSHTETJE E NXËNËSVE GJATË NXËNIES

PUNËTORI SOCIAL...




A. KUPTIME DHE NJOHURI PROFESIONALE	B. AFTËSI DHE SHKATHTËSI PROFESIONALE
1. Kupton marrëdhëniet njerëzore, bashkëveprimet dhe ndikimin e situatave sociale në funksionimin e individit. 2. Njeh metodikat e punës sociale me individ, si dhe të punës sociale në bashkësi lokale.	1.1 Posedon shkathtësi për identifikimin dhe evidentimin e nxënësve me rrezik social me vështirësi në nxënie. 2.1 Posedon shkathtësi për identifikimin, organizmin dhe shfrytëzimin e resurseve që janë në dispozicion në mjedisin shkollor dhe atë të jashtëm, në funksion të përmirësimit të suksesit arsimor të nxënësve.



SHEMBUJ TË PRAKTIKËS PROFESIONALE



- Mban evidencë dhe ofron ndihmë dhe mbështetje për nxënësit të cilët kushtet e pavolitshme sociale në të cilat jetojnë reflektohen negativisht në suksesin gjatë nxënies.
- Organizon dhe realizon aktivitete për mbështetjen e nxënësve nga kategoritë e ndjeshme sociale.
- Inicion mbështetje dhe ndihmë për nxënësit me vështirësi gjatë nxënies dhe sukses të dobët, në bashkëpunim me: arsimtarët për mësim plotësues, me nxënës tjerë për punë mentorimi, me organizata për mbështetje arsimore të nxënësve nga grupet e ndjeshme sociale, me qendrën për punë sociale për avancimin e gjendjes sociale të nxënësve, e me këtë edhe të mundësive për nxënie.



I. PUNË ME NXËNËS

Nën-fusha: VËZHGIM DHE MBËSHTETJE E ZHVILLIMIT TË NXËNËSVE

PUNËTORI SOCIAL...



A. KUPTIME DHE NJOHURI PROFESIONALE	B. AFTËSI DHE SHKATHTËSI PROFESIONALE
1. E di se çfarë janë krizat zhvillimore dhe të situatave dhe njeh mënyrat e përbaljes me të njëjtat.	1.1 Identifikon dhe reagon në mënyrë përkatëse ndaj situatave të krizës të nxënësve.
2. E di ndikimin e familjes në zhvillimin e nxënësve.	1.2 Shfrytëzon strategji për përballje me sjellje joadekuate të nxënësve.
3. Njih qasjet sistemore dhe metodikat e punës sociale me: individ, punë sociale në grup dhe punë sociale në bashkësi lokale.	2.1 Punon në integrimin e nxënësve nga mjedise të ndryshme socio-kulturore.
4. Është i njohur me bazat e punës sociale në kushte të krizës.	3.1 Përfaqëson të drejtat dhe interesat e nxënësve të rrezikuar social dhe i ndërlidhë me resurset e nevojshme për plotësimin e nevojave të tyre të mbrojtjes sociale.
5. Njih metodat e realizimit të programeve për parandalim social.	4.1 Ofron shërbime direkte për përmirësimin e situatës sociale të familjeve prej të cilave rrjedhin nxënësit.
6. Njih qasjet problematike në punën sociale (qasje drejt zgjidhjes së problemeve, qasje drejt zgjidhjes së detyrave, qasje e fokusuar në zgjidhje).	5.1 Posedon shkathtësi dhe zbaton teknika për vlerësim, planifikim dhe intervenim direkt dhe indirekt që ka të bëjë me nxënësin dhe mjedisin.





SHEMBUJ TË PRAKTIKËS PROFESIONALE

- Ndhmon nxënësit që të përballen me situata të krizës (sëmundje, vdekje, shkurorëzim, dhunë në familje dhe ngjashëm).
- Mbledhë të dhëna për zhvillimin personal dhe social të nxënësve (përmes vëzhgimit, intervistës, anketimit, fokus grupe).
- Mbledhë informacione për punën dhe sjelljen e nxënësve përmes vëzhgimit të mësimdhënies.
- Realizon punëtori dhe aktivitete tjera me nxënës për parandalimin e temave të ndryshme që kanë të bëjnë me shëndetin fizik dhe mental (p.sh. varshmëri, dieta, përballje me stres, përballje me dhunë, sjellje asociale, përballje me diskriminim, shtatzëni të padëshiruar, etj.).
- Intervenon gjatë sjelljes së papërshtatshme të nxënësve.
- Mbledhë të dhëna për nxënësit dhe kushtet në të cilat jetojnë ata, analizon dhe tregon ndikimet e mundshme në nxënien dhe sjelljen e nxënësve.
- Me paralele dhe forma tjera të organizmit të nxënësve, punon në pranimin e nxënësve nga kategoritë e ndjeshme sociale.
- Shqyrton kushtet sociale të nxënësve.
- Përpunon hartë sociale të paraleles.
- Identifikon nxënës të rrezikuar social dhe u ndihmon të përfshihen në procesin edukativo-arsimor.
- Identifikon dhe evidenton nxënësit që jetojnë në kushte të pavolitshme sociale (nxënës prej familjeve të varfra, familje me problem të papunësisë, familje që vetë kujdesen për veten, familje të marginalizuara dhe diskriminuara, familje të migruar, familje jofunksionale, nxënës pa prindër dhe përkujdesje prindërore, nxënës delikuent, nxënës prej familjeve me probleme banimi dhe probleme tjera të shumta sociale).
- Zbaton metoda të punës individuale dhe grupe sociale, mbështetë dhe ndihmon nxënësit me pengesa në zhvillimin social të cilët kushtet e pavolitshme sociale kanë rezultuar me probleme në shoqërim ose kanë kushtëzuar paraqitjen e problemeve sociale (delikuencë, sëmundje të varshmërisë, prostitucion, etj.).
- Nxitë formimin e grupeve të mbështetjes në mes nxënësve që kanë vështirësi dhe probleme të ngjashme.
- Krijon dhe zbaton programe për parandalimin e problemeve sociale të të gjithë nxënësit.

II. PUNË ME ARSIMTARË

PUNËTORI SOCIAL u ndihmon veçanërisht arsimtarëve gjatë sigurimit të përfshirjes përkatëse dhe punës me nxënësit e grupeve të ndjeshme sociale, si dhe mbështetjen e familjeve të tyre.

II. PUNË ME ARSIMTARË

Nën-fusha: MBËSHTETJE E ARSIMTARËVE GJATË PLANIFIKIMIT DHE REALIZIMIT TË PROCESIT EDUKATIVO-ARSIMOR DHE VETËVLERËSIMIT

PUNËTORI SOCIAL...



A. KUPTIME DHE NJOHURI PROFESIONALE	B. AFTËSI DHE SHKATHTËSI PROFESIONALE
1. I di potencialet dhe rreziqet gjatë nxënies së nxënësve me prejardhje të ndryshme socio-kulturore.	1.1 Ndhmon arsimtarët gjatë planifikimit t'u kushtojnë kujdes karakteristikave sociale dhe kulturore të mjedisit dhe familjeve të nxënësve.



SHEMBUJ TË PRAKTIKËS PROFESIONALE



- Realizon punëtori ose u ofron ndihmë individuale arsimtarëve për mënyra të ndryshme të mbledhjes së të dhënave për gjendjen sociale të nxënësve (kushtet e jetesës, nxënies, mundësi për përparim).

II. PUNË ME ARSIMTARË

Nën-fusha: MBËSHTETJE E ARSIMTARËVE GJATË PUNËS ME NXËNËS

PUNËTORI SOCIAL...



A. KUPTIME DHE NJOHURI PROFESIONALE	B. AFTËSI DHE SHKATHTËSI PROFESIONALE
1. Njeh teknikat e ndërmjetësimit dhe zgjidhjes së konflikteve në punën sociale.	1.1 Posedon shkathtësi për përfaqësim, konsultim, këshillim dhe ndërmjetësim në punën sociale.



SHEMBUJ TË PRAKTIKËS PROFESIONALE

- Realizon punë këshillëdhënëse dhe konsultative me arsimtarët për punë më efektive me nxënës në rrezik social.
- Përfshin arsimtarët në realizimin e programeve për parandalim social.

II. PUNË ME ARSIMTARË

Nën-fusha: MBËSHTETJE E ARSIMTARËVE GJATË PUNËS ME PRINDËR

PUNËTORI SOCIAL...



A. KUPTIME DHE NJOHURI PROFESIONALE	B. AFTËSI DHE SHKATHTËSI PROFESIONALE
1. Njeh teknikat e ndërmjetësimit dhe zgjidhjes së konflikteve në punën sociale me prindër.	1.1 Posedon shkathtësi për përfaqësim, konsultim, këshillim dhe ndërmjetësim me prindër nga familjet në rrezik social.



SHEMBUJ TË PRAKTIKËS PROFESIONALE

- Realizon punë këshillëdhënëse dhe konsultative me arsimtarë për miratimin e qasjes përkatëse ndaj prindërve për shkak të parandalimit të vështirësive në shoqërim që paraqiten në familjet në rrezik social.
- Realizon punë këshillëdhënëse dhe konsultative me arsimtarët për punë më efektive me prindërit e nxënësve nga familjet me probleme sociale.
- Përfshin arsimtarët në realizimin e programeve për parandalim social me prindër.
- Ndërmjetëson në përballje me konfliktet mes arsimtarit dhe prindit/grupit të prindërve.

III. PUNË ME PRINDËR

PUNËTORI SOCIAL punon veçanërisht me prindërit e kategorive të ndjeshme sociale, u ndihmon që t'i realizojnë të drejtat e mbrojtjes sociale, të vendosin rrjetin për mbështetje sociale dhe të realizojnë komunikim dhe bashkëpunim përkatës me shkollën. Po ashtu, punon edhe në realizimin e programeve për parandalim social të dedikuara për prindërit e nxënësve.

III. PUNË ME PRINDËR

Nën-fusha: KËSHILLIME DHE KONSULTIME INDIVIDUALE DHE GRUPORE ME PRINDËR

PUNËTORI SOCIAL...



A. KUPTIME DHE NJOHURI PROFESIONALE	B. AFTËSI DHE SHKATHTËSI PROFESIONALE
1. Njeh qasjet për punë me familje dhe raste individuale.	1.1 Ofron mbështetje sociale për familjet. 1.2 Përfaqëson të drejtat dhe interesat e prindërve nga familjet që gjenden në rrezik social dhe i ndërlidhë me familjet me resurse të nevojshme. 1.3 Posedon shkathtësi për vlerësim, planifikim dhe intervenim direkt dhe indirekt në familjet që gjenden në rrezik social dhe shfrytëzon teknika përkatëse (eko-hartë, genogram, kulturogram, etj.).



SHEMBUJ TË PRAKTIKËS PROFESIONALE

- Zbaton metoda të punës individuale dhe grupore sociale me prindërit e nxënësve nga familjet në rrezik social, të cilët kanë nevojë për mbështetje plotësuese gjatë nxënies, si dhe probleme gjatë shoqërizimit.
- Nxitë formimin e grupeve për vetë ndihmë mes prindërve të cilët përballen me vështirësi të ngjashme sociale.
- Ndihmon në realizimin e të drejtave dhe ndihmave sociale nga sistemi për mbrojtje sociale.
- Realizon programe për parandalim social për prindër.
- Realizon konsultim me prindër dhe sipas nevojës, udhëzon drejtë shërbimeve profesionale nga sfera e mbrojtjes sociale.
- Inicion dhe udhëheqë qendra për konsultime për prindër ose qendra familjare për mbështetjen e prindërve.
- Bën shqyrtim profesional në shtëpinë e familjeve të nxënësve të cilët paraqesin shenjat e para të problemeve sociale ose që tashmë përballen me ndonjë problem social.

III. PUNË ME PRINDËR

Nën-fusha: **EDUKIM I PRINDËRVE**

PUNËTORI SOCIAL...



A. KUPTIME DHE NJOHURI PROFESIONALE	B. AFTËSI DHE SHKATHTËSI PROFESIONALE
1. Dallon rolin e edukimit të prindërve për përmirësimin e sukseseve arsimore të nxënësve dhe parandalimin e paraqitjes së problemeve sociale.	1.1 Krijon, realizon dhe vlerëson programe nga sfera e parandalimit social.



SHEMBUJ TË PRAKTIKËS PROFESIONALE

- Organizon tribuna për tema aktuale sociale.
- Organizon dhe përfshin prindër në punëtori për identifikimin/tejkalimin e rreziqeve sociale dhe ndikimin e tyre në zhvillimin e nxënies së fëmijëve.

III. PUNË ME PRINDËR

Nën-fusha: **PËRFSHIRJE E PRINDËRVE NË JETËN DHE PUNËN E SHKOLLËS**

PUNËTORI SOCIAL...



A. KUPTIME DHE NJOHURI PROFESIONALE	B. AFTËSI DHE SHKATHTËSI PROFESIONALE
1. Njeh modalitetet e bashkëpunimit në mes shkollës dhe familjes.	1.1 Motivon dhe përfshin prindërit nga familjet me rrezik social në punën e shkollës.



SHEMBUJ TË PRAKTIKËS PROFESIONALE

- Ndhmon në sigurimin e bashkëpunimit të prindërve përmes përfshirjes së tyre me përfaqësues të tyre në trupa të ndryshëm punues dhe trupa dhe këshilla tjerë të shkollës.
- Angazhohet që prindërit nga familjet me rrezik social të jenë të përfshirë në mënyrë përkatëse në punën e shkollës.
- Ndhmon në sigurimin dhe përparimin e vazhdueshëm të bashkëpunimit në mes familjeve të nxënësve dhe shkollës.

IV. BASHKËPUNIM ME BASHKËSINË

PUNËTORI SOCIAL bashkëpunon me: qendrën për punë sociale, organizata sportive, humanitare, joqeveritare dhe organizata tjera, institucione sociale dhe shëndetësore, organizata fetare, sektorin privat, policinë dhe komunën, për sigurimin e ndihmës dhe mbështetjes së nxënësve dhe familjeve të tyre në situatë të nevojës sociale dhe për mbështetje të aktiviteteve programore që i realizon punëtori social në shkollë. Përmes zbatimit të metodave të punës sociale në bashkësinë lokale e animon bashkësinë, mobilizon mbështetjen dhe e zhvillon bashkëpunimin në mes bashkësisë lokale dhe shkollës.

IV. BASHKËPUNIM ME BASHKËSINË

Nën-fusha: **BASHKËPUNIM ME BASHKËSINË LOKALE**

PUNËTORI SOCIAL...



A. KUPTIME DHE NJOHURI PROFESIONALE	B. AFTËSI DHE SHKATHTËSI PROFESIONALE
1. Njeh metodikën e punës sociale në bashkësinë lokale.	1.1 Shfrytëzon modele të ndryshme të punës sociale në bashkësinë lokale (zhvillim social, planifikim social, aksion social dhe përforsim).



SHEMBUJ TË PRAKTIKËS PROFESIONALE



- Punon me bashkësinë lokale për plotësimin e nevojave të mbrojtjes sociale të kategorive të ndjeshme sociale të nxënësve dhe familjeve të tyre.
- Punon në iniciimin dhe vendosjen e bashkëpunimit, negocimit, përfaqësimit, aktivizimit të bashkësisë, mobilizimit të mjeteve, iniciimit të projekteve të përbashkëta për nevojat e realizimit të aktiviteteve programore me karakter social në shkollë.

IV. BASHKËPUNIM ME BASHKËSINË

Nën-fusha: BASHKËPUNIM ME INSTITUCIONE
DHE ORGANIZATA PROFESIONALE

PUNËTORI SOCIAL...



A. KUPTIME DHE NJOHURI PROFESIONALE	B. AFTËSI DHE SHKATHTËSI PROFESIONALE
1. Posedon njohuri nga fusha e punës së rrjetëzuar sociale.	1.1 Di të vendosë bashkëpunim të rrjetëzuar me organizata dhe institucione të jashtme.



AFTËSI DHE SHKATHTËSI PROFESIONALE



- Bashkëpunon me pushtetin lokal për sigurimin e ndihmës dhe mbështetjes për nxënës të rrezikuar social dhe përfshirjen e administratës komunale në mbështetjen e programeve që i realizon punëtori social në shkollë.
- Bashkëpunon me qendrën për punë sociale për t'u ofruar ndihmë të specializuar dhe profesionale nxënësve dhe familjeve me probleme sociale.
- Bashkëpunon me institucione sociale (shtëpi për fëmijë pa prindër dhe përkujdesje prindërore, shtëpi për fëmijët e anashkaluar në aspektin edukativ, etj.).
- Bashkëpunon me sektorin fetar dhe privat për sigurimin e mbështetjes së aktiviteteve programore në shkollë për nxënësit nga familjet me rrezik social.
- Bashkëpunon me organizata joqeveritare që realizojnë programe sociale për shkak të përfshirjes së nxënësve në to, dhe për përfshirjen e organizatave joqeveritare në realizimin e programeve parandaluese që i realizon punëtori social në shkollë.

VI. PUNË ANALITIKE-HULUMTUESE

PUNËTORI SOCIAL mbledhë të dhëna përmes realizimit të hulumtimeve cilësore dhe sasiore me të cilat e shqyrton përbërjen sociale të nxënësve dhe i analizon marrëdhëniet dhe ndikimet në mes faktorëve socialë dhe përparimit të nxënësve. Analizon gjendjen sociale në institucion për shkak të përcaktimit të arsyeve eventuale për probleme të caktuara edukativo-arsimore, për mospë suksesin e disa nxënësve të caktuar dhe propozon masa për tejkalimin e tyre.

VI. PUNË ANALITIKE-HULUMTUESE

Nën-fusha: HULUMTIM I PUNËS EDUKATIVO-ARSIMORE

PUNËTORI SOCIAL...



A. KUPTIME DHE NJOHURI PROFESIONALE	B. AFTËSI DHE SHKATHTËSI PROFESIONALE
1. Njeh bazat e metodologjisë hulumtuese të punës sociale në arsim.	1.1 Posedon shkathtësi për realizimin e hulumtimeve sociale cilësore dhe sasiore. 1.2 Posedon shkathtësi për përpilimin e instrumenteve të nevojshme për realizimin e hulumtimeve sociale.



SHEMBUJ TË PRAKTIKËS PROFESIONALE



- Ndjekë dhe hulumton shkaqet e sjelljes problematike, mospërfilljes edukative, thyerjes së disiplinës dhe mospë suksesit të nxënësve, që janë të kushtëzuar nga gjendja familjare dhe sociale.
- Përpunon instrumente (pyetësorë, lista kontrolluese, etj.) dhe realizon hulumtime vepruese nga fusha e punës sociale në arsim.

VII. STRUKTURË, ORGANIZIM DHE KLIMË SHKOLLORE

PUNËTORI SOCIAL kontribuon në ndërtimin e klimës pozitive në shkollë përmes programeve për pasurimin e jetës sociale në shkollë, si dhe sigurimin e inkluzionit (përfshirjes) sociale në bazë të barabartë pa diskriminim në çfarëdo baze për të gjithë nxënësit. Ai përfshihet edhe në dhënien e propozimeve dhe rekomandimeve për ndryshime sistimore në funksionimin e shkollës kur ky funksionim reflektohet negativisht në klimën sociale në shkollë, shoqërizimin e nxënësve dhe sukseset e tyre arsimore.

VII. STRUKTURË, ORGANIZIM DHE KLIMË SHKOLLORE

Nën-fusha: STRUKTURË DHE ORGANIZIM SHKOLLOR (PLANIFIKIM, NDJEKJE E PUNËS EDUKATIVO-ARSIMORE, EVIDENCË DHE DOKUMENTACION PEDAGOGJIK, EVALVIM)

PUNËTORI SOCIAL...



A. KUPTIME DHE NJOHURI PROFESIONALE

1. Është i njoftuar me bazat për planifikim dhe programim si dhe vlerësim të punës sociale në shkolla.

B. AFTËSI DHE SHKATHTËSI PROFESIONALE

- 1.1 Shfrytëzon teknika për programim dhe vlerësim të punës sociale me individë dhe familje.

SHEMBUJ TË PRAKTIKËS PROFESIONALE

- Mban evidencë për nxënësit që janë në gjendje të nevojës sociale (dosje, analiza, udhëzime specialiste drejtuar institucioneve).
- Mban dokumentacion nga bashkëpunimi me familjen dhe institucionet për mbrojtje sociale.

VII. STRUKTURË, ORGANIZIM DHE KLIMË SHKOLLORE

Nën-fusha: KLIMË SHKOLLORE, MJEDIS I SIGURT DHE PJESËMARRJE DEMOKRATIKE E NXËNËSVE

PUNËTORI SOCIAL... 


A. KUPTIME DHE NJOHURI PROFESIONALE	B. AFTËSI DHE SHKATHTËSI PROFESIONALE
1. Njeh rreziqet sociale për familjet që shpijnë drejt përjashtimit të nxënësve nga procesi arsimor.	1.1 Përfaqëson të drejtat e individëve dhe grupeve të ndjeshme dhe marginalizuara. 1.2 Punon në sigurimin e përfshirjes së plotë të nxënësve nga familjet me rrezik social



SHEMBUJ TË PRAKTIKËS PROFESIONALE



- Kujdeset për sigurimin e përfshirjes përkatëse sociale të grupeve të marginalizuara të nxënësve në jetën shkollore.
- Punon me familjet me rrezik social në sigurimin e përfshirjes së fëmijëve të tyre në procesin arsimor.
- Siguron dhe rregullisht i azhurnon të dhënat për kushtet socio-ekonomike në familjet e nxënësve.
- Merr pjesë në strukturimin e paraleleve dhe grupeve (aktivitete jashtëmësimore dhe të tjera), në bazë të të dhënave paraprakisht të përcaktuara për gjendjen sociale.



KOMPETENCA SPECIFIKE PËR DEFEKTOLOG

PUNË ME NXËNËS

DEFEKTOLOGU punon kryesisht me nxënësit me nevoja të posaçme arsimore⁷, detekton dhe vlerëson⁸ nevojat e tyre specifike dhe u jep mbështetje në procesin e nxënies dhe përparimit. Me qëllim që t'u sigurohet qasje deri te përmbajtjet mësimore dhe nxënia më efektive, defektologu shfrytëzon teknika të ndryshme përkatëse, metoda, strategji, procedura rehabilituese dhe teknologji përkatëse ndihmëse. Njëherësh, defektologu bashkë me ekipin inkluziv (përfshirës) i vëzhgon në mënyrë të vazhdueshme të arriturat e tyre në nxënie në pajtim me qëllimet e parashtruara individuale në planin individual arsimor dhe merr pjesë në krijimin e kulturës inkluzive (përfshirëse), politikës dhe praktikës inkluzive (përfshirëse) në shkollë.

7 Nxënës me nevoja të posaçme arsimore me të cilët punojnë defektologët janë nxënësit e Kategorisë A, si dhe nxënës me vështirës specifike në nxënie nga Kategoria B (disleksion, disgrafi dhe diskalkuli) sipas përkufizimit të OECD-së për nxënësit të cilëve u nevojitet mbështetje plotësuese në arsim. Sipas këtij përkufizimi, nxënësit të cilëve u nevojitet mbështetje plotësuese në arsim janë grupuar në tre kategori:

A. "Nxënës me nevoja të posaçme ose dëmtim, shikuar nga aspekti mjekësor si çrregullime organike që mund t'i përshkruhen patologjisë organike (për shembull, lidhur me dëmtimet shqisore, motorike ose neurologjike). Konsiderohet se nevojat arsimore rezultojnë kryesisht nga problemet që u përshkruhen këtyre çrregullimeve";

B. "Nxënës me çrregullime ose trazim në sjellje, emocione, ose me vështirësi specifike në nxënie. Konsiderohet se nevojat arsimore rezultojnë kryesisht nga problemet në bashkëveprimin ndërmjet nxënësit dhe kontekstit arsimor" dhe

C. "Nxënës që kanë nevojë për mbështetje të posaçme në arsim për shkak të faktorëve të pavolitshëm socio-ekonomik, kulturor dhe/ose gjuhësor. Ndihma e nevojshme plotësuese ka të bëjë edhe me nevojën që të kompensohen disavantazhet (jovolitshmëritë) që u përshkruhen këtyre faktorëve." *Students with Disabilities, Learning Difficulties and Disadvantages: Policies, Statistics and Indicators* © OECD 2007, ISBN 978-92-64-02762-6, <http://www.oecd.org/edu/school/40299703.pdf>

8 Sipas Klasifikimit Ndërkombëtar të Funkcionaliteteve (KNF/ICF – International classification of functionalities) <http://www.who.int/classifications/icf/en/>

I. PUNË ME NXËNËS

Nën-fusha: MBËSHTETJE E NXËNËSVE GJATË NXËNIES

DEFEKTOLIGU...



A. KUPTIME DHE NJOHURI PROFESIONALE	B. AFTËSI DHE SHKATHTËSI PROFESIONALE
1. Posedon njohuri për karakteristikat specifike të nxënësve me nevoja të posaçme arsimore.	1.1 Ofron mbështetje përkatëse dhe e vëzhgon përparimin e nxënësve me nevoja të posaçme arsimore.
2. Posedon njohuri për teknika dhe strategji përkatëse për vlerësimin e nevojave arsimore të nxënësve me nevoja të posaçme arsimore.	2.1 Shfrytëzon diferencim dhe individualizim me qëllim që të sigurojë qasje në përmbajtjet mësimore. 2.2 Shfrytëzon teknologji ndihmëse në punën me nxënës me nevoja të posaçme arsimore.



SHEMBUJ TË PRAKTIKËS PROFESIONALE



- Përcakton dhe ua jep mbështetjen përkatëse nxënësve në përputhje me nevojat e tyre arsimore.
- Koordinon përpunimin e PIA-së.
- U jep nxënësve me nevoja të posaçme arsimore ndihmë të drejtpërdrejtë gjatë nxënies.
- Planifikon dhe shfrytëzon teknologjinë ndihmëse në punën me nxënësit, dhe e përfshinë në PIA-në.
- Përshtatë mbështetjen sipas njohurive nga vëzhgimi i përparimit.

I. PUNË ME NXËNËS

Nën-fusha: VËZHGIM DHE MBËSHTETJE TË ZHVILLIMIT TË NXËNËSVE

DEFEKTOLIGU...



A. KUPTIME DHE NJOHURI PROFESIONALE	B. AFTËSI DHE SHKATHTËSI PROFESIONALE
1. Posedon njohuri për vëzhgimin e efekteve të PIA-së.	1.1 Merr pjesë/bën revizionin e PIA-së. 1.2 Përcakton nevojën e shërbimeve plotësuese për mbështetje.





SHEMBUJ TË PRAKTIKËS PROFESIONALE

- Sintetizon dhe interpreton të dhënat e fituara nga të gjithë anëtarët e ekipit inkluziv (përfshirës) dhe institucioneve relevante që ofrojnë shërbime.
- Organizon mbështetje defektologjike.
- Koordinon përfshirjen e profesionistëve të jashtëm.

I. PUNË ME NXËNËS

Nën-fusha: ORIENTIM PROFESIONAL DHE NË KARRIERË I NXËNËSVE

DEFEKTOLOGU...



A. KUPTIME DHE NJOHURI PROFESIONALE	B. AFTËSI DHE SHKATHTËSI PROFESIONALE
1. Një karakteristikat specifike të nxënësve me nevoja të posaçme arsimore dhe një sërë profesioneve përkatëse për nxënësit me nevoja të posaçme arsimore.	1.1 Ofron mbështetje gjatë përzgjedhjes përkatëse të profesioneve.



SHEMBUJ TË PRAKTIKËS PROFESIONALE

- Informon nxënësit me nevoja të posaçme arsimore për profesionet përkatëse
- Bën këshillim individual dhe grupor me nxënës me nevoja të posaçme arsimore për përzgjedhjen e drejtë të arsimit të mëtejshëm ose profesionit.

II. PUNË ME ARSIMITARË

DEFEKTOLOGU i mbështetë arsimtarët në punën me fëmijë me nevoja të posaçme arsimore, me theks të veçantë në përpilimin e planit individual arsimor dhe realizimin e të njëjtit, si dhe në përfshirjen përkatëse të këtyre nxënësve në mësimin e rregullt dhe në aktivitetet tjera edukativo-arsimore.

II. PUNË ME ARSIMITARË

Nën-fusha: MBËSHTETJE E ARSIMITARËVE GJATË PLANIFIKIMIT DHE REALIZIMIT TË PROCESIT EDUKATIVO-ARSIMOR DHE VETËVLERËSIMIT

DEFEKTOLOGU...



A. KUPTIME DHE NJOHURI PROFESIONALE	B. AFTËSI DHE SHKATHTËSI PROFESIONALE
1. Njeh mënyra përkatëse për modifikime dhe adaptime të mësimin dhe hapësirës, si dhe vlerësimin e të arriturave sipas PIA-së.	1.1 Përpilon/përzgjedhë, teknika metodike, mjete për punë dhe instrumente për notim që janë përkatëse me llojin e nevojave të posaçme arsimore, me qëllimet e parashtruara në PIA-në dhe me stilin e nxënies së nxënësit.



SHEMBUJ TË PRAKTIKËS PROFESIONALE

- Ofron ndihmë profesionale arsimtarëve gjatë përzgjedhjes/përpunimit të instrumenteve për notim për nxënësit me nevoja të posaçme arsimore.
- Jep udhëzime për modifikimet dhe adaptimet e domosdoshme në mësim, me qëllim që nxënësi maksimalisht të marrë pjesë dhe të arrijë rezultate.
- Jep udhëzime (konsultime grupore ose individuale) për dokumentimin e të arriturave të nxënësve me nevoja të posaçme arsimore.

II. PUNË ME ARSIMITARË

Nën-fusha: MBËSHTETJE E ARSIMITARËVE GJATË PUNËS ME NXËNËS

DEFEKTOLOGU...



A. KUPTIME DHE NJOHURI PROFESIONALE

1. Një karakteristikat e nxënësve me nevoja të posaçme arsimore.


B. AFTËSI DHE SHKATHTËSI PROFESIONALE

- 1.1 Forcon kapacitetet e arsimtarëve për identifikimin e punës me këta nxënës.



SHEMBUJ TË PRAKTIKËS PROFESIONALE

- U ofron ndihmë profesionale arsimtarëve, përmes takimeve individuale ose grupe dhe trajnimeve për identifikimin e nxënësve me nevoja të posaçme arsimore dhe strategjive për punë me ta.
- Zhvillon formularë, përmes të cilave arsimtarët bëjnë vlerësimin funksional të nivelit momental të zhvillimit të nxënësve dhe vëzhgojnë përparimin e tyre.




III. PUNË ME PRINDËR

DEFEKTOLOGU, përmes punës këshillëdhënëse dhe mbështetjes së drejtpërdrejtë të prindërve të fëmijëve me nevoja të posaçme arsimore, mundëson që ata t'i kuptojnë dhe pranojnë nevojat dhe mundësitë e posaçme të fëmijës së tyre dhe i udhëzon se si, në bashkëpunim me ekipin në shkollë, të punojnë në qëndrueshmërinë dhe zhvillimin e asaj që fëmija e di dhe mundet ta bëjë.

III. PUNË ME PRINDËR

Nën-fusha: KËSHILLIME DHE KONSULTIME INDIVIDUALE DHE GRUPORE ME PRINDËR

DEFEKTOLOGU... 

A. KUPTIME DHE NJOHURI PROFESIONALE	B. AFTËSI DHE SHKATHTËSI PROFESIONALE
1. I di mënyrat e mbështetjes së prindërve gjatë punës me fëmijë me nevoja të posaçme arsimore.	1.1 Ndhmon prindërit e fëmijëve me nevoja të posaçme arsimore që ta kuptojnë gjendjen e fëmijëve të tyre dhe t'ua ofrojnë ndihmën dhe mbështetjen e nevojshme.
2. Di specifikat për këshillim efektiv të prindërve të fëmijëve me nevoja të posaçme arsimore.	2.1 Shfrytëzon metoda të ndryshme për konsultime individuale dhe grupore të prindërve të fëmijëve me nevoja të posaçme arsimore.



SHEMBUJ TË PRAKTIKËS PROFESIONALE



- Informon prindërit e fëmijëve me nevoja të posaçme arsimore për të drejtat, obligimet dhe ndihmën që mund të marrin dhe i udhëzon drejt institucioneve relevante për ndihmë.
- Realizon konsultime individuale me prindërit për mbështetjen e fëmijëve me nevoja të posaçme arsimore.
- U ofron instruksione prindërve se si të punojnë me fëmijët e tyre në kushte shtëpiake.

IV. BASHKËPUNIM ME BASHKËSINË

DEFEKTOLOGU bashkëpunon me institucione arsimore, shëndetësore, sociale, si dhe institucione të specializuara që kontribuojnë për zhvillimin dhe nxënien e fëmijëve me nevoja të posaçme arsimore. Mund të bashkëpunojë me shkolla tjera në rrethinën e afërt për shkak të sigurimit të ndihmës këshillëdhënëse në raport me fëmijët me nevoja të posaçme arsimore.

IV. BASHKËPUNIM ME BASHKËSINË

Nën-fusha: **BASHKËPUNIM ME BASHKËSINË LOKALE**

DEFEKTOLOGU...



A. KUPTIME DHE NJOHURI PROFESIONALE

1. Është i informuar për ndërmarrjet përkatëse në të cilat mund të realizohet mësimi praktik.

B. AFTËSI DHE SHKATHTËSI PROFESIONALE

- 1.1 Ndërlidhë karakteristikat e nxënësve me format e mësimi praktik.



SHEMBUJ TË PRAKTIKËS PROFESIONALE

- Përfshihet në procesin e planifikimit, organizmit dhe vëzhgimit të mësimi praktik në shkollat e mesme profesionale.

V. ZHVILLIM PROFESIONAL DHE BASHKËPUNIM PROFESIONAL

V. ZHVILLIM PROFESIONAL DHE BASHKËPUNIM PROFESIONAL

Nën-fusha: MBËSHTETJE E ZHVILLIMIT
DHE BASHKËPUNIMIT PROFESIONAL NË SHKOLLË

DEFEKTOLOGU...



A. KUPTIME DHE NJOHURI PROFESIONALE	B. AFTËSI DHE SHKATHTËSI PROFESIONALE
1. Njeh kompetencat themelore profesionale për arsimtarë.	1.1 Ndërlidhë format dhe përmbajtjet e zhvillimit profesional me kompetencat e nevojshme të arsimtarëve.



SHEMBUJ TË PRAKTIKËS PROFESIONALE



- Mban dokumentacion për zhvillimin profesional të arsimtarëve.

VI. PUNË ANALITIKE-HULUMTUESE

DEFEKTOLOGU mbledhë të dhëna për numrin e nxënësve me nevoja të posaçme në shkollë, mban regjistër dhe rregullisht e azhurnon. Të dhënat e fituara i shfrytëzon për analiza krahasuese në raport me rritjen ose zvogëlimin e numrit çdo vit shkollor, planifikim të pajisjes së shkollës me mjete të konkretizimit dhe mjete ndihmëse, si dhe zhvillim profesional të arsimtarëve. Po ashtu, defektologu bën analizë të zhvillimit të klimës inkluzive (përfshirëse) në shkollë dhe përfshirjes së nxënësve me nevoja të posaçme arsimore në përmbajtjet mësimore dhe jashtëmësimore.

VI. PUNË ANALITIKE-HULUMTUESE

Nën-fusha: HULUMTIM I PUNËS EDUKATIVO-ARSIMORE

DEFEKTOLOGU...



A. KUPTIME DHE NJOHURI PROFESIONALE

1. Njeh procedurat për realizimin e hulumtimit veprues në mësim.

B. AFTËSI DHE SHKATHTËSI PROFESIONALE

- 1.1 Realizon hulumtime vepruese për përmirësimin e mësimdhënies.



SHEMBUJ TË PRAKTIKËS PROFESIONALE

- Propozon hulumtime vepruese për rritjen e efektivitetit të mësimit.
- Merr pjesë në hulumtimet vepruese në mësim.
- Interpretin njohuritë nga hulumtimet vepruese dhe propozon aktivitete të ardhshme.

VII. STRUKTURË, ORGANIZIM DHE KLIMË SHKOLLORE

DEFEKTOLÖGU ka rol parësor në ndërtimin e klimës dhe kulturës inkluzive për pranimin e fëmijëve me nevoja të posaçme arsimore.

VII. STRUKTURË, ORGANIZIM DHE KLIMË SHKOLLORE

Nën-fusha: STRUKTURË DHE ORGANIZIM SHKOLLOR
(PLANIFIKIM, VËZHGIM TË PUNËS EDUKATIVO-ARSIMORE, EVIDENCË
DHE DOKUMENTACION PEDAGOGJIK, EVALVIM)

DEFEKTOLÖGU...



A. KUPTIME DHE NJOHURI PROFESIONALE	B. AFTËSI DHE SHKATHTËSI PROFESIONALE
1. E di strukturën e evidencës dhe dokumentacionit për nxënësit me nevoja të posaçme arsimore dhe mënyrat e mbajtjes së tyre.	1.1 Organizon dhe/ose realizon vëzhgim periodik të përpilimit të evidencës dhe dokumentacionit për nxënësit me nevoja të posaçme arsimore.




SHEMBUJ TË PRAKTIKËS PROFESIONALE



- Vëzhgon mënyrën e mbajtjes së evidencës dhe dokumentacionit për nxënësit me nevoja të posaçme arsimore dhe propozon masa për përmirësim.
- Vendorsë procedura për evidencë të dosjeve të nxënësve me nevoja të posaçme arsimore.

VII. STRUKTURË, ORGANIZIM DHE KLIMË SHKOLLORE

Nën-fusha: KLIMË SHKOLLORE, MJEDIS I SIGURT
DHE PJESËMARRJE DEMOKRATIKE E NXËNËSVE

DEFEKTOLOGU... 


A. KUPTIME DHE NJOHURI PROFESIONALE	B. AFTËSI DHE SHKATHTËSI PROFESIONALE
1. Kupton rëndësinë e përfshirjes së nxënësve me nevoja të posaçme arsimore në të gjitha aktivitetet e shkollës.	1.1 Kujdeset për përfshirjen adekuate të nxënësve me nevoja të posaçme arsimore në aktivitetet e bashkësive të nxënësve.



SHEMBUJ TË PRAKTIKËS PROFESIONALE



- Informon dhe këshillon nxënësit me pengesa në zhvillim si të përfshihen në aktivitete përkatëse të bashkësive të nxënësve.
- Ndihmon bashkësitë e nxënësve që t'i pranojnë nxënësit me pengesa në zhvillim.



KOMPETENCA SPECIFIKE PËR BIBLIOTEKIST

PUNË ME NXËNËS

BIBLIOTEKISTI në punën me nxënës përveç asaj që u siguron burime të ndryshme për nxënie dhe u jep udhëzime për shfrytëzimin e tyre, organizon dhe përfshihet në aktivitete të ndryshme jashtëmësimore (seksione të bibliotekës, të letërsisë dhe të dramës, klube të shkrimtarëve të rinj, etj.). Veçanërisht është e rëndësishme të posedojë kompetenca dhe t'u japë mbështetje (individuale dhe përmes llojeve të ndryshme të aktiviteteve grupore) nxënësve për zhvillimin e shkathtësive të tyre për leximin e literaturës me dedikim të ndryshëm dhe për nevoja të ndryshme, si dhe shkathtësive për hulumtim përmes shfrytëzimit të burimeve të ndryshme të informacioneve (të shkruara, elektronike).

I. PUNË ME NXËNËS

Nën-fusha: MBËSHTETJE E NXËNËSVE GJATË NXËNIES

BIBLIOTEKISTI...




A. KUPTIME DHE NJOHURI PROFESIONALE	B. AFTËSI DHE SHKATHTËSI PROFESIONALE
1. Njeh strategji përkatëse për mësim dhe mbështetje të nxënësve gjatë nxënies në përputhje me karakteristikat individuale.	1.1 Është i ndjeshëm për nevojat e ndryshme arsimore të nxënësve, di të identifikojë dhe të sigurojë mbështetje përkatëse.
2. Njeh faktorët që ndikojnë në procesin e nxënies dhe motivimit të nxënësve.	1.2 Ndërlidhë teoritë për nxënie me kërkimin dhe shfrytëzimin e informacioneve. 2.1 Ndërton standarde të larta personale të nxënësit për sukses dhe qëndrim pozitiv ndaj leximit dhe nxënies. 2.2 Identifikon faktorë potencial negativ në nxënien dhe i merr parasysh në punën me nxënësit.
3. Njeh metoda dhe teknika për punë me nxënës dhe këshillimin e tyre të suksesshëm për lexim dhe nxënie.	3.1 Qasjet në mbështetjen e nxënësve dhe nxënies i harmonizon me nevojat e tyre specifike.
4. Njeh specifikat kulturore të mjedisit në të cilin gjendet shkolla.	4.1 Di të përzgjedhë materiale përkatëse për t'i plotësuar nevojat e shfrytëzuesve të ndryshëm.
5. Ka njohuri themelore të gjuhëve në të cilat zhvillohet mësimi në shkollë dhe të gjuhëve të huaja që mësohen në shkollë.	5.1 Është i aftë të gjejë dhe ofrojë edhe literaturë në gjuhët mësimore në shkollë edhe në gjuhët e huaja që mësohen në shkollë.
6. Njeh parime të punës në punëtori.	6.1 Ka shkathtësi për moderimin (udhëheqjen) e punëtorive edukative.
7. Njeh strategji dhe teknika efektive për lexim dhe nxënie.	7.1 Ndhmon nxënësit që të zhvillojnë shkathtësi për lexim dhe nxënie të pavarur.



SHEMBUJ TË PRAKTIKËS PROFESIONALE

- Rekomandon literaturë përkatëse për mbështetjen e përmbajtjeve mësimore ose literaturës së lirë.
- Vëzhgon përparimin e nxënësve në shfrytëzimin e informacioneve dhe u jep udhëzime përkatëse.
- Nxitë dhe mbështetë nxënësit që të paraqiten në konkurse dhe gara.
- Mbledhë të dhëna për prejardhjen kulturore dhe shprehitë e nxënësve (bën anketime, intervista, diskutime me fokus grupe) dhe i merr parasysh të dhënat për kulturën e tyre të leximit, shfrytëzimin e burimeve të informacioneve, etj.
- Shfrytëzon instrumente të ndryshme për mbledhjen e informacioneve për interesat, shprehitë përmes leximit të nxënësve dhe stilet e nxënies.
- Rekomandon literaturë përkatëse për plotësimin e interesave të nxënësve dhe stilet e nxënies.
- Shfrytëzon qasje të ndryshme në punën me nxënës (individuale, grupore, studim të literaturës, diskutime, debate).
- Siguron materiale në gjuhë të ndryshme, për kultura, bashkësi, religjione të ndryshme, etj. me qëllim që të njihen më mirë mes veti njerëzit në bashkësi.
- Informon dhe udhëzon nxënësit për literaturën e nevojshme në gjuhë të ndryshme mësimore.
- Realizon punëtori kreative, punëtori letrare (p.sh. për lexim, shkrim, hulumtim përmes internetit, shfrytëzim i multimedive etj.).
- Mëson nxënësit në mënyrë individuale dhe/ose grupore se si të shfrytëzojnë resurse të ndryshme për hulumtim.
- Udhëzon nxënësit që në mënyrë kritike dhe analitike të lexojnë dhe vlerësojnë përmbajtje dhe burime të ndryshme të informacioneve.



I. PUNË ME NXËNËS

Nën-fusha: VËZHIM DHE MBËSHTETJE TË ZHVILLIMIT TË NXËNËSVE

BIBLIOTEKISTI...



A. KUPTIME DHE NJOHURI PROFESIONALE	B. AFTËSI DHE SHKATHTËSI PROFESIONALE
1. Kupton sfidat në komunikimin dhe bashkëpunimin me pjesëtarë të kulturave të ndryshme, me vlera dhe përvoja të ndryshme. 2. E di rëndësinë e leximit për zhvillim personal dhe social dhe njeh mënyra të ndryshme të motivimit për lexim. 3. Di modele dhe forma të udhëheqjes së aktiviteteve jashtëmësimore për shkrim dhe lexim. 4. Njeh botimet aktuale në literaturën (shkencore dhe artistike) për fëmijë/të rinj.	1.1 Komunikon me nxënësit në mënyrën që siguron mbështetje dhe besim. 1.2 Komunikimin me nxënësit e mbështet në respekt dhe kujdes, duke promovuar vlera, qëndrime dhe sjellje pozitive që i pret edhe nga ana e tyre. 2.1 Shfrytëzon qasje të ndryshme për motivim dhe zhvillim të interesave për lexim. 2.2 Zhvillon aftësi për lexim analitik dhe kritik. 3.1 Organizon lloje të ndryshme të aktiviteteve jashtëmësimore për shkrim dhe lexim. 4.1 Përzgjedh materiale të formatit të ndryshëm për mbështetjen e leximit për shkak të nxënies dhe për kënaqësi.



SHEMBUJ TË PRAKTIKËS PROFESIONALE



- Praktikon mekanizma që i mundësojnë nxënësit të marrin mbështetje nga bashkëpunëtori profesional gjithmonë kur i nevojitet (nxënësit janë informuar për llojin e mbështetjes që mund ta marrin nga bibliotekisti).
- Dëgjon dhe respekton në mënyrë aktive qëndrimet, mendimet dhe interesat e nxënësve.
- Shfrytëzon lloje të ndryshme të strategjive dhe qasjeve në komunikimin individual dhe grupor me nxënësit.
- Mëson nxënësit se si të lexojnë zhanre të ndryshme.
- Udhëzon nxënësit që të lexojnë me kuptim.
- Promovon lexim për relaksim dhe për nxënie të përgjeshme.
- U rekomandon nxënësve tekste me/për dedikime të ndryshme dhe diskuton me ta që të ndërtojnë qëndrim personal.
- Paraqet model të lexuesit të motivuar dhe të pasionuar.
- Merr pjesë në organizimin dhe realizimin e aktiviteteve jashtëmësimore për shkrim dhe lexim (gara, klube leximi, takime me shkrimtarë, lexime letrare, seksione të dramës, klube të shkrimtarëve të rinj, etj.).
- U rekomandon nxënësve literaturë përkatëse (sipas përmbajtjes, formatit) në përputhje me nevojat dhe interesat e tyre.

II. PUNË ME ARSIMTARË

BIBLIOTEKISTI ka pozicion unik që nga njëra anë t'i njeh mirë risitë në veprimtarinë botuese relevante për punën edukativo-arsimore në shkollë, e nga ana tjetër të ketë informacione të mjaftueshme për resurset e nevojshme për realizimin e mësimin. Kjo i mundëson që në punën me arsimtarë t'u japë mbështetje në përzgjedhjen dhe idetë për shfrytëzimin e materialeve relevante nga biblioteka në realizimin e aktiviteteve mësimore dhe jashtëmësimore.

II. PUNË ME ARSIMTARË

Nën-fusha: MBËSHTETJE E ARSIMTARËVE GJATË PLANIFIKIMIT DHE REALIZIMIT TË PROCESIT EDUKATIVO-ARSIMOR DHE VETËVLERËSIMIT

BIBLIOTEKISTI...



A. KUPTIME DHE NJOHURI PROFESIONALE	B. AFTËSI DHE SHKATHTËSI PROFESIONALE
1. Njeh potencialet e burimeve të ndryshme të njohurive.	1.1 U jep mbështetje profesionale arsimtarëve për shfrytëzimin e burimeve të ndryshme të njohurive.
2. I di veçoritë e shtëpive të ndryshme botuese në veprimtarinë botuese.	2.1 Kërkon dhe ndjekë në mënyrë proaktive publikimet dhe botimet më të reja për punën edukativo-arsimore.
3. Ka njohuri për dokumentet e konceptcionit dhe njohuritë e përgjithshme të planeve dhe programeve mësimore për nivelin e arsimimit në të cilin punon.	3.1 Ndërlidhë resurset në dispozicion në bibliotekë me programet mësimore dhe jashtëmësimore.
4. Kupton veçantinë/individualitetin e nxënësve.	4.1 Respekton veçantinë/individualitetin e secilit nxënës i ndërlidhë nevojat e tij me burime përkatëse të nxënies.



SHEMBUJ TË PRAKTIKËS PROFESIONALE



- Ndhmon arsimtarët që të zgjedhin dhe shfrytëzojnë burime të ndryshme të njohurive (përmbajtje multi-mediatike, libra, etj.) përmes organizmit të punëtorive, dhënies së këshillave individuale, etj.
- Shqyrton katalogë, viziton panaire, librari.
- Bën përzgjedhjen dhe furnizimin e botimeve të reja për bibliotekën.
- Informon arsimtarët për titujt e ri që janë relevant për punën edukativo-arsimore (përpilon katalogë, bibliografi, i informon personalisht, etj.).
- Këshillon arsimtarët, organizon punëtori.
- Krijon plan për punën e seksionit për bibliotekistë në bashkëpunim me kuadrin mësitor.
- Ndhmon arsimtarët që të bëjnë përzgjedhje përkatëse të materialeve për nxënie.
- Ndhmon arsimtarët që përmes mësimdhënies t'i zhvillojnë shkathtësitë e nxënësve për shfrytëzimin e burimeve të ndryshme të informacioneve.
- Propozon sigurimin e resurseve përkatëse për të gjithë nxënësit duke përfshirë edhe nxënësit me nevoja të posaçme arsimore.
- Ndhmon ekipin që përpilon PIA-në në përzgjedhjen e materialeve për nxënie.
- U del në ndihmë kërkesave dhe nevojave specifike të nxënësve.

II. PUNË ME ARSIMTARË

Nën-fusha: MBËSHTETJE E ARSIMTARËVE GJATË PUNËS ME NXËNËS

BIBLIOTEKISTI... 

A. KUPTIME DHE NJOHURI PROFESIONALE	B. AFTËSI DHE SHKATHTËSI PROFESIONALE
1. I di mënyrat e punës me nxënës përmes shfrytëzimit të literaturës së llojlojshme.	1.1 Ndërlidhë karakteristikat dhe afinitetet e nxënësve me përzgjedhje përkatëse të literaturës.



SHEMBUJ TË PRAKTIKËS PROFESIONALE




- Propozon ose së bashku me arsimtarin i përpilon mënyrat për zhvillimin e aftësive të posaçme të nxënësve me prirje dhe për motivimin e nxënësve për të marrë pjesë në gara dhe konkurse të karaktereve të ndryshme.
- Sqaron dhe demonstroi mënyrat me të cilat mund t'u ndihmohet nxënësve në shfrytëzimin e librit dhe publikimeve tjera të shtypura në nxënien dhe mësimin e materialit mësitor.

III. PUNË ME PRINDËR

BIBLIOTEKISTI në punën me prindër nga njëra anë u ndihmon në përzgjedhjen e literaturës përkatëse për fëmijën e tyre për nxënie ose për lexim nga kënaqësia, e nga ana tjetër i përfshinë në aktivitetet e bibliotekës si për pasurimin e fondit të bibliotekës, ashtu edhe për shfrytëzimin adekuat të tij.

II. PUNË ME PRINDËR

Nën-fusha: **EDUKIM I PRINDËRVE**

BIBLIOTEKISTI... 

A. KUPTIME DHE NJOHURI PROFESIONALE	B. AFTËSI DHE SHKATHTËSI PROFESIONALE
1. I di mënyrat dhe format e komunikimit me prindër.	1.1 Di ta përshtatë komunikimin me karakteristikat e ndryshme të prindërve.
2. Kupton rëndësinë e bashkëpunimit me prindër.	2.1 Shfrytëzon mënyra të ndryshme për t'i përfshirë prindërit në aktivitete të ndryshme në bibliotekë.



SHEMBUJ TË PRAKTIKËS PROFESIONALE




- Këshillon prindërit në mënyrë individuale dhe grupore që të bëjnë përzgjedhje përkatëse të literaturës dhe materialeve për nxënie (libra, lojëra edukative, CD, etj.) për fëmijën e tyre.
- Edukon prindërit se si t'i mbështesin interesat dhe shkathtësitë për lexim të fëmijët e tyre.
- Përfshin prindërit në pasurimin e fondit të bibliotekës me libra dhe materiale edukative, duke përfshirë edhe lojërat edukative.
- U huazon prindërve libra dhe materiale tjera.
- Përfshin prindërit në realizimin e aktiviteteve të bibliotekës (lexime letrare, prezantim i librave, rregullim i bibliotekës, etj.).

IV. BASHKËPUNIM ME BASHKËSINË

BIBLIOTEKISTI zhvillon bashkëpunim të gjerë profesional me biblioteka tjera dhe me shtëpitë botuese me qëllim që të pasurohet biblioteka me material përkatës të bibliotekës dhe t'u sigurojë nxënësve dhe të punësuarve materiale që nuk i ka biblioteka, por që i kanë bibliotekat me të cilat bashkëpunon.

IV. BASHKËPUNIM ME BASHKËSINË

Nën-fusha: BASHKËPUNIM ME INSTITUCIONET DHE ORGANIZATAT PROFESIONALE

BIBLIOTEKISTI... 

A. KUPTIME DHE NJOHURI ROFESIONALE	B. AFTËSI DHE SHKATHTËSI PROFESIONALE
1. Posedon njohuri nga fusha e punës në bibliotekë dhe veprimtari të ngjashme.	1.1 Di të vendosë rrjetin e bashkëpunimit me organizata dhe institucione të jashtme me veprimtari e cila është e ndërlidhur me punën në bibliotekë, publicistikën, bibliofilinë dhe ngjashëm.
2. Njeh specifikat e llojeve të ndryshme të bibliotekave.	2.1 Di të shfrytëzojë informacione nga llojet e ndryshme të bibliotekave.



SHEMBUJ TË PRAKTIKËS PROFESIONALE

- Bashkëpunon me *Institutin për punë në bibliotekë të Fakultetit Pedagogjik* dhe institucione tjera të larta arsimore.
- Bashkëpunon me biblioteka nga bashkësia lokale dhe më gjerë.
- Bashkëpunon me organizata joqeveritare, publicistike dhe organizata dhe institucione tjera që në veprimtarinë e tyre e kanë librin si objekt kryesor të interesit.
- Siguron materiale nga bibliotekat tjera për nevojat e shkollës.

V. ZHVILLIM PROFESIONAL DHE BASHKËPUNIM PROFESIONAL

BIBLIOTEKISTI në pjesën për bashkëpunim profesional ka rol veçanërisht të rëndësishëm në krijimin e përmbledhjes së materialeve mësimore (në version të shtypur në letër ose version elektrik) që i kanë përpiluar arsimtarët, e që mund ta përdorin arsimtarët tjerë. Atë e krijojnë së bashku me arsimtarët, materiali ruhet në bibliotekë, ndërsa ai promovon dhe siguron përdorimin e tij. Po ashtu, është kyç roli i tij në edukimin e arsimtarëve për respektimin e të drejtave autoriale (shfrytëzim dhe citim i burimeve të ndryshme).

V. ZHVILLIM PROFESIONAL DHE BASHKËPUNIM PROFESIONAL

Nën-fusha: ZHVILLIM PERSONAL PROFESIONAL

BIBLIOTEKISTI...



A. KUPTIME DHE NJOHURI PROFESIONALE	B. AFTËSI DHE SHKATHTËSI PROFESIONALE
1. Kupton ndërlíkueshmërinë e profesionit bashkëpunëtor profesional – bibliotekist dhe nevojën e nxënies së përgjeshme.	1.1 Shfrytëzon njohuritë e fituara përmes zhvillimit profesional (arsimi dhe nxënia formale, joformale dhe informale) për avancim të praktikës personale.
2. Kupton rëndësinë e zhvillimit personal profesional.	2.1 Identifikon nevojat për zhvillim personal profesional duke i shfrytëzuar standardet dhe rezultatet nga vetë reflektimi i punës personale.
3. Njeh kompetencat dhe standardet për profilin e vet të bashkëpunëtorit profesional.	
4. Kupton rëndësinë e planifikimit të zhvillimit personal profesional.	
5. I di mënyrat dhe mundësitë efektive për zhvillim personal dhe profesional.	5.1 Analizon dhe përcakton nevoja për përmirësimin e praktikës personale.
6. Është i informuar për shoqatat profesionale të bibliotekistëve.	6.1 Bashkëpunon me bashkëpunëtorët profesional dhe me shoqatat profesionale në dhe jashtë shkollës.
7. Njeh kodeksin etik të profesionit.	



SHEMBUJ TË PRAKTIKËS PROFESIONALE



- Përmirëson vazhdimisht udhëheqjen dhe organizmin e bibliotekës.
- Ndjekë literaturë profesionale dhe informacione me rëndësi për arsimin dhe edukimin.
- Përfshinë mënyra të reja të punës me arsimtarë dhe nxënës.
- Planifikon, mban evidencë dhe posedon dëshmi (plan personal, certifikata, vizita dhe trajnime të realizuara, shënime nga vetë reflektimi dhe ngjashëm) për zhvillimin personal profesional.
- Merr pjesë në forma të ndryshme grupore (trajnime, konferenca, seminare, etj.) dhe individuale (kërkim të literaturës, lexon publikime profesionale, kërkon në internet resurse të ndryshme, etj.) të zhvillimit profesional në dhe jashtë shkollës.
- Merr pjesë në aktivitete të ndryshme të shoqatave profesionale, rrjete sociale dhe forume me qëllim që ta përmirësojë punën e vet.
- Sillet në përputhje me kodeksin etik të profesionit.

V. ZHVILLIM PROFESIONAL DHE BASHKËPUNIM PROFESIONAL

Nën-fusha: MBËSHTETJE E ZHVILLIMIT DHE BASHKËPUNIMIT PROFESIONAL NË SHKOLLË

BIBLIOTEKISTI...



A. KUPTIME DHE NJOHURI PROFESIONALE	B. AFTËSI DHE SHKATHTËSI PROFESIONALE
1. Kupton rëndësinë e bashkëpunimit profesional në shkollë.	1.1 Vendorsë marrëdhënie profesionale në punë.
2. Kupton potencialet e materialeve për nxënie të përpiluara nga arsimtarët.	2.1 Promovon shkëmbim të resurseve për nxënie të përpiluara nga arsimtarët.
3. Njeh mënyra për tërheqjen dhe shfrytëzimin e informacioneve prej burimeve të ndryshme të shkruara dhe digjitale.	3.1 I jep mbështetje profesionale kuadrit mësimor lidhur me bibliotekën dhe shfrytëzimin e informacioneve.



SHEMBUJ TË PRAKTIKËS PROFESIONALE



- Bashkëpunon me drejtorin, bashkëpunëtorët profesional, arsimtarët dhe të punësuarit tjerë.
- Bashkëpunon me nxënës, arsimtarë, administratë shkollore dhe prindër gjatë përpilimit dhe realizimit të programit për punën e bibliotekës.
- Bashkë me arsimtarët i përzgjedhë dhe rendit resurset e përpiluara mësimore, i ruan në bibliotekë dhe ua ofron për shfrytëzim të tjerëve në shkollë.
- Mban trajnime/punëtori për kolegët se si në mësimin e tyre t'i mësojnë nxënësit që të gjejnë dhe shfrytëzojnë lloje të ndryshme të informacioneve.

VII. STRUKTURË, ORGANIZIM DHE KLIMË SHKOLLORE

BIBLIOTEKISTI ka rolin kyç në zhvillimin e bibliotekës si qendër për nxënie të të gjithëve dhe shkëmbim të informacioneve profesionale. Për këtë qëllim ai e organizon bibliotekën që të jetë lehtë e arritshme për shfrytëzim si nga aspekti fizik, ashtu edhe nga aspekti i nevojave të shfrytëzuesve të ndryshëm. Bibliotekisti organizon aktivitete për pasurimin e fondit të bibliotekës, por organizon edhe aktivitete të ndryshme për shfrytëzimin e tij.

VII. STRUKTURË, ORGANIZIM DHE KLIMË SHKOLLORE

Nën-fusha: STRUKTURË, ORGANIZIM DHE KLIMË SHKOLLORE,
MJEDIS I SIGURT DHE PJESËMARRJE DEMOKRATIKE

BIBLIOTEKISTI...



A. KUPTIME DHE NJOHURI PROFESIONALE	B. AFTËSI DHE SHKATHTËSI PROFESIONALE
1. Kupton rëndësinë e bibliotekës si qendër për nxënie dhe shfrytëzim të burimeve të ndryshme të informacioneve.	1.1 Organizon bibliotekën që të paraqesë qendër për nxënie dhe shkëmbim të informacioneve në shkollë.
2. Njeh lloje të ndryshme të materialeve dhe mjeteve për nxënie dhe për realizimin e planeve dhe programeve mësimore në shkollë.	2.1 Vlerëson burime për nxënie me formate të ndryshme dhe prej medieve të ndryshme. 2.2 Di t'i lidhë politikatat zhvillimore të shkollës me resurset që nevojiten për implementimin e tyre.
3. Kupton faktorët social dhe psikologjik që ndikojnë në shfrytëzimin e resurseve nga personeli profesional dhe nxënësve.	3.1 Shfrytëzon mënyra të ndryshme për ngritjen e interesit të nxënësve, të punësuarve dhe prindërve për shfrytëzimin e bibliotekës.
4. Njeh dhe kupton produktet multi-mediatike, rrjetet lokale dhe të tjera dhe shërbimet on-lajn të bibliotekës.	4.1 Udhëzon nxënësit dhe të punësuarit të përdorin produkte multi-mediatike dhe shërbime on-lajn të bibliotekave.
5. Kupton se gjatë planifikimit të punës në shkollë duhet të merren parasysh specifikat e mjedisit në të cilin gjendet shkolla.	5.1 Organizon ngjarje të ndërlidhura me punën e bibliotekës që e reflektojnë planin dhe programin e shkollës dhe specifikat e bashkësisë.
6. Njeh mënyra të ndryshme të shkrimit dhe prezantimit të përmbajtjeve.	6.1 Di të vlerësojë dhe përzgjedhë mënyrën më përkatëse të prezantimit të informacioneve.
7. Njeh mundësitë për përdorimin e teknologjisë së ndryshme informative-komunikuese, duke përfshirë edhe teknologjitë e reja.	7.1 Di të përdorë TIK për krijim, ruajtje, gjetje, shkëmbim dhe organizim të informacioneve dhe për komunikim.



8. Di për dallimet mes njerëzve dhe mes bashkësive (kulturë, pamje fizike, etj.).	8.1 Promovon ndjeshmërinë për dhe pranimin e dallimeve.
9. I di dhe i kupton rregullat e udhëheqjes dhe organizmit të bibliotekës së shkollës.	9.1 Organizon bibliotekën për të qenë më lehtë e arritshme për shfrytëzuesit. 9.2 Siguron qasje deri tek materiali i bibliotekës përmes rrugës elektronike. 9.3 Udhëzon nxënësit që të shfrytëzojnë bibliotekën.
10. Njeh proceset e bibliotekës, furnizim të librave, periodikë, revista, gazeta, etj.	10.1 Avancojnë punën e bibliotekës në bazë të njohurive nga efektet e punës paraprake (përdorim i bibliotekës, kënaqësi dhe efekte nga përdorimi). 10.2 Bën përpunim profesional – katalogim, klasifikim dhe renditje të fondit të librave.
11. Njeh softuerë për punë në bibliotekë dhe përparësitë e tyre.	11.1 Shfrytëzon sistemin kompjuterik (COBISS etj.).
12. E di rregulloren për siguri të bibliotekës dhe kupton rëndësinë e vendosjes së sistemit të sigurisë.	12.1 Përshtatë sistemin e sigurisë në përputhje me kushtet në shkollë. 12.2 Siguron respektim të kodeksit të sjelljes në bibliotekë.
13. Njeh rregulloren për të drejtat autoriale dhe rregullat e citimit.	13.1 Promovon respektim të të drejtave autoriale dhe citim të drejtë.



SHEMBUJ TË PRAKTIKËS PROFESIONALE



- Udhëzon nxënësit dhe të punësuarit drejt resurseve në bibliotekë.
- Përpunon materiale për promovimin e punës së bibliotekës në formë të ndryshme.
- Organizon aktivitete për nxenie për të cilat nevojitet shfrytëzim i resurseve të ndryshme.
- Prezanton produkte nga aktiviteti i nxënësve në bibliotekë.
- Përzgjedhë burime përkatëse (libra, revista, resurse elektronike për programe specifike).
- Vlerëson materialet me arsimtarët.
- Përzgjedhë materiale cilësore për realizimin e përmbajtjeve përkatëse në mësim dhe për aktivitete jashtëmësimore dhe ua propozon arsimtarëve për shfrytëzim.
- Organizon aktivitete promotive për punën e bibliotekës (materiale promotive, informacione në faqen e internetit, prezantime gjatë mbledhjeve prindërore, prezantime të evenimenteve shkollë, etj.).
- Përdorë produktet multi-mediatike dhe shërbimet on-lajn të bibliotekës.
- Përgatitë drejtime dhe materiale tjera për lloje të ndryshme të shfrytëzuesve të produkteve multi-mediatike dhe shërbimeve on-line të bibliotekave.
- Merr pjesë në përpilimin e programeve zhvillimore dhe vjetore të shkollës.
- Përfshihet në aktivitete në nivel të shkollës (p.sh. kremtime, manifestime).



- Merr pjesë në përpilimin dhe botimin e materialeve promotive për shkollën.
- Ndhmon arsimtarët dhe nxënësit në përzgjedhjen e mënyrës së prezantimit të përmbajtjeve të ndryshme (mësimore, jashtëmësimore, të projektit, promotive).
- Merr pjesë në rregullimin e faqes së internetit të shkollës.
- Shfrytëzon TIK-un në punën e përditshme dhe u jep udhëzime të tjerëve se si ta shfrytëzojnë atë.
- Nxënësve u ofron paletë të mundësive për shfrytëzimin e mediave të ndryshme.
- Rregullon hapësirën e bibliotekës ashtu që i prezanton diversitetet.
- Ndhmon nxënësit që të gjejnë informacione për t'iu përgjigjur pyetjeve të tyre lidhur me kulturat, racat, religjionet, bashkësitë e ndryshme, etj.
- Organizon hapësirën e bibliotekës për të qenë lehtë e arritshme për shfrytëzuesit në aspektin fizik.
- Krijon një kënd informativ për risitë e bibliotekës (ku ekspozohen librat, revistat dhe botimet tjera të sapo furnizuara).
- Siguron materiale informative (të shkruara, grafike, elektronike, etj.) për mënyrën e shfrytëzimit të bibliotekës.
- Organizon materialet sipas moshës, interesave dhe nevojave të shfrytëzuesve (p.sh. sipas fushës, zhanrit, etj.).
- Botimin e librave dhe materialeve e harmonizon me organizmin e punës së nxënësve dhe arsimtarëve në shkollë.
- Njofton nxënësit me organizmin e bibliotekës.
- Mëson nxënësit se si të përdorin katalogë dhe fonde.
- Aftëson nxënësit se si dhe ku t'i gjejnë informacionet që u nevojiten.
- Përpilon plan dhe program vjetor për punën e bibliotekës në përputhje me programin për punën e shkollës.
- Kontrollon fondin e librave për dëmtime të mundshme dhe jep propozim për shlyerjen e tyre dhe zëvendësim të mundshëm me të rinj.
- Shtyp, mban libër inventari dhe e shënon fondin e bibliotekës.
- Udhëzon nxënësit dhe arsimtarët që ta përdorin softuerin elektronik në bibliotekë.
- Shënon materialin e bibliotekës me bar-kod dhe ka pasqyrë të materialit të bibliotekës.
- Punon në përputhje me rregullat për siguri në shkollë.
- Informon dhe insiston në respektimin e rregullave për sjellje në bibliotekë.
- Shërben si shembull për respektimin e rregullave të sigurisë.
- Udhëzon arsimtarët dhe nxënësit për mënyrat e shfrytëzimit e të drejtave autoriale.



**STANDARDE
PROFESIONALE
për BASHKËPUNËTOR
PROFESIONAL - MENTOR**

KOMPETENCA TË PËRBASHKËTA PËR BASHKËPUNËTOR PROFESIONAL – MENTOR

PIKËNISJE THEMELORE


Një numër i caktuar i bashkëpunëtorëve profesional përmes punës, iniciativës dhe angazhimit të tyre në shkollë veçanërisht dallohen dhe paraqesin shembull të praktikës së mirë për kolegët tjerë. Prioriteti i tyre nuk është vetëm përfundimi i obligimeve të punës, por përfundimi i tyre cilësor. Standardet profesionale për bashkëpunëtorë profesional–mentor janë përpiluar që të jenë dokument bazë në drejtim të lehtësimit të procesit për avancim në profesion.

Në këtë pjesë janë zhvendosur kompetencat që bashkëpunëtori profesional duhet t'i posedojë për të marrë pozitën bashkëpunëtor profesional–mentor. Ato paraqesin sendërtim të kompetencave themelore profesionale dhe paraqesin një lloj kriteri që pritet ta plotësojnë vetëm një pjesë e bashkëpunëtorëve profesionalë, ata që paraqesin shembull për praktikë të mirë, dhe si rezultat të avancohen në profesion.

Gjatë përkufizimit të standardeve është nisur nga konceptimi se bashkëpunëtori profesional–mentor gjatë punës i ka zhvilluar dhe përsosur kompetencat themelore profesionale për bashkëpunëtor profesional dhe aktivitetet edhe obligimet i kryen në mënyrë më cilësore dhe në nivel më të lartë. Për shkak të përvojës së tij, dëshmimit në punë dhe besimit të fituar, bashkëpunëtori profesional–mentor ka mundësi veçanërisht t'i mbështesë arsimtarët në punën e tyre, por edhe të ofrojë kontribut të konsiderueshëm në të gjitha fushat

e punës së shkollës në tërësi. Ai ka vizion se në cilin drejtim lëvizë shkolla, zhvillon strategji, ndërsa më i angazhuar është edhe në nivel lokal. Për shkak të kësaj, puna e tij është e dalluar në shkollë dhe në bashkësinë lokale. Ai është praktikant reflektues që e shqyrton praktikën e vet dhe tregon interesim për risitë në profesion dhe arsim, si dhe është i përkushtuar vazhdimisht në zhvillimin profesional.

Te standardet më shumë vëmendje u kushtohet standardeve të përbashkëta, sesa standardeve për profilet e posaçme profesionale, për shkak se vlerësohej se angazhimi në nivel lokal dhe nacional kërkon kompetenca që janë të ngjashme të secili profil i bashkëpunëtorit profesional dhe sendërtohet në kompetencat profesionale karakteristike për profilet konkrete profesionale.



1. PUNË ME NXËNËS

BASHKËPUNËTORI PROFESIONAL-MENTOR posedon njohuri më të thella për zhvillimin e fëmijëve dhe të rinjve dhe shkathtësi më të zhvilluara për punë me nxënës sesa një bashkëpunëtor profesional. Ai punon në çështje më të ndjeshme me të cilat përballen individë ose grupe të nxënësve, me ç' rast vepron duke përdorur qasje më të reja të mbështetura në njohuri të reja shkencore dhe vepron në mënyrë më të thelluar. Gjatë marrjes së vendimeve mund t'i referohet përvojës dhe intuitës së vet, por kryesisht vendimet i mbështet në dëshmi për vlefshmërinë dhe efektivitetin e intervenimeve të ndërmarra. Ai u kushton vëmendje më të madhe qasjeve strategjike dhe aktiviteteve parandaluese dhe ndërmerr nisma për përmirësimin e shkollës me qëllim që të jetë vend më i mirë për nxënie dhe zhvillim të nxënësve. Për këtë qëllim i rishqyrton vazhdimisht praktikat ekzistuese dhe sipas nevojës i ndryshon ato. Puna e tij e ka promovuar atë si ekspert që u ndihmon nxënësve jo vetëm të përballen me vështirësitë në të cilat hasin, por edhe t'i forcojnë veçoritë, aftësitë dhe shkathtësitë që do t'u jenë të rëndësishme në jetë. Kujdeset për mirëqenien e nxënësve dhe i përfaqëson interesat e tyre ashtu që direkt ose indirekt siguron kushte optimale për nxënie dhe zhvillim.

I përmirëson vazhdimisht praktikat e tij dhe mëson dhe gjen vazhdimisht zgjidhje kreative për problemet me të cilat përballen në punë.

Nga **psikologu-mentor** pritet veçanërisht të jetë kompetent për të zhvilluar sistemin për identifikim, ndjekje dhe mbështetje të punës me nxënësit e talentuar, ndërsa nga **defektologu-mentor** të dijë të zhvilloj sistem të tillë të punës me nxënës me nevoja të posaçme arsimore, me çka do të kontribuohet për gjendjen e përgjithshme që të gjithë nxënësit të kenë kushte për zhvillim maksimal.

I. PUNË ME NXËNËS

Nën-fusha: MBËSHTETJE E NXËNËSVE GJATË NXËNIES

BASHKËPUNËTORI PROFESIONAL...



KOMPETENCA TË BASHKËPUNËTORIT PROFESIONAL-MENTOR

1. Siguron që të gjithë nxënësit të kenë mundësi të barabarta për sukses duke shfrytëzuar qasje për përmirësimin e nxënies të mbështetura në njohuritë më të reja shkencore.
2. Zhvillon qasje për ndërtimin e shkollës inkluzive (përfshirëse).



SHEMBUJ TË PRAKTIKËS PROFESIONALE



- Adapton dhe/ose krijon instrumente dhe metoda për ndjekjen e përparimit të nxënësve gjatë nxënies.
- Krijon dhe realizon punëtori, me nxënësit në të cilat demonstroi metoda dhe teknika të reja dhe efektive të nxënies.
- Vlerëson efektivitetin e programeve dhe praktikave dhe udhëheqë procesin e përmirësimit të të arriturave të nxënësve.
- Realizon notim diagnostik (të arritura arsimore, procese kognitive, mënyrë dhe stil i nxënies, etj.) me qëllim të mbështetjes së drejtpërdrejtë të nxënësve.
- Punon në projekte dhe hulumtime me dhe për nxënës me nevoja të posaçme arsimore, integrim ndëretnik dhe/ose inkluzion (përfshirje) socio-ekonomike në kuadër të shkollës.
- Udhëheqë ekipin për arsim inkluziv (përfshirës).
- Vlerëson vlefshmërinë, përshtatshmërinë dhe efektivitetin e intervenimeve të ndërmarra.
- Inicion nisma dhe ndërmerr aktivitete për dallimin dhe respektimin e diversiteteve në nivel të shkollës dhe në bashkësinë më të gjerë.

I. PUNË ME NXËNËS

Nën-fusha: VËZHGIM DHE MBËSHTETJE TË ZHVILLIMIT TË NXËNËSVE

BASHKËPUNËTORI PROFESIONAL...



KOMPETENCA TË BASHKËPUNËTORIT PROFESIONAL-MENTOR

1. Zhvillon strategji për mbështetjen e zhvillimit të nxënësve, të përshtatur me specifikat e vetë nxënësve dhe shkollës.





SHEMBUJ TË PRAKTIKËS PROFESIONALE



- Shfrytëzon analizë të situatës për t'i vlerësuar nevojat dhe për të përpiluar aktivitete përkatëse.
- Shfrytëzon metoda dhe teknika të reja për vlerësim dhe punë këshillëdhënëse me nxënësit.
- Udhëheqë ekipe për mbështetjen dhe ndjekjen e zhvillimit të nxënësve.
- Planifikon dhe koordinon qasje strategjike për ndjekje dhe mbështetje të zhvillimit të nxënësve të përshtatura me specifikat e shkollës.
- Merr pjesë në ndjekjen e përshtatshmërisë së qasjeve dhe ndryshimeve që ndodhin si rezultat i atyre qasjeve.
- Përpilon qasje në nivel të shkollës për zhvillimin e shkathtësive jetësore të nxënësit (p.sh. udhëheqje, humanizëm, oratori, sipërmarrësi, etj.).
- Trajnon nxënës për edukim dhe ndërmjetësim moshatar.

I. PUNË ME NXËNËS

**Nën-fusha: ORIENTIM PROFESIONAL
DHE NË KARRIERË I NXËNËSVE**

BASHKËPUNËTORI PROFESIONAL...



KOMPETENCA TË BASHKËPUNËTORIT PROFESIONAL-MENTOR


1. Avancojnë procesin e orientimit profesional dhe zhvillimit në karrierë në shkollë.



SHEMBUJ TË PRAKTIKËS PROFESIONALE



- Planifikon dhe krijon metoda dhe qasje për orientim profesional dhe zhvillim në karrierë për nxënësit në të gjitha fazat e arsimit të tyre.
- U jep drejtime arsimtarëve se si të realizohen aktivitetet në mësimin e rregullt dhe aktivitetet jashtëmësimore.



II . PUNË ME ARSIMTARË

BASHKËPUNËTORI PROFESIONAL-MENTOR është iniciator dhe përkrahës i qasjeve të reja në mësimdhënie, me ç' rast udhëheqë ekipet për përfshirjen e inovacioneve. Motivon arsimtarët që ta modernizojnë punën e tyre dhe i mbështetë në shfrytëzimin e metodave të reja mësimore efektiviteti i të cilave është i mbështetur dhe i vërtetuar në aspektin shkencor. Informon dhe ndihmon arsimtarët që t'i kuptojnë njohuritë më të reja për punën edukativo-arsimore, praktikat efektive dhe i inkurajon që edhe vetë të gjejnë zgjidhje kreative në sfidat e punës me nxënësit dhe t'u dalin në ndihmë nevojave të të gjithë nxënësve. Përmes punës së tij, në kolektiv paraqitet si mbështetës dhe lehtësues i punës së arsimtarëve dhe ata ndjehen të lirshëm që të kërkojnë mbështetje prej tij. Ai u ndihmon të bëhen praktikantë reflektues, autonom, por edhe të dinë ta paraqesin praktikën e tyre të suksesshme para tjerëve. Me këtë rast, çdo profil i bashkëpunëtorit profesional siguron që të merren parasysh njohuritë nga sfera e specialitetit të tyre më të ngushtë.

II. PUNË ME ARSIMITARË

Nën-fusha: MBËSHTETJE E ARSIMITARËVE GJATË PLANIFIKIMIT DHE REALIZIMIT TË PROCESIT EDUKATIVO-ARSIMOR DHE VETËVLERËSIMIT

BASHKËPUNËTORI PROFESIONAL...



KOMPETENCA TË BASHKËPUNËTORIT PROFESIONAL-MENTOR

1. Promovon qasje dhe modele inovative në planifikimin e mësimit dhe forma tjera të punës edukativo-arsimore.
2. Krijon/zbaton projekte inovative didaktike-metodike në nivel të shkollës.



SHEMBUJ TË PRAKTIKËS PROFESIONALE

- Ndhmon arsimtarët gjatë konceptimit didaktiko-metodik të mësimit.
- Ndhmon arsimtarët në planifikimin dhe realizimin e orëve të vëzhguara të mësimit.
- Merr pjesë në planifikimin dhe programimin e ekipit të punës edukativo-arsimore nga aspekti i profesionalizimit të vet (aspekte metodike, karakteristika individuale të nxënësve, mjedis social, qasje të reja, etj.).
- Udhëzon se si të shfrytëzohen shkathtësi refleksive për analizimin dhe përmirësimin e praktikës.
- Udhëheqë ekip profesional që realizon projekt inovativ në shkollë.
- Është anëtar i ekipeve për certifikimin e zbatimit të qasjeve të reja në mësimdhënie.
- Posedon certifikata për zbatimin e njohurive/shkathtësive të marra nga projektet.



II. PUNË ME ARSIMITARË

Nën-fusha: MBËSHTETJE E ARSIMITARËVE GJATË PUNËS ME NXËNËS

BASHKËPUNËTORI PROFESIONAL...



KOMPETENCA TË BASHKËPUNËTORIT PROFESIONAL-MENTOR

1. Kontribuon për krijimin e mjedisit pozitiv për nxënësit në shkollë.
2. Krijon klimë të pranimit të diversiteteve dhe situatave të krizës të nxënësit.
3. Përfshin njohuritë për karakteristikat, përparimin dhe zhvillimin e nxënësve.





SHEMBUJ TË PRAKTIKËS PROFESIONALE

- Ndhmon kujdestarët e klasës në planifikimin dhe përzgjedhjen e aktiviteteve edukative dhe parandaluese me nxënësit.
- Ndhmon arsimtarët dhe kujdestarët e klasës gjatë zgjidhjes konstruktive të konflikteve në paralele.
- Përpilon aktivitete për arsimtarët gjatë punës me nxënës.
- Këshillon arsimtarët se si t'u përgjigjen situatave të krizës të nxënësit.
- Njofton arsimtarët me paranojoritë dhe karakteristikat tjera relevante të nxënësve të rinj (gjatë kalimit në mësimin lëndor dhe arsimin e mesëm) dhe u ofron udhëzime për punë.
- Vëzhgon përshtatjen e kërkesave programore me karakteristikat e moshës së nxënësve dhe ofron rekomandime për harmonizimin e të njëjtave.
- Udhëzon arsimtarët e rinj për mënyrën e mësimdhënies së kategorive të caktuara të nxënësve.





III. PUNË ME PRINDËR⁹

BASHKËPUNËTORI PROFESIONAL-MENTOR është më i shkathët në aftësitë komunikuese sesa bashkëpunëtori profesional. Përvoja në punën me prindër të nxënësve, si dhe vëzhgimi i vazhdueshëm i qasjeve më të reja në punën me ta e sensibilizon deri në atë masë sa që bashkëpunëtori profesional-mentor i dallon situatat potenciale të palakmueshme dhe reagon në mënyrë përkatëse ndaj tyre, ndërsa puna e suksesshme e bën të dallohet te prindërit dhe bashkësia lokale. Sikurse në nën-fushat tjera edhe këtu është inovativ dhe krijon ide dhe qasje të reja për bashkëpunim, këshillim dhe edukim të mundshëm të prindërve në drejtim të realizimit të suksesshëm të rolit të tyre prindëror.

⁹ Me prind nënkuptohet edhe përfaqësuesi ligjor, kujdestar.

III. PUNË ME PRINDËR

Nën-fusha: KËSHILLIME DHE KONSULTIME INDIVIDUALE
DHE GRUPORE ME PRINDËR

BASHKËPUNËTORI PROFESIONAL...



KOMPETENCA TË BASHKËPUNËTORIT PROFESIONAL-MENTOR

1. Dallon situata konflikti në raportin prind-shkollë dhe reagon ndaj tyre në mënyrë përkatëse.
2. Përmirëson informimin e prindërve.
3. Parashikon rezistencat e mundshme të prindërit dhe punon në tejkalimin e tyre.



SHEMBUJ TË PRAKTIKËS PROFESIONALE



- Ndërmjetëson në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve/konflikteve të mundshme në raportin prind-kuadër edukativo-arsimor ose prind-nxënës.
- Shfrytëzon metoda dhe qasje të bazuara shkencore të punës këshillëdhënëse me prindër/familje.
- Merr pjesë në aktivitetet në nivel lokal për informimin e prindërve për çështje të ndryshme nga fusha e arsimit.
- Përshtatë komunikimin varësisht nga situata dhe përvojat e mëparshme.

III. PUNË ME PRINDËR

Nën-fusha: EDUKIM I PRINDËRVE

BASHKËPUNËTORI PROFESIONAL...



KOMPETENCA TË BASHKËPUNËTORIT PROFESIONAL-MENTOR

1. Vëzhgon tendencat bashkëkohore e të qenët prind.



SHEMBUJ TË PRAKTIKËS PROFESIONALE



- Krijon punëtori edukative për prindër.
- Paraqet/demonstron tendencat bashkëkohore e të qenit prind përmes trajnimeve, takimeve, publikimeve dhe ngjashëm.

III. PUNË ME PRINDËR

Nën-fusha: PËRFSHIRJE E PRINDËRVE NË JETËN
DHE PUNËN E SHKOLLËS

BASHKËPUNËTORI PROFESIONAL...



KOMPETENCA TË BASHKËPUNËTORIT PROFESIONAL-MENTOR


1. Përmirëson bashkëpunimin e shkollës me familjen.



SHEMBUJ TË PRAKTIKËS PROFESIONALE



- Informon kolegët për qasjet e shkollës për zbatimin e risive në sistemin arsimor dhe mënyrat e informimit të prindërve për to.
- Inicion dhe organizon projekte për përfshirjen e prindërve në jetën dhe punën e shkollës.





IV. BASHKËPUNIM ME BASHKËSINË

BASHKËPUNËTORI PROFESIONAL-MENTOR ndërmerr nismë në bashkëpunim me bashkësinë lokale për çështje që janë relevante jo vetëm për shkollën, por edhe për bashkësinë. Ai u qaset çështjeve të bashkëpunimit me bashkësinë në mënyrë sistematike dhe nismat e tij hasin në mirëkuptim dhe pranim për shkak të bashkëpunimit të suksesshëm të deritatëhershëm. Angazhohet në mënyrë aktive në realizimin e politikave dhe praktikave të caktuara shkollore dhe të njëjtat i promovon në bashkësinë më të gjerë. Me gjithë këtë, së bashku me aktivitetet për shpërndarjen e njohurive dhe përvojave të veta përmes mediave të ndryshme, bashkëpunëtori profesional-mentor ka përvetësuar reputacionin e ekspertit në fushën e tij, mendimi i të cilit respektohet nga njerëzit.

IV. BASHKËPUNIM ME BASHKËSINË

Nën-fusha: BASHKËPUNIM ME BASHKËSINË LOKALE

BASHKËPUNËTORI PROFESIONAL...



KOMPETENCA TË BASHKËPUNËTORIT PROFESIONAL-MENTOR

1. Inicion dhe zhvillon bashkëpunim partneriteti me bashkësinë për çështje relevante për arsimin në bashkësinë.



SHEMBUJ TË PRAKTIKËS PROFESIONALE



- Përpilon procedura për mënyrën e planifikimit, organizmit dhe realizimit të aktiviteteve dhe për vëzhgimin dhe vlerësimin e tyre (ligjërata, tribuna, parakalime, ekspozita, akademi, gara, etj.).
- Ka rol udhëheqës në projektet për bashkëpunim me bashkësinë lokale (iniciator, udhëheqës, koordinator).
- Njohuritë dhe përvojat e tij profesionale i prezanton para opinionit më të gjerë.
- Informon bashkësinë lokale për çështje të caktuara aktuale nga arsimi dhe ofron mbështetje për çështje nga fusha e tij.



V. ZHVILLIM PROFESIONAL DHE BASHKËPUNIM PROFESIONAL

BASHKËPUNËTORI PROFESIONAL-MENTOR e ka tejkaluar fazën e punës rutine dhe është i interesuar për përmirësimin e punës personale përmes përvetësimit të njohurive për praktikën më të reja në profesionin, por edhe përmes analizës së punës personale. Ai identifikon temat/nën-fushat e punës në të cilat duhet të zhvillohet në aspektin profesional, ndaj për këtë qëllim edhe hyn më thellë në disa nën-fusha të caktuara. Prandaj, ai e planifikon në mënyrë sistematike zhvillimin personal profesional dhe përzgjedhë përmbajtje, forma dhe metoda më adekuate. Meqë personalisht e ka vërtetuar rëndësinë e zhvillimit profesional për punë të suksesshme, bashkëpunëtori profesional-mentor angazhohet që të gjithë të punësuarit në shkollë të zhvillohen duke ndërtuar një sistem për zhvillim profesional në shkollë, në kuadër të të cilit koordinon, trajnon, vëzhgon dhe udhëzon forma të ndryshme të zhvillimit profesional.

V. ZHVILLIM PROFESIONAL DHE BASHKËPUNIM PROFESIONAL

Nën-fusha: ZHVILLIM PERSONAL PROFESIONAL

BASHKËPUNËTORI PROFESIONAL...



KOMPETENCA TË BASHKËPUNËTORIT PROFESIONAL-MENTOR

1. Vlerëson aktivitetet personale profesionale nga aspekti i efekteve dhe i përmirëson ato.



SHEMBUJ TË PRAKTIKËS PROFESIONALE

- Përpilon instrumente për reflektim dhe vetëvlerësim, si dhe shkëmben përvojat nga zhvillimi personal profesional dhe praktika profesionale.
- Ndjekë literaturën profesionale për shqyrtim më të thellë të çështjeve specifike dhe të reja nga kjo fushë dhe e shfrytëzon atë gjatë punës.
- Ndjekë trajnime për arritjen e kompetencave më të larta (shkathtësi më specifike nga fusha, trajnime për mentorë, për udhëheqje, hulumtim).



V. ZHVILLIM PROFESIONAL DHE BASHKËPUNIM PROFESIONAL

Nën-fusha: MBËSHTETJE E ZHVILLIMIT
DHE BASHKËPUNIMIT PROFESIONAL NË SHKOLLË

BASHKËPUNËTORI PROFESIONAL...



KOMPETENCA TË BASHKËPUNËTORIT PROFESIONAL-MENTOR

1. Kontribuon që arsimtarët dhe bashkëpunëtorët profesional t'i përvetësojnë kompetencat themelore.
2. Vendorsë sistem të zhvillimit profesional të kuadrit edukativo-arsimor në shkollë.







SHEMBUJ TË PRAKTIKËS PROFESIONALE

- Organizon, informon dhe bën shpërndarjen e njohurive dhe shkathtësive të përvetësuara nga trajnimi ose seminari i ndjekur.
- Mentoron arsimtarë, bashkëpunëtorë profesional dhe studentë.
- Planifikon, krijon, organizon dhe realizon trajnime interne.
- Mban evidencë dhe posedon dëshmi për zhvillimin profesional të arsimtarëve në shkollë.
- Merr pjesë në procesin e certifikimit të arsimtarëve për të punuar në programe/projekte të caktuara.
- Udhëheqë ekipet në shkollë që punojnë në përparimin e punës edukativo-arsimore.
- Inicion dhe udhëheqë bashkësi për nxënie nga fusha e tij në shkollë dhe në rajon.
- Përpilon program për zhvillimin profesional të kuadrit edukativo-arsimor të shkollës.
- Udhëheqë ekipin shkollor për zhvillim profesional.
- Organizon mbështetje të arsimtarëve për realizimin e aktiviteteve që kanë të bëjnë me zhvillimin profesional.
- Shkëmben njohuri, kuptime dhe shkathtësi për mbështetjen e zhvillimit profesional.
- Vëzhgon efektet e zhvillimit profesional të shkollës.
- Përpilon modele për planifikimin dhe vëzhgimin e formave të ndryshme të zhvillimit profesional në nivel të shkollës.





VI. PUNË ANALITIKE-HULUMTUESE

BASHKËPUNËTORI PROFESIONAL-MENTOR e ka ngritur punën analitike-hulumtuese në nivel më të lartë se mbledhja dhe analizimi rutinë i të dhënave nga dokumentacioni pedagogjik që udhëhiqet në shkollë dhe zbatimi i hulumtimeve të vogla për përmirësimin e punës edukativo-arsimore. Ai sillet si hulumtues – mbledhë dëshmi për atë se çfarë funksionon në shkollë e çfarë jo, si dhe në çfarë kushtesh. Punon në mënyrë ekipore dhe udhëheqë ekipe për hulumtimin e çështjeve aktuale nga punë edukativo-arsimore në shkollë, ndërsa konstatimet dhe propozimet për përparimin e veprimtarisë edukativo-arsimore i sjellë në bazë të dëshmive. Në hulumtimet e praktikës pedagogjike parashtron pyetje që janë me interes të gjerë profesional, kërkojnë dizajn më të ndërlikuar metodologjik dhe përpunim më të ndërlikuar statistikor dhe të dhënat i prezanton para opinionit më të gjerë profesional. Ai di t'i vlerësojë në mënyrë kritike hulumtimet e realizuara nga personat tjerë dhe konstatimet deri te të cilat kanë ardhur ata.

Nëse hulumtimet i realizon në mënyrë të pavarur, atëherë ato zakonisht janë hulumtime të thelluara të çështjeve specifike nga fusha e tij më e ngushtë, ndërsa kur punon në mënyrë ekipore, që duhet të jetë rast më i shpeshtë, atëherë secili bashkëpunëtor profesional siguron që në mënyrë përkatëse të shqyrtohet aspekti për të cilin ai është kompetent (aspekti pedagogjik, psikologjik, sociologjik dhe ai i defektologjisë), që siguron shqyrtim gjithëpërfshirës të problemit.

VI. PUNË ANALITIKE-HULUMTUESE

Nën-fusha: HULUMTIM I PUNËS EDUKATIVO-ARSIMORE

BASHKËPUNËTORI PROFESIONAL...



KOMPETENCA TË BASHKËPUNËTORIT PROFESIONAL-MENTOR

1. Identifikon çështje relevante dhe realizon hulumtime për përmirësimin e cilësisë së procesit edukativo-arsimor.



SHEMBUJ TË PRAKTIKËS PROFESIONALE



- Përpilon hulumtime për çështje bazike me interes më të gjerë.
- Merr pjesë në punën e ekipit për realizimin e hulumtimit.
- Interpreton dhe prezanton të dhënat para opinionit më të gjerë profesional.

VII. STRUKTURË, ORGANIZIM DHE KLIMË SHKOLLORE

BASHKËPUNËTORI PROFESIONAL-MENTOR jo vetëm që ka pozicion në shkollë i cili i mundëson të ketë shqyrtim në punën e përgjithshme, por edhe njohuri të profesionale dhe përvoja e përvetësuar i mundësojnë që t'i shikojë situatat me një urtësi të caktuar dhe t'i rreket punës në mënyrë strategjike. E di se shkolla nuk është organizatë statike, porse vazhdimisht ndryshon së bashku me ndryshimet në arsimin dhe shoqërinë më të gjerë. Ai synon ta bëjë shkollën vend më të mirë për nxënie dhe për punë, kryesisht përmes zhvillimit të strategjive, programeve dhe intervenimeve parandaluese, duke i ndërlidhur të njëjtat në një sistem unik shkollor, sipas të cilit shkolla bëhet e dalluar.

VII. STRUKTURË, ORGANIZIM DHE KLIMË SHKOLLORE

Nën-fusha: STRUKTURË DHE ORGANIZIM SHKOLLOR (PLANIFIKIM, VËZHGIM TË PUNËS EDUKATIVO-ARSIMORE, EVIDENCË PEDAGOGJIKE, EVALVIM)

BASHKËPUNËTORI PROFESIONAL...



KOMPETENCA TË BASHKËPUNËTORIT PROFESIONAL-MENTOR

1. Vëzhgon dhe analizon ndryshimet në arsim.
2. Zhvillon dhe zbaton politika arsimore në shkollën.
3. Rezultatet nga vlerësimi i punës së shkollës i shfrytëzon për ngritjen e cilësisë së procesit edukativo-arsimor.



SHEMBUJ TË PRAKTIKËS PROFESIONALE



- Është autor i artikujve/punimeve profesionale në të cilat i analizon/sqaron politikat nacionale në arsim.
- Është ligjërues në seminare/punëtori në shkollë për tema që kanë të bëjnë me reformat në arsim.
- Është anëtar i ekipeve/grupeve punuese për përpilimin e veprimeve, procedurave, rregulloreve dhe programeve në nivel të shkollës.
- Propozon dhe koordinon realizimin e zgjidhjeve të reja organizative në punën edukativo-arsimore.
- Përpilon analiza, plane vepruese.
- Është anëtar i ekipit për përpilimin e programit zhvillimor të shkollës.
- Merr pjesë në konceptimin dhe realizimin e projekteve inovative shkollore.

VII. STRUKTURË, ORGANIZIM DHE KLIMË SHKOLLORE

Nën-fusha: KLIMË SHKOLLORE, MJEDIS I SIGURT DHE PJESËMARRJE DEMOKRATIKE E NXËNËSVE

BASHKËPUNËTORI PROFESIONAL...



KOMPETENCA TË BASHKËPUNËTORIT PROFESIONAL-MENTOR


1. Zhvillon strategji për krijimin e mjedisit të sigurt dhe pozitiv për nxënie.
2. Kontribuon në krijimin e klimës dhe komunikimit pozitiv dhe jo diskriminues shkollore.
3. Përpilon procesin e intervenimit ndaj krizës në shkollë.





SHEMBUJ TË PRAKTIKËS PROFESIONALE

- Zhvillon politikë shkollore për parandalimin e dhunës në shkollë.
- Krijon procedura dhe veprime shkollore për intervenim.
- Koordinon realizimin e politikave, procedurave dhe veprimeve për krijimin e mjedisit të sigurt dhe pozitiv për nxënie.
- Ndërmerr aktivitete për parandalimin dhe tejkalimin e situatave të konfliktit.
- Inicion nisma dhe ndërmerr aktivitete për identifikimin dhe respektimin e diversiteteve në nivel të shkollës dhe në bashkësinë më të gjerë.
- Merr pjesë në përpilimin e planit për intervenim në situata të krizës në shkollë.
- Kontribuon për përgatitjen psikologjike të nxënësve dhe arsimtarëve për reagim në situata të krizës.



KOMPETENCA SPECIFIKE PËR BASHKËPUNTOR PROFESIONAL-MENTOR PEDAGOG

I. PUNË ME NXËNËS

Nën-fusha: VËZHGIM DHE MBËSHTETJE
E ZHVILLIMIT TË NXËNËSVE

PEDAGOGU...



KOMPETENCA TË BASHKËPUNËTORIT PROFESIONAL-MENTOR

1. Përmirëson sistemin për reagim gjatë situatave të krizës të nxënësit në nivel të shkollës.



SHEMBUJ TË PRAKTIKËS PROFESIONALE



- Krijon dhe zhvillon programe parandaluese (p.sh. forcim të vetëbesimit dhe vetërespektit, parandalim të llojeve të papëlqyeshme të sjelljes, nxënie të shkathtësive sociale, motivim për nxënie, etj.) për të gjithë nxënësit, veçanërisht për ata nga grupet e ndjeshme.
- Krijon dhe realizon punëtori për realizimin e programeve parandaluese.
- Vëzhgon efektet nga realizimi i programeve.

II. PUNË ME ARSIMTARË

Nën-fusha: MBËSHTETJE E ARSIMTARËVE GJATË
PLANIFIKIMIT DHE REALIZIMIT TË PROCESIT
EDUKATIVO-ARSIMOR DHE VETËVLERËSIMIT

PEDAGOGU...



KOMPETENCA TË BASHKËPUNËTORIT PROFESIONAL-MENTOR

1. Zhvillon politikë shkollore për notim cilësor.
2. Kupton qasjet konceptuale në notime të ndryshme eksterne nacionale dhe ndërkombëtare, si dhe analizon rezultatet prej tyre.
3. Shfrytëzon metodologji për vlerësimin e librave shkollorë dhe materialeve tjera mësimore.





SHEMBUJ TË PRAKTIKËS PROFESIONALE



- Analizon dhe vlerëson praktikën e notimit në shkollë.
- Shfrytëzon njohuritë nga vlerësimi i njohurive shkencore për notim efektiv në hartimin e politikës shkollore për notim.
- Merr pjesë në vlerësimin e rezultateve nga puna edukativo-arsimore.
- Merr pjesë në përpilimin dhe barazimin e kriterëve për notim.
- Ua sqaron arsimtarëve qasjet konceptuale gjatë notimeve të ndryshme eksterne kombëtare dhe ndërkombëtare.
- Ndihmon arsimtarët që t'i shfrytëzojnë rezultatet nga notimet eksterne (kombëtare dhe ndërkombëtare) për përmirësimin e mësimin dhe nxënies.
- Tregon mënyrën e shfrytëzimit të instrumenteve dhe procedurave për vlerësimin e librave shkollore dhe burimeve tjera të nxënies.
- Rezultatet nga vlerësimi i jep si rekomandime për përzgjedhjen e librave shkollore dhe materialeve mësimore.

II. PUNË ME ARSIMTARË

**Nën-fusha: MBËSHTETJE E ARSIMTARËVE
GJATË PUNËS ME NXËNËS**



PEDAGOGU...

KOMPETENCA TË BASHKËPUNËTORIT PROFESIONAL-MENTOR

1. Përparon punën me nxënësit e talentuar.
2. Ndërlidhë dinamikën e paraleles me mënyrën e menaxhimit në klasë.



SHEMBUJ TË PRAKTIKËS PROFESIONALE



- Sqaron dhe demonstroi mënyrat në të cilat mund t'u ndihmohet nxënësve për shfrytëzimin e qasjeve të ndryshme gjatë nxënies.
- Vëzhgon procesin e ndryshimeve në punë të arsimtari dhe ofron udhëzime për përparimin e mënyrës së punës.
- Përpilon sociogram të paraleles/klasës dhe e analizon atë.
- Njofton arsimtarët e rinj me dinamikën e paraleles me të cilën do të punojnë dhe ofron udhëzime për punë.
- Udhëzon arsimtarët e rinj drejt qasjeve dhe strategjive të reja për mbajtjen e orës.

KOMPETENCA SPECIFIKE PËR BASHKËPUNËTOR PROFESIONAL-MENTOR PSIKOLOG

I. PUNË ME NXËNËS

Nën-fusha: MBËSHTETJE E NXËNËSVE GJATË NXËNIES



KOMPETENCA TË BASHKËPUNËTORIT PROFESIONAL-MENTOR

1. Krijon sistem për identifikim, vëzhgim dhe mbështetje të nxënësve të talentuar në shkollën.



SHEMBUJ TË PRAKTIKËS PROFESIONALE



- Merr pjesë në përpilimin/adaptimin e instrumenteve për identifikimin e nxënësve të talentuar.
- Realizon punëtori dhe konsultime individuale me nxënësit e talentuar (strategji metakognitive, motivim, shkathtësi sociale, etj.).
- Vëzhgon përparimin e nxënësve të talentuar.

I. PUNË ME NXËNËS

Nën-fusha: VËZHGIM DHE MBËSHTETJE TË ZHVILLIMIT TË NXËNËSVE



KOMPETENCA TË BASHKËPUNËTORIT PROFESIONAL-MENTOR

1. Përmirëson sistemin për reagim gjatë situatave të krizës të nxënësve në nivel të shkollës.



SHEMBUJ TË PRAKTIKËS PROFESIONALE

- Krijon dhe zhvillon programe parandaluese (p.sh. forcim të vetëbesimit dhe vetërespektit, parandalim të llojeve të papëlqyeshme të sjelljes, nxënie të shkathtësive sociale, motivim për nxënie, etj.) për të gjithë nxënësit, veçanërisht për ata nga grupet e ndjeshme.
- Krijon dhe realizon punëtori për realizimin e programeve parandaluese.
- Vëzhgon efektet nga realizimi i programeve.

II. PUNË ME ARSIMTARË

Nën-fusha: MBËSHTETJE E ARSIMTARËVE GJATË PLANIFIKIMIT DHE REALIZIMIT TË PROCESIT EDUKATIVO-ARSIMOR DHE VETËVLERËSIMIT



KOMPETENCA TË BASHKËPUNËTORIT PROFESIONAL-MENTOR

1. Zhvillon politikë shkollore për notim cilësor.
2. Kupton qasjet konceptuale në notime të ndryshme eksterne kombëtare dhe ndërkombëtare, si dhe i analizon rezultatet prej tyre.



SHEMBUJ TË PRAKTIKËS PROFESIONALE

- Analizon dhe vlerëson praktikën e notimit në shkollë.
- Shfrytëzon njohuritë nga vlerësimi i njohurive shkencore për notim efektiv në hartimin e politikës shkollore për notim.
- Merr pjesë në vlerësimin e rezultateve nga punë edukativo-arsimore.
- Merr pjesë në përpilimin dhe barazimin e kriterëve për notim.
- Ua sqaron arsimtarëve qasjet konceptuale gjatë notimeve të ndryshme eksterne kombëtare dhe ndërkombëtare.
- Ndihmon arsimtarët që t'i shfrytëzojnë rezultatet nga notimet eksterne (kombëtare dhe ndërkombëtare) për përmirësimin e mësimin dhe nxënies.

II. PUNË ME ARSIMTARË

Nën-fusha: MBËSHTETJE E ARSIMTARËVE GJATË PUNËS ME NXËNËS



KOMPETENCA TË BASHKËPUNËTORIT PROFESIONAL-MENTOR

1. Përparon punën me nxënësit e talentuar.
2. Ndërlidhë dinamikën e paraleles me mënyrën e menaxhimit në klasë.



SHEMBUJ TË PRAKTIKËS PROFESIONALE



- Sqaron dhe demonstroi mënyrat në të cilat mund t'u ndihmohet nxënësve për shfrytëzimin e qasjeve të ndryshme gjatë nxënies.
- Ndjekë procesin e ndryshimeve në punë të arsimtari dhe ofron udhëzime për përparimin e mënyrës së punës.
- Përpilon sociogram të paraleles dhe e analizon atë.
- Njofton arsimtarët e rinj me dinamikën e paraleles me të cilën do të punojnë dhe ofron udhëzime për punë.
- Udhëzon arsimtarët e rinj drejt qasjeve dhe strategjive të reja për mbajtjen e orës.

KOMPETENCA SPECIFIKE PËR BASHKËPUNËTOR PROFESIONAL-MENTOR SOCIOLOG

I. PUNË ME NXËNËS

Nën-fusha: VËZHGIM DHE MBËSHTETJE TË ZHVILLIMIT TË NXËNËSVE



KOMPETENCA TË BASHKËPUNËTORIT PROFESIONAL-MENTOR

1. Përmirëson sistemin për reagim gjatë situatave të krizës të nxënësit në nivel të shkollës.



SHEMBUJ TË PRAKTIKËS PROFESIONALE



- Krijon dhe zhvillon programe parandaluese (p.sh. forcim të vetëbesimit dhe vetërespektit, parandalim të llojeve të papëlqyeshme të sjelljes, nxënie të shkathtësive sociale, motivim për nxënie, etj.) për të gjithë nxënësit, veçanërisht për ata nga grupet e ndjeshme.
- Krijon dhe realizon punëtori për realizimin e programeve parandaluese.
- Vëzhgon efektet nga realizimi i programeve.

KOMPETENCA SPECIFIKE PËR BASHKËPUNËTOR PROFESIONAL-MENTOR DEFEKTOLOG

I. PUNË ME NXËNËS

Nën-fusha: MBËSHTETJE E NXËNËSVE GJATË NXËNIES



KOMPETENCA TË BASHKËPUNËTORIT PROFESIONAL-MENTOR

1. Krijon sistem të identifikimi, vëzhgimit dhe mbështetjes së nxënësve me nevoja të posaçme arsimore në shkollë.



SHEMBUJ TË PRAKTIKËS PROFESIONALE



- Vëzhgon përparimin dhe zhvillon qasje për punë me nxënësit me nevoja të posaçme arsimore.
- Përpilon/adapton instrumente për identifikimin e nxënësve me nevoja të posaçme arsimore.

II. PUNË ME ARSIMTARË

Nën-fusha: MBËSHTETJE E ARSIMTARËVE GJATË PLANIFIKIMIT DHE REALIZIMIT TË PROCESIT EDUKATIVO-ARSIMOR DHE VETËVLERËSIMIT



KOMPETENCA TË BASHKËPUNËTORIT PROFESIONAL-MENTOR

1. Zhvillon politikë shkollore për notim cilësor.
2. Kupton qasjet konceptuale në notime të ndryshme eksterne kombëtare dhe ndërkombëtare, si dhe analizon rezultatet prej tyre.
3. Promovon metoda dhe qasje efektive në punë me nxënës me nevoja të posaçme arsimore.



SHEMBUJ TË PRAKTIKËS PROFESIONALE

- Analizon dhe vlerëson praktikën e notimit në shkollë.
- Shfrytëzon njohuritë nga vlerësimi i njohurive shkencore për notim efektiv në hartimin e politikës shkollore për notim.
- Merr pjesë në vlerësimin e rezultateve nga puna edukativo-arsimore.
- Merr pjesë në përpilimin dhe barazimin e kriterëve për notim.
- Ua sqaron arsimtarëve qasjet konceptuale gjatë notimeve të ndryshme eksterne kombëtare dhe ndërkombëtare.
- Ndihmon arsimtarët që t'i shfrytëzojnë rezultatet nga notimet eksterne (kombëtare dhe ndërkombëtare) për përmirësimin e të arriturave.
- Përgatitë dhe realizon aktivitete mësimore, me qëllim të demonstrimit të metodave dhe qasjeve në punën me nxënës me nevoja të posaçme arsimore.

V. ZHVILLIM PROFESIONAL DHE BASHKËPUNIM PROFESIONAL

Nën-fusha: MBËSHTETJE E ZHVILLIMIT DHE BASHKËPUNIMIT PROFESIONAL NË SHKOLLË



KOMPETENCA TË BASHKËPUNËTORIT PROFESIONAL-MENTOR

1. Përparon punën e arsimtarëve me fëmijë me nevoja të posaçme arsimore.



SHEMBUJ TË PRAKTIKËS PROFESIONALE

- Zhvillon projekte dhe nisma për t'i përmirësuar njohuritë teorike dhe shkathtësitë praktike të arsimtarëve për punë me nxënës me nevoja të posaçme arsimore.

VII. STRUKTURË, ORGANIZIM DHE KLIMË SHKOLLORE

Nën-fusha: STRUKTURË DHE ORGANIZIM SHKOLLOR
(PLANIFIKIM, VËZHGIM TË PUNËS EDUKATIVO-ARSIMORE,
EVIDENCË PEDAGOGJIKE, EVALVIM)



KOMPETENCA TË BASHKËPUNËTORIT PROFESIONAL-MENTOR

1. Përpilon politikë dhe strategji të brendshme shkollore për punë me nxënës me nevoja të posaçme arsimore.



SHEMBUJ TË PRAKTIKËS PROFESIONALE



- Zhvillon sistem për vëzhgim dhe regjistrim përmes të cilit arsimtarët do ta vëzhgojnë dhe shënojnë përparimin e nxënësve me nevoja të posaçme arsimore në drejtim të realizimit të qëllimeve të parashikuara në PIA.
- Zhvillon procedura administrative për komunikim efektiv dhe shkëmbimin e të dhënave me institucionet relevante.
- Përfshin aspektet e arsimimit inkluziv (përfshirës) të nxënësve me nevoja të posaçme arsimore në të gjitha dokumentet strategjike të shkollës

KOMPETENCA SPECIFIKE PËR BASHKËPUNËTOR PROFESIONAL-MENTOR BIBLIOTEKIST

I. PUNË ME NXËNËS

Nën-fusha: MBËSHTETJE E NXËNËSVE GJATË NXËNIES



BIBLIOTEKISTI...

KOMPETENCA PROFESIONALE

1. Ndërlidhë teorinë për nxënie me kërkimin dhe shfrytëzimin e informacioneve për zgjidhjen e problemeve dhe rezonim kritik
2. Shfrytëzon qasje inovative në aftësimin e nxënësve për lexim me kuptim dhe hulumtim të burimeve të informacioneve.
3. Ndërlidhë qëllimet ndërlëndore në dokumentet konceptuese dhe programore me aktivitetet në bibliotekë.



SHEMBUJ TË PRAKTIKËS PROFESIONALE



- Udhëzon nxënësit se si gjatë zgjidhjes së problemeve të shfrytëzojnë burime të ndryshme të informacioneve.
- Organizon aktivitete me nxënësit për vlerësim kritik të informacioneve të fushave dhe burimeve të ndryshme.
- Mëson nxënësit që t'i argumentojnë qëndrimet dhe mendimet.
- Organizon forma të ndryshme të punës grupore të nxënësve për leximin e literaturës artistike.
- Organizon me nxënësit hulumtim të temave të ndryshme përmes kërkimit të literaturës dhe burimeve tjera të informacioneve.
- Shfrytëzon metoda të ndryshme në punë me nxënës (demonstron, ligjëron, mbështetë aktivitete të iniciuara nga vetë nxënësit, etj.).
- Vendosë qëllimet ndërlëndore dhe përzgjedhë aktivitete dhe materiale përkatëse për realizimin e tyre gjatë planifikimit të punës së bibliotekës.
- Realizon aktivitete që përfshijnë qëllime ndërlëndore.

I. PUNË ME NXËNËS

Nën-fusha: VËZHGIM DHE MBËSHTETJE
TË ZHVILLIMIT TË NXËNËSVE



BIBLIOTEKISTI...

KOMPETENCA PROFESIONALE

1. Shfrytëzon mënyra të ndryshme për motivim për lexim.



SHEMBUJ TË PRAKTIKËS PROFESIONALE

- Organizon aktiviteteve të ndryshme për motivim për lexim (lexues i muajit, shkrim i përmbledhjes së librave, gara, klube leximi, klube hulumtuese, etj.).



II. PUNË ME ARSIMITARË

Nën-fusha: MBËSHTETJE E ARSIMITARËVE
GJATË PLANIFIKIMIT DHE REALIZIMIT TË PROCESIT
EDUKATIVO-ARSIMOR DHE VETËVLERËSIMIT



BIBLIOTEKISTI...

KOMPETENCA PROFESIONALE

1. Promovon dhe siguron kushte për qasje të barabartë.
2. Ndihmon arsimtarët që të shfrytëzojnë strategji të llojllojshme për përmirësimin e leximit në kuadër të mësimit të rregullt duke marrë parasysh nevojat dhe interesat e ndryshëm të nxënësve.



SHEMBUJ TË PRAKTIKËS PROFESIONALE

- Zhvillon politikë për qasje të barabartë deri te resurset në bibliotekë dhe vëzhgon zbatimin e saj.
- Analizon shfrytëzimin e bibliotekës nga aspekti i qasjes deri te shfrytëzuesit e ndryshëm, për arsyet e shfrytëzimit të pamjaftueshëm të bibliotekës nga kategori të caktuara të shfrytëzuesve potencial, etj., ofron propozime për tejkalim, ndërmerr aktivitete konkrete, etj.
- Ndërmerr aktivitete konkrete për tejkalimin e barrierave fizike, sociale dhe intelektuale që pamundësojnë qasje të barabartë deri te resurset dhe shërbimet.
- Ndihmon arsimtarët në gjetjen dhe shfrytëzimin e materialeve që janë adekuate me karakteristikat e moshës, kognitive dhe sociale të nxënësve.
- Organizon punëtori për arsimtarë për shfrytëzimin e strategjive për lexim me kuptimin e llojeve të ndryshme të teksteve.
- Organizon grupe për nxënie me arsimtarë për vendosjen e strategjive për nxënie në mësimdhënie.



II. PUNË ME ARSIMTARË

Nën-fusha: MBËSHTEJTE E ARSIMTARËVE GJATË PUNËS ME NXËNËS

BIBLIOTEKISTI...



KOMPETENCA PROFESIONALE

1. Ndihmon arsimtarët për inovacion në shfrytëzimin e mediave dhe burimeve të reja të informacioneve në mësim.



SHEMBUJ TË PRAKTIKËS PROFESIONALE



- Këshillon arsimtarët, organizon punëtori.
- Demonstron shfrytëzim inovativ të mediave të reja dhe i nxitë arsimtarët që t'i shfrytëzojnë ato.
- U sugjeron arsimtarëve se ku mund t'i vendosin burimet e reja të informacioneve në mësim.

III. PUNË ME PRINDËR

Nën-fusha: EDUKIM I PRINDËRVE

BIBLIOTEKISTI...



KOMPETENCA PROFESIONALE

1. Përmirëson bashkëpunimin e shkollës me familjen.



SHEMBUJ TË PRAKTIKËS PROFESIONALE



- Informon prindërit për burimet e reja të informacioneve arsimore.
- Inicion dhe organizon projekte për përfshirjen e prindërve në jetën dhe punën e shkollës.

IV. BASHKËPUNIM ME BASHKËSINË

Nën-fusha: BASHKËPUNIM ME INSTITUCIONE
DHE ORGANIZATA PROFESIONALE



KOMPETENCA PROFESIONALE

1. Inicion dhe zhvillon bashkëpunim partneriteti me bashkësinë për çështje relevante arsimore në bashkësimë.



SHEMBUJ TË PRAKTIKËS PROFESIONALE



- Realizon aktivitete të përbashkëta me institucione dhe organizata tjera për promovimin e leximit.
- Përpilon procedura për mënyrën e planifikimit, organizimit dhe realizimit të aktiviteteve dhe për vëzhgimin dhe vlerësimin e tyre. (ligjërata, tribuna, ekspozita, gara, etj.).
- Ka rol udhëheqës në projektet për bashkëpunim me bashkësinë lokale (iniciator, udhëheqës, koordinator).
- Njohuritë dhe përvojat e tij profesionale i prezanton para opinionit më të gjerë.
- Informon bashkësinë lokale për çështje të caktuara aktuale nga arsimi dhe ofron mbështetje për çështje nga fusha e tij.

V. ZHVILLIM PROFESIONAL DHE BASHKËPUNIM PROFESIONAL

Nën-fusha: ZHVILLIM PERSONAL PROFESIONAL



KOMPETENCA PROFESIONALE

1. Bën vlerësimin e aktiviteteve profesionale nga aspekti i efekteve dhe i përmirëson ato.



SHEMBUJ TË PRAKTIKËS PROFESIONALE



- Përpilon instrumente për reflektim dhe vetëvlerësimin dhe shkëmben përvojat nga zhvillimi personal profesional dhe praktika profesionale.
- Ndjekë literaturë profesionale për kërkimin e thellë të specifikave dhe çështjeve të reja nga fusha dhe e shfrytëzon në punë.
- Ndjekë trajnime për arritjen e kompetencave më të larta (shkathtësi më specifike nga fusha, trajnime për mentor, për udhëheqje, hulumtim).
- Zbaton vlerësime të rregullta të nevojave për shfrytëzimin e bibliotekës duke shfrytëzuar instrumente hulumtuese si pyetësorë, grupe fokusi, intervistë, etj.
- Zbaton hulumtime vepruese për përmirësimin e punës personale.

V. ZHVILLIM PROFESIONAL DHE BASHKËPUNIM PROFESIONAL

Nën-fusha: MBËSHTETJE E ZHVILLIMIT
DHE BASHKËPUNIMIT PROFESIONAL NË SHKOLLË

BIBLIOTEKISTI...



KOMPETENCA PROFESIONALE

1. Promovon qasje inovative në shfrytëzimin e teknologjive informative dhe burimeve tjera të informacioneve.
2. Njeh mënyra të qasjes dhe di të sigurojë informacione prej bazave të ndërlukuara.



SHEMBUJ TË PRAKTIKËS PROFESIONALE



- Ofron sugjerime për përmirësimin e punës së shkollës.
- Shkëmben njohuritë dhe informacionet me kuadrin mësimdhënës dhe udhëheqës.
- Përpilon drejtime, udhëzime për shfrytëzimin e burimeve të ndryshme të informacioneve në mësim.
- Siguron materiale për nevojat e shkollës prej bibliotekave tjera vendore dhe të huaja.

VI. STRUKTURË, ORGANIZIM DHE KLIMË SHKOLLORE

Nën-fusha: STRUKTURË, ORGANIZIM DHE KLIMË SHKOLLORE

BIBLIOTEKISTI...



KOMPETENCA PROFESIONALE

1. Ndërlidhë risitë në bazat e burimeve të informacioneve (TED, on-lajne kurse, materiale didaktike elektronike, etj.) me nevojat për nxënie.
2. Di të zhvillojë programe për punë të bibliotekës që e vendosin atë në qendër të nxënies edhe shkëmbimit të informacioneve në shkollë.
3. Motivon dhe trajnon nxënës për punë vullnetare në bibliotekë.
4. Ndërton strategji dhe organizon aktivitete për pasurimin dhe shfrytëzimin e fondit të bibliotekës dhe të bibliotekës si resurs për nxënie.
5. Organizon bibliotekën si qendër të resurseve për materiale profesionale dhe marrjen e ideve për përpilimin e materialeve profesionale.





SHEMBUJ TË PRAKTIKËS PROFESIONALE

- Informohet për përmbajtje dhe karakteristika të bazave specifike të informacioneve.
- Informon dhe udhëzon për mënyrat e shfrytëzimit të bazave të reja të informacioneve.
- Promovon bibliotekën si qendër të nxënies të të gjithëve në shkollë dhe në bashkësinë më të gjerë.
- Bashkëpunon me nxënës, arsimtarë, administratë shkollore dhe prindër, në përpilimin e programit për punë, që t'u dalë në ndihmë nevojave të tyre.
- Paraqet punën e bibliotekistit para nxënësve.
- Bën përzgjedhje të nxënësve të interesuar për punë vullnetare në bibliotekë.
- Bën program për trajnim të nxënësve.
- Përfshin në mënyrë aktive nxënësit në realizimin e aktiviteteve të bibliotekës.
- Ndihmon nxënësit që të përpilojnë materiale për prezantimin e punës së tyre dhe punës së bibliotekës.
- Vendos sistem dhe shfrytëzon mënyra të ndryshme për rritjen e fondit të bibliotekës (p.sh. donacione nga shtëpi botuese dhe individë, aktivitete për grumbullimin e mjeteve për pajisjen e bibliotekës).
- Bashkë me arsimtarët bën vlerësim dhe seleksionim të rregullt të materialeve profesionale në përputhje me nevojat, aftësitë dhe interesat e nxënësve dhe të punësuarve dhe specifikat e shkollës dhe mjedisit.
- Organizon "panair të librave" për shitje në shkollë.
- Organizon aktivitete donatore.
- Gjen sponsorë.
- Përfshin arsimtarët, nxënësit dhe prindërit në aktivitete për rritjen e fondit të bibliotekës.
- Ofron ide për shfrytëzim inovativ të bibliotekës.
- Përkufizon misionin dhe prioritetet e bibliotekës.



**STANDARDE
PROFESIONALE**
për **BASHKËPUNËTOR**
PROFESIONAL-KËSHILLTAR

KOMPETENCA TË PËRBASHKËTA PËR BASHKËPUNËTOR PROFESIONAL-KËSHILLTAR

PIKËNISJE THEMELORE

Në këtë pjesë janë zhvendosur kompetencat që bashkëpunëtori profesional i cili tashmë ka marrë titullin-mentor, duhet t'i posedojë për të marrë titullin bashkëpunëtor profesional-këshilltar. Ato paraqesin sendërtim të *Kompetencave themelore profesionale të bashkëpunëtorëve profesional dhe standardeve për bashkëpunëtor profesional-mentor* dhe paraqesin një lloj kriteri që pritet ta plotësojnë vetëm një pjesë e bashkëpunëtorëve më të dalluar profesional dhe si rezultat të avancohen në profesion.

Gjatë përkufizimit të standardeve është nisur nga konceptimi i bashkëpunëtorit profesional-këshilltar si praktikant i cili gjatë punës i ka zhvilluar dhe përsosur kompetencat themelore profesionale për bashkëpunëtor profesional dhe standardet për bashkëpunëtor profesional-mentor, por edhe ka vazhduar të sendërtohet dhe ka treguar se angazhohet tërësisht në nivel më të gjerë në shkollë, kështu që përfshihet në përpilimin e dokumenteve, strategjive dhe projekteve kombëtare, shpërndanë njohurinë përmes përpilimit të broshurave, doracakëve, librave, mbajtjes së trajnimeve, pjesëmarrjes në emisione informative dhe ngjashëm.

Gjatë përpilimit të standardeve u përkushtohet më shumë vëmendje standardeve të përbashkëta, sesa standardeve për profilet e posaçme profesionale, për shkak se vlerësohet se angazhimi në nivel lokal dhe kombëtar kërkon kompetenca që janë të ngjashme te secili profil i bashkëpunëtorit profesional dhe sendërtohet në kompetencat profesionale karakteristike për profilet konkrete profesionale.

Qëllimi përfundimtar i *Standardeve profesionale për bashkëpunëtor profesional-këshilltar* është që të kontribuojnë për angazhim të lartë cilësor të bashkëpunëtorit profesional-këshilltar që i tejkalon kornizat e punës së përditshme në shkollë, e me këtë të kontribuohet për punë më cilësore të të gjitha shkollave.



PUNË ME NXËNËS

BASHKËPUNËTORI PROFESIONAL-KËSHILLTAR është me kompetencë të lartë në fushën e tij profesionale dhe demonstroi praktikë e cila është shembull i mirë për punë me nxënës dhe që mund të jetë e rekomanduar në nivel sistemor. Ai posedon shkathtësi të thelluara për punë të drejtpërdrejtë me nxënës, qasjet e tij në punë janë inovative, të mbështetura në hulumtime të reja shkencore ose praktika të vërtetuara personale, është i përkushtuar në angazhimin për ndryshime në politikat që i prekin nxënësit në nivel rajonal ose kombëtar dhe për këtë arsye njohuritë dhe shkathtësitë për punë me nxënës ia prezanton opinionit më të gjerë profesional dhe është lider i ndryshimeve. Përvoja shumëvjeçare i mundëson perspektivë më të gjerë, ndaj në këtë mënyrë pikëpamjet, qëndrimet, kuptimet dhe angazhimet e tij e tejkalojnë nxënien dhe mirëqenien e nxënësve në shkollë dhe janë të zbatueshme në një kontekst më të gjerë rajonal dhe kombëtar. Ai angazhohet për nxënie dhe zhvillim më të suksesshëm të të gjithë nxënësve, ndërsa këtë e tregon përmes zhvillimit të programeve lokale ose kombëtare dhe intervenimeve për mbështetjen e nxënësve, publikimin e shembujve nga praktika, pjesëmarrje në përpunimin e dokumenteve kombëtare dhe ngjashëm. Secili nga profilet e bashkëpunëtorëve profesional synon që në dokumentet e karakterit sistemor në përpilimin e të cilit është përfshirë, ta vendosë ekspertizën nga profesioni i tij më i ngushtë dhe të sigurojë përfshirje të gjithmbarshme të qasjeve në punën me nxënës.

I. PUNË ME NXËNËS

Nën-fusha: MBËSHTETJE E NXËNËSVE GJATË NXËNIES

BASHKËPUNËTORI PROFESIONAL...



KOMPETENCA TË BASHKËPUNËTORIT PROFESIONAL-KËSHILLTAR

1. Përpilon dhe realizon qasje të reja gjatë vlerësimit dhe vëzhgimit të përparimit të nxënësve.
2. Promovon qasje bashkëkohore gjatë nxënies para bashkësisë më të gjerë profesionale.
3. Promovon përmirësim në politikat, qasjet dhe metodat për nxënie efektive të rezultuara nga hulumtimet dhe/ose të kontrolluara në praktikë.
4. Kontribuon në përfshirjen e nxënësve në bashkësinë më të gjerë.



SHEMBUJ TË PRAKTIKËS PROFESIONALE



- Është anëtar i ekipit që krijon metoda, strategji dhe instrumente për vëzhgimin e përparimit të nxënësve në nivel kombëtar.
- Zhvillon programe dhe ndërhyrje për mbështetjen e nxënësve gjatë nxënies në nivel lokal dhe/ose nivel kombëtar dhe merr pjesë në vlerësimin e tyre.
- Hulumton, përshtatë dhe zhvillon qasje për mbështetje të nxënësve gjatë nxënies.
- Vlerëson efektivitetin e intervenimeve individuale dhe sistemore në mënyrën e nxënies së nxënësve.
- Publikon shembuj nga praktika personale dhe hulumtime në revista profesionale ose të postuara në faqe zyrtare (të recensuara) të internetit.
- Merr pjesë në ekipe për zhvillimin e qasjeve dhe metodave për nxënie efektive.
- Merr pjesë në hulumtime për vlerësimin e qasjeve dhe programeve të pranuar për nxënie efektive.
- Prezanton të dhëna nga hulumtimet në tubime profesionale, në libra, publikime, artikuj, revista profesionale, doracakë, etj.
- Merr pjesë në përpunimin e dokumenteve për përmirësimin e arsimit inkluziv (përfshirës) në nivel kombëtar dhe lokal.
- Merr pjesë në projekte dhe nisma në nivel kombëtar dhe lokal për përfshirjen e nxënësve me nevoja të posaçme arsimore në shkollë dhe mjedisin më të gjerë.
- Merr pjesë në grupe punuese për përpunimin e instrumenteve për identifikimin e nevojave të posaçme arsimore në nivel kombëtar.

I. PUNË ME NXËNËS

Nën-fusha: VËZHIM DHE MBËSHTETJE
TË ZHVILLIMIT TË NXËNËSVE

BASHKËPUNËTORI PROFESIONAL...



KOMPETENCA TË BASHKËPUNËTORIT PROFESIONAL-KËSHILLTAR

1. Zhvillon qasje të reja për ndjekjen dhe mbështetjen e zhvillimit të nxënësve.



SHEMBUJ TË PRAKTIKËS PROFESIONALE

- Merr pjesë në ekipe profesionale në nivel lokal ose kombëtar për përpilimin e programeve për mbështetjen e zhvillimit të nxënësve.
- Merr pjesë në realizimin dhe vlerësimin e efektivitetit të programeve të realizuara në nivel lokal ose kombëtar.



I. PUNË ME NXËNËS

Nën-fusha: ORIENTIM PROFESIONAL
DHE NË KARRIERË I NXËNËSVE

BASHKËPUNËTORI PROFESIONAL...



KOMPETENCA TË BASHKËPUNËTORIT PROFESIONAL-KËSHILLTAR

1. Hulumton dhe promovon qasje të reja në zhvillim profesional dhe në karrierë.



SHEMBUJ TË PRAKTIKËS PROFESIONALE

- Merr pjesë në përpilimin e dokumenteve strategjike dhe programore për zhvillim profesional dhe në karrierë.
- Merr pjesë në përpilimin e qasjeve dhe instrumenteve të reja për orientim profesional dhe zhvillim në karrierë.
- Merr pjesë në vlerësimin e efekteve nga qasjet e zbatuara të zhvillimit profesional dhe në karrierë në nivel kombëtar ose lokal.





II. PUNË ME ARSIMTARË

BASHKËPUNËTORI PROFESIONAL-KËSHILLTAR jo vetëm që është i respektuar dhe shumë i çmuar nga arsimtarët në shkollë, por është i dalluar si bashkëpunëtor i lartë profesional dhe i pranuar në bashkësinë më të gjerë. Me kalimin e periudhës në punë ka marrë përvojë dhe siguri të mjaftueshme që të mund t'i mbështesë arsimtarët në punë, edhe atë jo vetëm ata nga shkolla e tij, por edhe arsimtarët nga rajoni ose shteti. Këtë e arrin përmes pjesëmarrjes në përpilimin e dokumenteve konceptuale, autorësisë së artikujve/analizave, përpunimin e materialeve didaktike-metodike, pjesëmarrjen në intervenime sistemore dhe ngjashëm. Në punën e dokumenteve me interes më të gjerë që e përparojnë punën e arsimtarëve nga bashkëpunëtori profesional-këshilltar pritet që të japë kontribut të thellë nga aspekti i profesionalizmit më të ngushtë personal.

II. PUNË ME ARSIMTARË

Nën-fusha: MBËSHTETJE E ARSIMTARËVE GJATË PLANIFIKIMIT DHE REALIZIMIT TË PROCESIT EDUKATIVO-ARSIMOR DHE VETËVLERËSIMIT

BASHKËPUNËTORI PROFESIONAL...



KOMPETENCA TË BASHKËPUNËTORIT PROFESIONAL-KËSHILLTAR

1. Përpilon dokumente konceptuale dhe programore në nivel nacional.
2. Përparon aspektet didaktike-metodike të mësimi.



SHEMBUJ TË PRAKTIKËS PROFESIONALE



- Është anëtar i ekipeve për përpilimin e dokumenteve konceptuale në arsim.
- Është autor /bashkautor i analizave dhe vlerësimeve të aspekteve të caktuara të sistemit edukativo-arsimor në nivel kombëtar.
- Është autor i artikujve në të cilat i analizon/sqaron politikat kombëtare në arsim.
- Merr pjesë në ekipet për përpilimin e programeve mësimore.
- Përpilon materiale profesionale didaktike-metodike që janë pozitivisht të recensuara (shembuj të praktikës së mirë).
- Është autor/bashkautor i doracakëve, udhëzimeve, drejtimeve, mjeteve të konkretizimit dhe ngjashëm me të cilat përparohet mësimi.
- Është recensent i librave shkollorë dhe burimeve tjera për nxënie.
- Është autor/bashkautor i librave të aprovuar shkollor dhe materialeve punuese për nxënës.

II. PUNË ME ARSIMTARË

Nën-fusha: MBËSHTETJE E ARSIMTARËVE GJATË PUNËS ME NXËNËS

BASHKËPUNËTORI PROFESIONAL...



KOMPETENCA TË BASHKËPUNËTORIT PROFESIONAL-KËSHILLTAR

1. Kontribuon në zhvillimin dhe vlerësimin e intervenimeve/ndryshimeve sistemore në shkollë, komunë ose rajon.



SHEMBUJ TË PRAKTIKËS PROFESIONALE



- Vlerëson efikasitetin e programeve kombëtare dhe i modifikon në bazë të njohurive.
- Realizon intervenime/ndryshime sistemore në shkollë dhe/ose komunë/qytet.
- Vlerëson efektet nga aktivitetet e ndërmarra.

III. PUNË ME PRINDËR¹⁰

BASHKËPUNËTORI PROFESIONAL-KËSHILLTAR njihet në mesin e prindërve si dikush që kontribuon në nxënien dhe zhvillimin e nxënësve dhe si dikush që është vazhdimisht i informuar për të gjitha zhvillimet/çështjet relevante për jetën e nxënësve. Angazhimi i tij i tejkalon këshillimet e suksesshme me prindërit në shkollë, meqë duke shkruar doracakë, duke marrë pjesë në përpilimin e dokumenteve konceptuale ose në emisione edukative, duke shkruar në revista dhe faqe të njohura të internetit, ai është aktiv dhe ka ndikim në përmasa më të gjera në shoqëri.

¹⁰ Me prind nënkuptohet edhe përfaqësues ligjor, kujdestar.

III. PUNË ME PRINDËR

Nën-fusha: KËSHILLIME DHE KONSULTIME INDIVIDUALE
DHE GRUPORE ME PRINDËR

BASHKËPUNËTORI PROFESIONAL...



KOMPETENCA TË BASHKËPUNËTORIT PROFESIONAL-KËSHILLTAR

1. Identifikon qasje të reja efektive në këshillimin e prindërve dhe i zbaton ato në praktikë.



SHEMBUJ TË PRAKTIKËS PROFESIONALE

- Është autor/recensent i doracakut për punë me prindër në veprimtarinë edukativo-arsimore.
- Merr pjesë në përpilimin e dokumenteve konceptuale për punë me prindër.



III. PUNË ME PRINDËR

Nën-fusha: EDUKIM I PRINDËRVE

BASHKËPUNËTORI PROFESIONAL...



KOMPETENCA TË BASHKËPUNËTORIT PROFESIONAL-KËSHILLTAR

1. Prindërit dhe opinionin më të gjerë i edukon për çështje që kanë të bëjnë me të qenët prind përmes mjeteve për komunikim masiv.



SHEMBUJ TË PRAKTIKËS PROFESIONALE

- Është autor i doracakut për prindër (për të qenët prind më i mirë).
- Merr pjesë në TV/radio emisione edukative.
- Shkruan në revista dhe faqe të famshme interneti për të qenët prind.
- Është udhëheqës i shkollave për prindër.



IV. BASHKËPUNIM ME BASHKËSINË

BASHKËPUNËTORI PROFESIONAL-KËSHILLTAR jo vetëm që është iniciator, por është edhe inovator dhe kjo perceptohet në angazhimin e tij në bashkësi, ku vazhdimisht gjen mënyra për të iniciuar dhe organizuar projekte për përmirësimin e jetës në shkollë dhe në bashkësi. Ai është i dalluar në bashkësi si iniciator i bashkëpunimit me bashkësinë, gjë që karakterizohet me përmbajtje dhe mënyra të reja të bashkëpunimit. Ai është krenar me të arriturat e shkollës së tij, ndaj për këtë arsye e shfrytëzon çdo rast për ta promovuar shkollën në bashkësi, si dhe banorët e bashkësisë t'i lidhë fortë me shkollën.

IV. BASHKËPUNIM ME BASHKËSINË

Nën-fusha: BASHKËPUNIM ME BASHKËSINË LOKALE

BASHKËPUNËTORI PROFESIONAL...



KOMPETENCA TË BASHKËPUNËTORIT PROFESIONAL-KËSHILLTAR

1. Identifikon fusha dhe mënyra të reja për bashkëpunim me bashkësinë dhe merr përsipër rolin udhëheqës në zbatimin e tyre.



SHEMBUJ TË PRAKTIKËS PROFESIONALE



- Inicion, përpilon dhe organizon projekte me bashkësinë lokale për përmirësimin e të arriturve të nxënësve dhe jetës në bashkësinë.
- Ndërton strategji dhe e promovon punën e shkollës dhe të arriturat e nxënësve në bashkësinë më të gjerë.
- Organizon dhe mban seminare, tribuna dhe punëtori për përparimin e marrëdhënieve partnere në mes shkollave dhe institucioneve nga bashkësia.

V. ZHVILLIM PROFESIONAL DHE BASHKËPUNIM PROFESIONAL

BASHKËPUNËTORI PROFESIONAL-KËSHILLTAR është shembull i një profesionisti i cili investon vazhdimisht dhe shumë në zhvillimin e tij profesional. Si rezultat i kësaj ai merr arsim plotësues formal dhe përfshihet në forma të ndryshme të arsimit joformal. Për shkak të përvojës dhe njohurive për zhvillimin profesional të bashkëpunëtorëve dhe kuadrit tjetër edukativo-arsimor ai angazhohet në përgatitjen e dokumenteve strategjike për zhvillim profesional në nivel të shtetit. Bashkëpunëtori profesional-këshilltar ka kompetenca dhe përvoja të ndryshme në forma për zhvillim profesional të kuadrit edukativo-arsimor që tejkalojnë kornizat e shkollës. Prandaj, kolegët e tij, bashkëpunëtorët profesional dhe arsimtarët e vlerësojnë kompetencën e tij në shumë fusha dhe e përjetojnë si dikë që është aty për ta për t'u ndihmuar në zhvillimin e tyre profesional.

V. ZHVILLIM PROFESIONAL DHE BASHKËPUNIM PROFESIONAL

Nën-fusha: ZHVILLIMI PERSONAL PROFESIONAL

BASHKËPUNËTORI PROFESIONAL...



KOMPETENCA TË BASHKËPUNËTORIT PROFESIONAL-KËSHILLTAR

1. Zhvillon dhe zbaton strategji dhe dokumente për zhvillim profesional në nivel rajonal dhe kombëtar
2. Vazhdimisht zhvillon njohuritë e veta shkencore dhe profesionale.



SHEMBUJ TË PRAKTIKËS PROFESIONALE



- Është anëtar i grupeve të punës për përgatitjen e dokumenteve për zhvillim profesional të interesit rajonal dhe kombëtar.
- Prezanton njohuritë profesionale që i ka arritur përmes hulumtimeve në shtypin profesional (revista, libra, doracakë) ose në takime profesionale.
- Merr pjesë në punën e trupit për vlerësim të avancimit profesional dhe në karrierë të kolegëve arsimtarë / bashkëpunëtorëve profesional.
- Merr pjesë në përzgjedhjen, përshtatjen dhe përpilimin e instrumenteve për vlerësimin e arsimtarëve / bashkëpunëtorëve profesional.
- Ofron propozime për përmirësimin e rolit (kompetenca, programe, status, organizim sipas profesionit) të profilit personal të bashkëpunëtorit profesional.
- Zhvillim profesional në tituj shkencorë (specializim/master/doktoratë).
- Përdor forma të ndryshme të zhvillimit joformal profesional për risitë në profesion.
- Merr pjesë në takime profesionale kombëtare dhe ndërkombëtare.
- Merr pjesë në udhëtime profesionale dhe studimore.

V. ZHVILLIM PROFESIONAL DHE BASHKËPUNIM PROFESIONAL

Nën-fusha: MBËSHTETJE E ZHVILLIMIT
DHE BASHKËPUNIMIT PROFESIONAL NË SHKOLLË

BASHKËPUNËTORI PROFESIONAL...



KOMPETENCA TË BASHKËPUNËTORIT PROFESIONAL-KËSHILLTAR

1. Kontribuon që arsimtarët të përvetlojnë kompetenca më të larta.
2. Kontribuon në zhvillimin profesional të kolegëve dhe bashkëpunëtorëve profesional.
3. Inicion bashkëpunim mes shkollave për zhvillim profesional.





SHEMBUJ TË PRAKTIKËS PROFESIONALE

- Ndihmon mentorët e arsimtarëve në përgatitjen e programit të mentorimit dhe vëzhgon realizimin e tij.
- Është autor/bashkautor i programit për zhvillimin profesional të mësimeve dhe bashkëpunëtorëve profesional.
- Është realizues i trajnimeve jashtë shkollës.
- Ndihmon arsimtarët në zbatimin e hulumtimeve vepruese dhe në përgatitjen e prezantimit të gjetjeve dhe/ose përpilimin e llojeve të ndryshme të punimeve profesionale.
- Praktikant e suksesshme të tij i ndan me kolegët në funksion të zhvillimit të tyre profesional.
- Administron faqen e vet të internetit/blog për të shkëmbyer informacione dhe përvoja nga profesioni.
- Inicion bashkëpunim rajonal/kombëtar të bashkëpunëtorëve profesional.
- Është realizues i trajnimeve, punëtorive, konsultimeve për kolegët bashkëpunëtorë profesional në nivel kombëtar.
- Informon dhe nxitë kolegët për të shfrytëzuar mundësitë për nxënie dhe zhvillim profesional.
- Udhëheq punën e aktiveve profesionale, seksioneve dhe/ose shoqatave të bashkëpunëtorëve profesional në nivel rajonal dhe shtetëror.
- Organizon forma të ndryshme të shkëmbimit të praktikave të mira për avancimin e zhvillimit profesional dhe në karrierë të arsimtarëve dhe bashkëpunëtorëve profesional në nivel të bashkësisë.





VI. PUNË ANALITIKE-HULUMTUESE

BASHKËPUNËTORI PROFESIONAL-KËSHILLTAR posedon kompetenca të larta profesionale për studime dhe hulumtime komplekse në punën edukativo-arsimore. Ai di të shfrytëzojë proceduara dhe zbulime shkencore-hulumtuese që do të kontribuojnë në sqarimin e dukurive dhe situatave të ndryshme dhe sjelljen e vendimeve në nivel sistematik. Ka zhvilluar aftësi për të bërë plane kërkimore më komplekse që kërkojnë edhe analiza më komplekse statistikore, për shkak të cilës arsye paraqet burim të vlefshëm për institucionet tjera arsimore të cilat merren me punë hulumtuese dhe shpesh është i angazhuar në projekte, hulumtime, analiza të ndryshme, etj. Bashkëpunëtori profesional-këshilltar i analizon në mënyrë kritike të dhënat për gjendjen në sistemin e edukativo-arsimor, sipas nevojës bën meta-analiza, i prezanton njohuritë dhe në bazë të tyre jep sugjerime për përmirësime sistematike. Në fushën më të ngushtë profesionale bën hulumtime më komplekse relevante për arsimin në kontekst më të gjerë (kombëtar ose ndërkombëtar).

VI. PUNË ANALITIKE-HULUMTUESE

Nën-fusha: ANALIZË DHE VLERËSIM
I PUNËS EDUKATIVO-ARSIMORE

BASHKËPUNËTORI PROFESIONAL...



KOMPETENCA TË BASHKËPUNËTORIT PROFESIONAL-KËSHILLTAR

1. Bën vështrim kritik/analizë të kushteve ekzistuese në arsim.



SHEMBUJ TË PRAKTIKËS PROFESIONALE



- Përpilon analiza, interpreton rezultate dhe i prezanton para publikut më të gjerë.
- Bën meta-analizë të të dhënave dhe i publikon njohuritë.
- Analizon situatat dhe politikat e arsimit, si dhe pasojat e tyre dhe i prezanton njohuritë.

VI. PUNË ANALITIKE-HULUMTUESE

Nën-fusha: HULUMTIM I PUNËS EDUKATIVO – ARSIMORE

BASHKËPUNËTORI PROFESIONAL...



KOMPETENCA TË BASHKËPUNËTORIT PROFESIONAL-KËSHILLTAR

1. Punon në projekte hulumtuese në bashkëpunim me institucione tjera profesionale kombëtare dhe ndërkombëtare.



SHEMBUJ TË PRAKTIKËS PROFESIONALE



- Merr pjesë në formimin dhe standardizimin e mjeteve matëse.
- Mban trajnime për projekte hulumtuese në procesin edukativo-arsimor.
- Rezultatet e hulumtimit i publikon në revista vendore dhe të huaja.
- Merr pjesë në ekipe për hulumtime (kombëtare dhe ndërkombëtare), të realizuara nga institucionet tjera arsimore (p.sh. BZHA, QATP, fakultete, etj.).
- Bën meta-analizë të rezultateve të hulumtimit për çështje të ndryshme, të prezantuara në studime hulumtuese kombëtare dhe ndërkombëtare.

VII. STRUKTURË, ORGANIZIM DHE KLIMË SHKOLLORE

BASHKËPUNËTORI PROFESIONAL-KËSHILLTAR krahas asaj që i kryeson proceset e planifikimit afatgjatë të strategjive dhe politikave për fusha të ndryshme në nivel të shkollës, për shkak të kompetencës dhe inovacionit të tij përfshihet edhe në përpilimin e dokumenteve strategjike dhe konceptuale në nivel të shtetit. Ai jo vetëm që ka suksese në krijimin e mjedisit stimulues dhe të sigurt në shkollën e tij, por angazhohet edhe për bashkësi të sigurt në të cilën janë përfshirë edhe shkolla tjera dhe anëtarë të bashkësisë lokale. Krahas angazhimit për inkluzion (përfshirje) të nxënësve në shkollë, angazhohet edhe në përfshirjen e tyre në bashkësinë më të gjerë, kështu që inicion projekte për bashkëpunim mes shkollave ose aktivitete për bashkëpunim me bashkësinë lokale.

VII. STRUKTURË, ORGANIZIM DHE KLIMË SHKOLLORE

**Nën-fusha: STRUKTURË DHE ORGANIZIM SHKOLLOR
(PLANIFIKIM, VËZHGIM TË PUNËS EDUKATIVO-ARSIMORE,
EVIDENCË PEDAGOGJIKE, EVALVIM)**

BASHKËPUNËTORI PROFESIONAL...



KOMPETENCA TË BASHKËPUNËTORIT PROFESIONAL-KËSHILLTAR

1. Analizon dhe përpilon dokumente konceptuese dhe strategjike në arsim.
2. Zhvillon projekte për përparimin e punës edukativo-arsimore në nivel rajonal dhe kombëtar.
3. Udhëheqë procesin e planifikimit zhvillimor në shkollë.
4. Përmirëson politikat shkollore për notim.



SHEMBUJ TË PRAKTIKËS PROFESIONALE



- Koordinon nisma të shkollës për përmirësimin e planeve dhe programeve mësimore.
- Është anëtar i ekipeve për përpilimin e dokumenteve konceptuese në arsim.
- Është autor/bashkautor i analizave dhe vlerësimeve të disa aspekteve të caktuara të sistemit arsimor në nivel kombëtar.
- Është anëtar i ekipit që udhëheqë projekte të reja në nivel kombëtar.
- Prezanton përvoja nga inovacionet e realizuara në literaturë profesionale, media, tubime profesionale, konferenca, seminare.
- Merr pjesë në projekte ndërkombëtare.
- Është autor/bashkautor i projekteve të aprovuara me të cilat përparohet puna edukativo-arsimore.
- Koordinon aktivitetet për ndërlidhjen e planeve të përpiluara strategjike dhe zhvillimore.
- Organizon mbikëqyrje dhe vlerësim të programit zhvillimor të shkollës.
- Përgatitë raport nga vlerësimi i programit zhvillimor në fusha të caktuara.
- Udhëheqë ekipin për ndërtimin e politikës shkollore për notim.

VII. STRUKTURË, ORGANIZIM DHE KLIMË SHKOLLORE

Nën-fusha: KLIMË SHKOLLORE, MJEDIS I SIGURT
DHE PJESËMARRJE DEMOKRATIKE E NXËNËSVE

BASHKËPUNËTORI PROFESIONAL...



KOMPETENCA TË BASHKËPUNËTORIT PROFESIONAL-KËSHILLTAR


1. Nxitë aktivitete për krijimin e një mjedisi të sigurt dhe pozitiv për nxënësit në nivel lokal.
2. Kontribuon në përfshirjen e nxënësve në bashkësinë më të gjerë.



SHEMBUJ TË PRAKTIKËS PROFESIONALE



- Inicion, organizon dhe realizon aktivitete të përbashkëta për bashkëpunimin mes nxënësve dhe arsimtarëve të shkollave të ndryshme për shkak të sigurisë.
- Inicion, organizon dhe realizon aktivitete të përbashkëta me bashkësinë lokale për shkak të sigurisë së nxënësve.
- Propozon dhe ndërmerr aktivitete për përfshirjen e nxënësve në jetën dhe punën e bashkësisë lokale pa dallim të aftësive të tyre, prejardhjes dhe gjendjes socio-ekonomike.
- Merr pjesë në përpilimin e dokumenteve për përmirësimin e arsimit inkluziv (përfshirës) në nivel lokal e kombëtar.



KOMPETENCA SPECIFIKE PËR BASHKËPUNËTOR PROFESIONAL-KËSHILLTAR PEDAGOG

I. PUNË ME NXËNËS

Nën-fusha: VËZHIM DHE MBËSHTETJE TË ZHVILLIMIT TË NXËNËSVE



KOMPETENCA TË BASHKËPUNËTORIT PROFESIONAL-KËSHILLTAR

1. Zhvillon programe për parandalimin dhe intervenim në raste krize të nxënësve.



SHEMBUJ TË PRAKTIKËS PROFESIONALE



- Merr pjesë në përpilimin e dokumenteve strategjike në nivel kombëtar për intervenim në situata krize të nxënësve.
- Punon me ekipe në nivel kombëtar për dallimin dhe parandalimin e situatave të krizës të nxënësve dhe dhënien e mbështetjes.

II. PUNË ME ARSIMTARË

Nën-fusha: MBËSHTETJE E ARSIMTARËVE GJATË PLANIFIKIMIT DHE REALIZIMIT TË PROCESIT EDUKATIVO-ARSIMOR DHE VETËVLERËSIMIT

PEDAGOGU... 

KOMPETENCA TË BASHKËPUNËTORIT PROFESIONAL-KËSHILLTAR

1. Avanco vlerësimin kombëtar.



SHEMBUJ TË PRAKTIKËS PROFESIONALE

- Merr pjesë në ekipe për përpilimin e testeve të standardizuara të njohurisë.
- Merr pjesë në përpilimin e dokumenteve për vlerësime eksterne kombëtare.



II. PUNË ME ARSIMTARË

Nën-fusha: MBËSHTETJE E ARSIMTARËVE GJATË PUNËS ME NXËNËS

PEDAGOGU... 

KOMPETENCA TË BASHKËPUNËTORIT PROFESIONAL-KËSHILLTAR

1. Merr pjesë në ndryshime sistimore në përshtatjen e mënyrës së punës së arsimtarëve ndaj nevojave dhe mundësive të nxënësve me nevoja të posaçme arsimore.



SHEMBUJ TË PRAKTIKËS PROFESIONALE

- Është anëtar i ekipeve profesionale për krijimin e qasjeve për punë me nxënës të talentuar.
- Është autor/bashkautor i doracakëve për punë me nxënës me nevoja të posaçme arsimore (nxënës të talentuar, nxënës me pengesa në zhvillim, të deprivuar në aspektin social, vështirësi specifike në nxënie, etj.).



KOMPETENCA SPECIFIKE PËR BASHKËPUNËTOR PROFESIONAL-KËSHILLTAR PSIKOLOG

I. PUNË ME NXËNËS

Nën-fusha: MBËSHTETJE E NXËNËSVE GJATË NXËNIES



KOMPETENCA TË BASHKËPUNËTORIT PROFESIONAL-KËSHILLTAR

1. Zhvillon sistem për punë me nxënës të talentuar.



SHEMBUJ TË PRAKTIKËS PROFESIONALE



- Realizon aktivitete për dallim, mbështetje dhe zhvillim të nxënësve të talentuar në bashkësi.
- Merr pjesë në përpilimin dhe realizimin e programit për punë me nxënës të talentuar në nivel lokal.
- Merr pjesë në përpilimin e dokumenteve programore dhe strategjike në nivel kombëtar për punë me nxënës të talentuar.

I. PUNË ME NXËNËS

Nën-fusha: VËZHGIM DHE MBËSHTETJE TË ZHVILLIMIT TË NXËNËSVE



KOMPETENCA TË BASHKËPUNËTORIT PROFESIONAL-KËSHILLTAR

1. Zhvillon programe për parandalimin dhe intervenim në situata krize të nxënësve.



SHEMBUJ TË PRAKTIKËS PROFESIONALE



- Merr pjesë në përpilimin e dokumenteve strategjike në nivel kombëtar për intervenim në situata krize të nxënësve.
- Punon me ekipe në nivel nacional për dallimin dhe parandalimin e situatave të krizës të nxënësve dhe dhënien e mbështetjes.

II. PUNË ME ARSIMTARË

Nën-fusha: MBËSHTETJE E ARSIMTARËVE GJATË PLANIFIKIMIT DHE REALIZIMIT TË PROCESIT EDUKATIVO-ARSIMOR DHE VETËVLERËSIMIT



KOMPETENCA TË BASHKËPUNËTORIT PROFESIONAL-KËSHILLTAR

1. Avanco vlerësimin kombëtar.



SHEMBUJ TË PRAKTIKËS PROFESIONALE



- Merr pjesë në ekipe për përpilimin e testeve të standardizuara të njohurisë.
- Merr pjesë në përpilimin e dokumenteve për vlerësime eksterne kombëtare.

II. PUNË ME ARSIMTARË

Nën-fusha: MBËSHTETJE E ARSIMTARËVE GJATË PUNËS ME NXËNËS



KOMPETENCA TË BASHKËPUNËTORIT PROFESIONAL-KËSHILLTAR

1. Merr pjesë në ndryshime sistemore në përshtatjen e mënyrës së punës së arsimtarëve ndaj nevojave dhe mundësive të nxënësve me nevoja të posaçme arsimore.



SHEMBUJ TË PRAKTIKËS PROFESIONALE



- Është anëtar i ekipeve profesionale për krijimin e qasjeve për punë me nxënës të talentuar.
- Është autor/bashkautor i doracakëve për punë me nxënës me nevoja të posaçme arsimore (nxënës të talentuar, nxënës me pengesa në zhvillim, të deprimuar në aspektin social, vështirësi specifike në nxënie, etj.).



KOMPETENCA SPECIFIKE PËR BASHKËPUNËTOR PROFESIONAL-KËSHILLTAR SOCIOLOG

I. PUNË ME NXËNËS

Nën-fusha: VËZHGIM DHE MBËSHTETJE TË ZHVILLIMIT TË NXËNËSVE



KOMPETENCA TË BASHKËPUNËTORIT PROFESIONAL-KËSHILLTAR

1. Zhvillon programe për parandalimin dhe intervenim në situata krize të nxënësve.



SHEMBUJ TË PRAKTIKËS PROFESIONALE



- Merr pjesë në përpilimin e dokumenteve strategjike në nivel kombëtar për intervenim në situata krize të nxënësve.
- Punon me ekipe në nivel kombëtar për dallimin dhe parandalimin e situatave të krizës të nxënësve dhe dhënien e mbështetjes.

KOMPETENCA SPECIFIKE PËR BASHKËPUNËTOR PROFESIONAL-KËSHILLTAR DEFEKTOLOG

I. PUNË ME NXËNËS

Nën-fusha: MBËSHTETJE E NXËNËSVE GJATË NXËNIES



KOMPETENCA TË BASHKËPUNËTORIT PROFESIONAL-KËSHILLTAR

1. Zhvillon sistem për punë me nxënës me nevoja të posaçme arsimore.



SHEMBUJ TË PRAKTIKËS PROFESIONALE



- Realizon aktivitete për dallimin, mbështetjen e nxënësve me nevoja të posaçme arsimore në bashkësi.
- Merr pjesë në përpilimin e dokumenteve programore, strategjike, rregulloreve për punë me nxënës me nevoja të posaçme arsimore.

II. PUNË ME ARSIMITARË

Nën-fusha: MBËSHTETJE E ARSIMITARËVE GJATË PLANIFIKIMIT DHE REALIZIMIT TË PROCESIT EDUKATIVO-ARSIMOR DHE VETËVLERËSIMIT

DEFEKTOLOGU... 

KOMPETENCA TË BASHKËPUNËTORIT PROFESIONAL-KËSHILLTAR

1. Avanco vlerësimin kombëtar.



SHEMBUJ TË PRAKTIKËS PROFESIONALE

- Merr pjesë në ekipe për përpilimin e testeve të standardizuara të njohurisë.



II. PUNË ME ARSIMITARË

Nën-fusha: MBËSHTETJE E ARSIMITARËVE GJATË PUNËS ME NXËNËS

DEFEKTOLOGU... 

KOMPETENCA TË BASHKËPUNËTORIT PROFESIONAL-KËSHILLTAR

1. Merr pjesë në ndryshime sistemore në përshtatjen e mënyrës së punës së arsimtarëve me nxënësit me nevoja të posaçme arsimore dhe vështirësi specifike në nxënie.



SHEMBUJ TË PRAKTIKËS PROFESIONALE

- Është autor/bashkautor i doracakëve për punë me nxënës me nevoja të posaçme arsimore dhe vështirësi specifike në nxënie.
- Merr pjesë në përpilimin e procedurave për punë të arsimtarëve me nxënës me nevoja të posaçme arsimore dhe vështirësi specifike në nxënie.



KOMPETENCA SPECIFIKE PËR BASHKËPUNËTOR PROFESIONAL-KËSHILLTAR BIBLIOTEKIST

I. PUNË ME NXËNËS

Nën-fusha: MBËSHTETJE E NXËNËSVE GJATË NXËNIES

BIBLIOTEKISTI...



KOMPETENCA PROFESIONALE

1. Promovon qasje bashkëkohore për shfrytëzimin e bibliotekës si qendër për nxënie para bashkësisë më të gjerë profesionale.
2. Promovon përmirësim të politikave, qasjeve dhe metodave për nxënie efektive në bibliotekë të rezultuara nga hulumtimet dhe/ose të kontrolluara në praktikë.



SHEMBUJ TË PRAKTIKËS PROFESIONALE



- Hulumton, përshtatë dhe zhvillon qasje për mbështetje në nxënien e nxënësve në bibliotekë.
- Vlerëson efektivitetin e intervenimeve individuale dhe sistemore në mënyrën e shfrytëzimit të bibliotekës.
- Publikon shembuj nga praktika personale dhe hulumtimet në revista profesionale ose të publikuara në faqe zyrtare (të recensuara) të internetit.
- Merr pjesë në ekipe për zhvillimin e qasjeve dhe metodave për nxënie efektive.
- Merr pjesë në hulumtim për vlerësim/evalvim të qasjeve dhe programeve të pranuar për nxënie efektive.
- Prezanton të dhëna nga hulumtimet në tubime profesionale, në libra, publikime, artikuj, revista profesionale, doracakë, etj.

IV. BASHKËPUNIM ME BASHKËSINË

Nën-fusha: BASHKËPUNIM ME INSTITUCIONE DHE ORGANIZATA PROFESIONALE

BIBLIOTEKISTI...



KOMPETENCA PROFESIONALE

1. Identifikon fusha dhe mënyra të reja për bashkëpunim me bashkësinë dhe merr përsipër rolin udhëheqës në implementimin e tyre.
2. Kontribuon për zhvillimin dhe evalvimin (vlerësimin) e intervenimeve/ndryshimeve sistemore në shkollë, komunë ose rajon.



SHEMBUJ TË PRAKTIKËS PROFESIONALE

- Inicion, përpilon dhe organizon projekte me bashkësinë lokale për përmirësimin e të arriturave të nxënësve dhe jetës në bashkësi.
- Ndërton strategji dhe e promovon punën e shkollës dhe të arriturat e nxënësve në bashkësinë më të gjerë.
- Organizon dhe mban seminare, tribuna, punëtori për avancimin e marrëdhënieve partnere ndërmjet shkollave dhe institucioneve nga bashkësia.
- Vlerëson efikasitetin e programeve kombëtare dhe i modifikon në bazë të njohurive.
- Zbaton intervenime/ndryshime sistemore në shkollë dhe/ose komunë/qytet.
- Vlerëson efektet e aktiviteteve të ndërmarra.



V. ZHVILLIM PROFESIONAL DHE BASHKËPUNIM PROFESIONAL

Nën-fusha: ZHVILLIM PERSONAL PROFESIONAL

BIBLIOTEKISTI...



KOMPETENCA PROFESIONALE

1. Zhvillon në mënyrë permanente njohuritë personale shkencore dhe profesionale.



SHEMBUJ TË PRAKTIKËS PROFESIONALE

- Zhvillohet në aspektin profesional në tituj shkencor. (specializim/magjistraturë/doktoratë).
- Shfrytëzon forma të ndryshme të zhvillimit joformal profesional për risi në profesion.
- Merr pjesë në tubime profesionale kombëtare dhe ndërkombëtare.
- Merr pjesë në udhëtime profesionale dhe studimore.



V. ZHVILLIM PROFESIONAL DHE BASHKËPUNIM PROFESIONAL

Nën-fusha: MBËSHTETJE E ZHVILLIMIT
DHE BASHKËPUNIMIT PROFESIONAL NË SHKOLLË

BIBLIOTEKISTI...



KOMPETENCA PROFESIONALE

1. Inicion bashkëpunim me bibliotekistë nga shkollat tjera për shkëmbimin e njohurive për avancimin e punës.
2. Kontribuon për zhvillimin profesional të kolegëve – bibliotekistë.



SHEMBUJ TË PRAKTIKËS PROFESIONALE



- Merr pjesë në ekipe/seksione/aktive rajonale të bibliotekistëve.
- Praktikrat e suksesshme personale i shkëmben me kolegët në funksion të zhvillimit të tyre profesional.
- Administron ueb-faqe/blog personal për shkëmbimin e informacioneve dhe përvojave nga profesioni.
- Inicion bashkëpunim rajonal/kombëtar të bashkëpunëtorëve profesional.
- Është realizues i trajnimeve, punëtorive, konsultimeve për kolegët bashkëpunëtorë profesional në nivel kombëtar.
- Informon dhe nxitë kolegët për shfrytëzimin e mundësive për nxënie dhe zhvillim profesional.
- Udhëheqë punën e seksioneve dhe/ose shoqatave të bashkëpunëtorëve profesional në nivel rajonal dhe shtetëror.

VII. STRUKTURË, ORGANIZIM DHE KLIMË SHKOLLORE

Nën-fusha: STRUKTURË DHE ORGANIZIM I SHKOLLËS

BIBLIOTEKISTI...



KOMPETENCA PROFESIONALE

1. Analizon dhe përpilon dokumente konceptuale dhe strategjike në arsim.
2. Zhvillon projekte për avancimin e punës edukativo-arsimore në nivel rajonal dhe kombëtar.
3. Nxitë, planifikon dhe organizon rrjetëzimin e bibliotekave shkollore dhe të tjera.





SHEMBUJ TË PRAKTIKËS PROFESIONALE

- Koordinon iniciativa në shkollë për përmirësimin e plan-programeve mësimore.
- Është anëtar i ekipeve për përgatitjen e dokumenteve konceptuese në arsim.
- Është autor / bashkëautor i analizës dhe vlerësimit të aspekteve të veçanta të sistemit arsimor në nivel kombëtar.
- Është anëtar i ekipit që udhëheqë projekte inovative në nivel kombëtarë.
- Prezanton përvoja nga inovacionet e zbatuara në literaturë profesionale, media, tubime profesionale, konferenca, seminare.
- Merr pjesë në projekte ndërkombëtare.
- Është autor/bashkautor i projekteve të aprovuara me të cilat avancohet puna edukativo-arsimore.
- Merr pjesë në zhvillimin e rrjeteve për shkëmbim të informacioneve dhe resurseve.
- Përpilon propozime, plane për rrjetëzim të shkollave në nivel të komunës.
- Bën analiza të bashkëpunimit ndërmjet bibliotekave shkollore dhe ofron propozime për përmirësim.





**KOMPETENCA
PROFESIONALE
për BASHKËPUNËTORË
PROFESIONAL
NË PROFESION
NË SHKOLLAT
E MESME**

PARATHËNIE

Kompetencat profesionale të bashkëpunëtorëve profesional i përpiloi grupi punues i përbërë prej përfaqësuesve të shkollave dhe Qendrës për Arsim Profesional dhe Trajnim. Gjatë përpilimit të tyre janë marrë parasysh *Kompetencat themelore profesionale të arsimtarëve dhe bashkëpunëtorëve profesional*.

Kompetencat profesionale të bashkëpunëtorëve profesional në profesion i përkufizojnë vlerat, njohuritë dhe shkathtësitë që ata duhet t'i posedojnë me qëllim që ta ushtrojnë me sukses detyrën e tyre. Të përshkruar janë kompetencat të cilat bashkëpunëtorët profesional në profesion duhet t'i posedojnë nga momenti i përfundimit të stazhit të fillestarit dhe pas dhënies së suksesshme të provimit profesional (të fillestarit), e deri në fund të stazhit të punës. Gjatë përcaktimit të tyre i kushtohet kujdes përfshijes së kompetencave që kanë të bëjnë me angazhimin e përgjithshëm profesional të bashkëpunëtorëve profesional në profesion – punë me nxënës, me arsimtarë dhe në shkollë në tërësi. Roli i bashkëpunëtorit profesional ishte shqyrtuar më së shumti nga aspekti i sigurimit të mbështetjes së arsimtarëve me qëllim të realizimit të suksesshëm të mësimdhënies, kurse të bashkëpunëtorët profesional që drejtpërdrejt punojnë me nxënës, është përfshirë edhe mbështetja gjatë nxënies dhe zhvillimit të nxënësve.

Gjatë përpilimit të kompetencave lindi ideja për punë ekipore ndërmjet arsimtarëve dhe bashkëpunëtorëve profesional në profesion.

Kompetencat e përgjithshme që janë të domosdoshme për shumicën e profesioneve në shekullin 21, si për shembull shfrytëzimi i teknologjisë informatike, njohja e gjuhëve të huaja, etj., nuk janë përmendur meqë pritet që bashkëpunëtorët profesional t'i posedojnë deri në nivelin që mundëson shfrytëzim në punën e përditshme.

Kompetencat profesionale që kanë të bëjnë me njohuri dhe shkathtësi profesionale janë të organizuara në katër fusha, ndërsa secila fushë përbëhet prej disa nën-fushave. Me këtë rast, disa kompetenca të caktuara mund të bëjnë pjesë në disa fusha. Në raste të tilla kompetenca

është e zhvendosur vetëm në një fushë, gjegjësisht, ajo që është përmendur një herë, nuk paraqitet sërish në ndonjë fushë tjetër.

Njohuritë dhe shkathtësitë profesionale dhe shembujt e aktiviteteve janë grupuar në fushat vijuese:

I. PUNË ME NXËNËS

- Mbështetje e nxënësve gjatë nxënies
- Vëzhgim dhe mbështetje të zhvillimit të nxënësve

II. PUNË ME ARSIMTARË

- Mbështetje e arsimtarëve gjatë planifikimit dhe realizimit të procesit edukativ-arsimor dhe vetëvlerësimit
- Mbështetje e arsimtarëve gjatë punës me nxënës

III. ZHVILLIM PROFESIONAL DHE BASHKËPUNIM PROFESIONAL

- Zhvillim personal profesional
- Mbështetje e zhvillimit dhe bashkëpunimit profesional në shkollë

IV. STRUKTURË, ORGANIZIM DHE KLIMË SHKOLLORE

- Strukturë dhe organizim shkollor klimë shkollore, mjedis i sigurt dhe pjesëmarrje demokratike

VLERA PROFESIONALE

SECILI NXËNËS MUND TË MËSOJË DHE TË ZHVILLOHET

Bashkëpunëtori profesional në profesion i përfshirë në mësimdhënie beson se, ndonëse nxënësit janë individë të veçantë dhe dallojnë sipas aftësive, qasjeve në nxënie, përvojave, interesave dhe motivimit, të gjithë mund të mësojnë dhe të zhvillohen. Është i bindur se potencialet e nxënësve do të zhvillohen, nëse nxënësit janë të motivuar që të bëjnë përpjekjen përkatëse, që do të rezultojë me ndjenjën e suksesit. Kjo do ta forcojë vetëbesimin dhe motivimin për nxënie. Konsideron se, nëse mësimdhënia u del në ndihmë interesave dhe nevojave të nxënësve dhe mundëson përvetësim të njohurive që janë relevante për ta, nxënësit do të mësojnë me kënaqësi dhe përkushtim dhe do të reflektojnë për potencialet e tyre si për diçka që mund të përmirësohet, ndërsa kjo do të ndihmojë që të zhvillohen si individë të suksesshëm dhe anëtarë të bashkësisë. Janë të bindur se qasja demokratike ndaj nxënësve do t'i nxisë nxënësit që te ata të shikojnë dikë që ofron ndihmë dhe mbështetje. Këto bindje veçanërisht duhet t'i manifestojnë bashkëpunëtorët profesional që drejtpërdrejt punojnë me nxënës.

PËRKUSHTIM NDAJ PROFESIONIT

Bashkëpunëtori profesional në profesion, ndonëse nuk është kryesisht i përgatitur për punë në arsim e do këtë profesion, dëshiron të punojë me të rinj, beson në mundësitë e tyre dhe u gëzohet sukseseve që ata i arrijnë. Është i bindur se ai nuk është vetëm bashkëpunëtor i arsimtarit, por duhet të tregojë kujdes për nxënien dhe zhvillimin e nxënësve, të jetë i hapur për komunikim dhe ndihmë dhe t'u japë mbështetje kur ajo u nevojitet. Beson se profesioni që e ushtron është i rëndësishëm jo vetëm për nxënësit, por edhe për shoqërinë dhe beson se ndryshimet pozitive të nxënësit shpijnë drejt ndryshimeve pozitive në shoqëri si tërësi. Konsideron se pa marrë parasysh se sa është diçka mirë, gjithmonë mund të jetë

edhe më mirë, ndaj për këtë arsye sfidat në profesion i shikon si mundësi për përmirësimin e mësimeve dhe praktikave.

BASHKËPUNIM

Bashkëpunëtori profesional konsideron se për nxënie dhe zhvillim të suksesshëm të nxënësit është me rëndësi që të vendoset marrëdhënie partnere e të gjithëve në shkollë. Ai dhe arsimtarët do të ndajnë qëllime të njëjta për nxënien e nxënësve, do të shkëmbejnë informacione, do të mbështetet në respektin dhe besimin e ndërsjellë. Është i bindur se përmes bashkëpunimit profesional me kolegët mund të kontribuojë për të arritura më të larta të nxënësve, afirmim të shkollës.

BARAZI, INKLuzion (PËRFSHIRJE) DHE DREJTËSI SOCIALE

Bashkëpunëtori profesional është i ndjeshëm ndaj diversiteteve të nxënësit dhe tregon gatishmëri që t'i pranojë nxënësit si individë të veçantë, të ndryshëm prej tjerëve, pa marrë parasysh aftësitë e tyre. Beson se nxënësit do të duan të mësojnë dhe do të duan profesionin për të cilin aftësohem nëse ndjehen të pranuar nga të gjithë dhe prandaj synon të krijojë mjedis në të cilin çdo diversitet pranohet dhe respektohet. Konsideron se dokumentet për të drejtat e njeriut dhe fëmijëve dhe kundër diskriminimit, si dhe parimet e drejtësisë sociale, duhet të zbatohen në përpikshmëri në përditshmëri dhe këtë e tregon përmes marrjes së vendimeve të drejta dhe korrekte.

I . PUNË ME NXËNËS

BASHKËPUNËTORI PROFESIONAL NË PROFESION i cili është i përfshirë në mësimdhënie u ofron mbështetje nxënësve në zhvillimin e shkathtësive për shfrytëzimin e suksesshëm të pajisjes dhe aparaturës bashkëkohore, shfrytëzimin në mënyrë përkatëse të resurseve në laborator, kabinete ose punëtori për mësim praktik. Është veçanërisht e rëndësishme që përmes qasjes individuale të punës së bashkëpunëtorit profesional në profesion t'i motivojë nxënësit për arritjen e rezultateve më të mira.

Bashkëpunëtori profesional në profesion kontribuon përmes asistimit gjatë realizimit të veprimeve dhe procedurave gjatë mësimit praktik dhe përmes komunikimit me arsimtarin e lëndës profesionale, sugjeron shfrytëzimin e pajisjes përkatëse dhe mjeteve për mbrojtje.

Është veçanërisht e rëndësishme që bashkëpunëtori profesional në profesion të mbajë portofol përkatës për nxënësit.

I. PUNË ME NXËNËS

Nën-fusha: MBËSHTETJE E NXËNËSVE
GJATË NXËNIES¹²

BASHKËPUNËTORI PROFESIONAL NË PROFESION...



A. KUPTIME DHE NJOHURI PROFESIONALE	B. AFTËSI DHE SHKATHTËSI PROFESIONALE
1. Njeh konceptet për zhvillimin kognitiv të nxënësit.	1.1 Vlerëson gatishmërinë e nxënësve për përfshirje në punën me pajisje dhe aparaturë bashkëkohore që janë pjesë përbërëse e laboratorit, kabinetit ose punëtorisë për realizimin e mësimit praktik dhe vëzhgimit përkatës të tij.
2. Njeh strategji themelore për nxënie, me resurse përkatëse mësimore, që i zhvillojnë shkathtësitë nga fusha e mësimit praktik, në përputhje me karakteristikat individuale.	2.1 Dallon nevoja të ndryshme arsimore të nxënësve. 2.2 Ofron mbështetje gjatë punës me resurse përkatëse mësimore për realizimin e mësimit praktik.
3. Njeh metoda dhe teknika për punë me nxënës dhe udhëzimin e tyre të suksesshëm për punë me resurse përkatëse mësimore gjatë procesit të mësimit praktik.	3.1 Harmonizon nevojat specifike të nxënësve në procesin e realizimit të mësimit praktik. 3.2 Dallon teknologjitë e reja përkatëse për realizimin e procesit të mësimit praktik.
4. Njeh faktorë që e motivojnë nxënësin për punë me resurse përkatëse mësimore gjatë procesit të zhvillimit të shkathtësive.	4.1 Ndërton qëndrim pozitiv për punë me resurse përkatëse mësimore në procesin e zhvillimit të shkathtësive.
5. Njeh parime themelore të arsimit inkuziv (përfshirës).	5.1 Dallon nevojën e qasjes përkatëse për inkluzion (përfshirje).
6. Njeh modele dhe forma për kapëlimin e detyrave të punës për mësim praktik.	6.1 Organizon aktivitete për sqarimin e detyrave nga mësimi praktik në bashkëpunim me arsimtarin e lëndës praktike.
7. Di të mbajë evidencë për përparimin e nxënësit pas realizimit të procesit të mësimit praktik.	7.1 Vlerëson dhe evidenton suksesin e punës së nxënësit.



¹¹ Nën-fusha ka të bëjë me punëtorë profesional që janë drejtpërdrejt të përfshirë në mësimdhënie.



SHEMBUJ TË PRAKTIKËS PROFESIONALE

- Shfrytëzon metoda përkatëse për përgatitjen e nxënësve gjatë përfshirjes në punë me pajisje dhe aparaturë bashkëkohore që janë pjesë përbërëse e laboratorit, kabinetit ose punëtorisë për realizimin e mësimit praktik.
- Demonstron veprime, procedura dhe procese me resurse përkatëse mësimore.
- Vëzhgon përparimin e nxënësve në mësimin praktik dhe u jep udhëzime përkatëse në përputhje me karakteristikat individuale.
- Udhëzon në mënyrë individuale dhe/ose grupe nxënësit se si të shfrytëzojnë teknika të ndryshme për punë me resurse përkatëse mësimore për zhvillimin e shkathhtësisë nga fusha përkatëse.
- Mundëson bashkëpunim efektiv me dhe mes nxënësve.
- Gjen mënyrë për prezantimin e teknologjive të reja aplikative për mësimit praktik.
- Realizon lloje të ndryshme të punës individuale dhe grupe, në bashkëpunim me arsimtarin e mësimit praktik.
- Nxitë dhe mbështetë paraqitjen e nxënësve në konkurse dhe gara.
- Zbaton qasje përkatëse me nxënësit me nevoja të posaçme arsimore.
- Përgatitë fleta mësimore me përmbajtje nga mësimit praktik, në bashkëpunim me arsimtarin e mësimit praktik.
- Zbaton metodë të demonstrimit të produktit të gatshëm dhe fazave të përpunimit të të njëjtit.
- Mban portofol për mësimit praktik .

I. PUNË ME NXËNËS

Nën-fusha: VËZHIM DHE MBËSHTETJE TË ZHVILLIMIT TË NXËNËSVE

BASHKËPUNËTORI PROFESIONAL NË PROFESION...




A. KUPTIME DHE NJOHURI PROFESIONALE	B. AFTËSI DHE SHKATHTËSI PROFESIONALE
1. Njeh parime të punës në laborator, kabinet dhe punëtori për mësimit praktik. 2. E di punën dhe rëndësinë e pajisjesve dhe aparaturës bashkëkohore që janë pjesë përbërëse e laboratorit, kabinetit ose punëtorisë për realizimin e mësimit praktik.	1.1 Është i aftësuar të demonstrojë punën në laborator me zbatimin e parimeve dhe metodave themelore të mbrojtjes dhe vetëmbrojtjes. 1.2 Zbaton parime dhe metoda themelore të mbrojtjes dhe vetëmbrojtjes gjatë punës në laborator, kabinet dhe punëtori për mësimit praktik. 2.1 Identifikon pjesë përbërëse, sqaron karakteristikat dhe përdorimin e pajisjesve dhe aparaturës, sqaron procesin e punës. 2.2 Kujdeset për mirëmbajtjen dhe përdorimin e drejtë të pajisjesve dhe aparaturës.
KOMPETENCA SPECIFIKE PËR BASHKËPUNËTORËT PROFESIONAL TË PËRFSHIRË NË MËSIMDHËNIE	
3. Dallon sfida në komunikim dhe bashkëpunim me pjesëtarë të kulturave të ndryshme, me vlera dhe përvoja të ndryshme.	3.1 Komunikon me nxënësit dhe arsimtarët në mënyrën që siguron mbështetje dhe besim. 3.2 Komunikon me respekt dhe vëmendje, duke promovuar vlerat, qëndrimet dhe sjelljet pozitive.





SHEMBUJ TË PRAKTIKËS PROFESIONALE

- Asiston në realizimin e veprimeve dhe procedurave gjatë realizimit të mësimit praktik.
- Sugjeron shfrytëzimin e pajisjesve dhe mjeteve përkatëse për mbrojtje dhe vetëmbrojtje të makro dhe mikro mjedisit.
- Shfrytëzon mjete të ndryshme mësimore për njoftimin e nxënësve me pjesët themelore dhe karakteristikat e pajisjeve dhe aparaturës.
- Demonstron procesin e punës me pajisje dhe aparaturë.
- Realizon procedura për mirëmbajtjen dhe përdorimin e drejtë të pajisjeve, aparaturës dhe makinave.
- Praktikon mekanizma që i mundësojnë nxënësit të zhvillojë besim dhe të fitojë mbështetje.
- Dëgjon dhe respekton në mënyrë aktive qëndrimet, mendimet dhe interesat e nxënësve.
- Shfrytëzon qasje të ndryshme në komunikimin individual dhe grupor me nxënësit.
- Komunikon me arsimtarin profesional si pjesë e ekipit për mësim praktik.



II. PUNË ME ARSIMTARË

BASHKËPUNËTORI PROFESIONAL NË PROFESION është mirë që nga njëra anë t'i njih planet dhe programet mësimore për mësim praktik, e nga ana tjetër të ketë informacione të mjaftueshme për resurset në dispozicion për realizimin e mësimi praktik. Kjo i mundëson që në punën me arsimtarët t'i japë mbështetje në përzgjedhjen e mënyrave dhe ideve për shfrytëzimin e resurseve relevante për realizimin e mësimi praktik.

Bashkëpunëtori profesional në profesion i cili është drejtpërdrejt i përfshirë në mësim e vëzhgon komunikimin në klasë dhe i jep informacion kthyes arsimtarit.

II. PUNË ME ARSIMTARË

Nën-fusha: MBËSHTETJE E ARSIMTARËVE GJATË PLANIFIKIMIT DHE REALIZIMIT TË PROCESIT EDUKATIVO-ARSIMOR DHE VETËVLERËSIMIT

BASHKËPUNËTORI PROFESIONAL NË PROFESION...




A. KUPTIME DHE NJOHURI PROFESIONALE	B. AFTËSI DHE SHKATHTËSI PROFESIONALE
<ol style="list-style-type: none"> 1. Njeh planet dhe programet mësimore për profesionin në arsimin në të cilin punon. 2. Njeh karakteristikat dhe dedikimin e resurseve mësimore¹³ të nevojshme për realizimin e mësimit praktik. 3. Njeh burime të ndryshme të materialeve dhe teknologjive të reja të nevojshme për realizimin e mësimit praktik. 4. Ka njohuri nga furnizimi dhe mbajtja e evidencës për resurse të nevojshme dhe të shpenzuara mësimore për realizimin e programit të mësimit praktik. 	<ol style="list-style-type: none"> 1.1 Identifikon planin dhe programin mësimor për mësimit praktik për profilin arsimor për të cilin realizon mësimit praktik. 2.1 Përcakton resurset në dispozicion në laborator, kabinet, punëtori varësisht nga qëllimet e programeve mësimore të mësimit praktik. 2.2 Identifikon resurset mësimore sipas karakteristikave të tyre. 2.3 Shfrytëzon në mënyrë të drejtë resurset mësimore. 3.1 Kërkon dhe vëzhgon risi në teknologji karakteristike për profesionin për përmirësimin e mësimit praktik. 3.2 Informon arsimtarët për burimet e ndryshme të materialeve dhe teknologjive. 4.1 Bën furnizimin e resurseve të nevojshme mësimore për realizimin e programit të mësimit praktik.
KOMPETENCA SPECIFIKE PËR BASHKËPUNËTORËT PROFESIONAL TË PËRFSHIRË NË MËSIMDHËNIE	
<ol style="list-style-type: none"> 5. Kupton veçorinë /individualitetin e nxënësve. 6. Njeh parime të vendosjes së klimës pozitive socio-emocionale në laborator, në kabinet dhe punëtori për mësimit praktik. 	<ol style="list-style-type: none"> 5.1 Respekton veçoritë/individualitetin e secilit nxënës dhe i ndërlikohet nevojat e tij me mënyrat përkatëse për zhvillimin e shkathtësive. 6.1 Kontribuon gjatë vendosjes së klimës pozitive socio-emocionale në laborator, në kabinet dhe punëtori për mësimit praktik.

¹² Me resurse nënkuptohen: substanca, inventar laboratorik, reagensë, instrumente, prova për analiza, aparate dhe ngjashëm



SHEMBUJ TË PRAKTIKËS PROFESIONALE

- Harton plan javor dhe ditor për punë dhe organizon lloje të ndryshme të aktiviteteve për zhvillimin e shkathtësive të nxënësve në bashkëpunim me kuadrin mësimor.
- Organizon punën në përputhje me programin mësimor përmes planifikimit ditor dhe javor të punës.
- Bën përzgjedhjen e resurseve mësimore të nevojshme për realizimin e programit të mëimit praktik.
- Ndhmon në përzgjedhjen e resurseve përkatëse mësimore për realizimin e programit të mëimit praktik në bazë të planit ditor dhe javor për punë /ndihmon në përzgjedhjen e resurseve përkatëse mësimore për realizimin e detyrave konkrete praktike.
- Shpërndan resurse përkatëse mësimore sipas vendeve të punës.
- Tregon mënyrat e përzgjedhjes dhe shfrytëzimit të burimeve të ndryshme të materialeve dhe teknologjive.
- Informon arsimtarët për të arriturat e reja tekniko-teknologjike për realizimin e suksesshëm të programeve mësimore.
- Përpilon listë të resurseve të nevojshme për realizimin e programit të mëimit praktik në bashkëpunim me arsimtarin.
- Bën sigurimin /pranimin e resurseve të nevojshme mësimore që nevojiten për realizimin e programit të mëimit praktik.
- Mban evidencë të përditshme (aktuale) të resurseve të nevojshme mësimore për realizimin e mëimit praktik.
- Plotëson lista dhe kartonë regjistrimi për resurse të nevojshme dhe të harxuara mësimore.
- U propozon arsimtarëve resurse përkatëse të nevojshme për nxënës duke përfshirë edhe nxënësit me nevoja të posaçme arsimore.
- Ndhmon arsimtarët gjatë përzgjedhjes së resurseve mësimore varësisht nga nevojat specifike të nxënësve.
- U del në ndihmë kërkesave dhe nevojave specifike të nxënësve.
- Vëzhgon sjelljen e nxënësve të paraleles gjatë mëimit praktik dhe pushimit dhe i jep informacion kthyes arsimtarit për përmirësimin e klimës socio-emocionale në punëtori/laborator/kabinet.



II. PUNË ME ARSIMTARË

Nën-fusha: MBËSHETJE E ARSIMTARËVE
GJATË PUNËS ME NXËNËS⁴

BASHKËPUNËTORI PROFESIONAL NË PROFESION...



A. KUPTIME DHE NJOHURI PROFESIONALE	B. AFTËSI DHE SHKATHTËSI PROFESIONALE
1. Njeh mënyra të punës me nxënës përmes shfrytëzimit të resurseve të ndryshme mësimore.	1.1 Shfrytëzon aftësitë dhe afinitetet e nxënësve përmes përzgjedhjes së resurseve përkatëse mësimore.
2. Njeh ndikimin e faktorëve social dhe kulturor në arsim.	2.1 Promovon respektimin e dallimeve dhe vlerave demokratike. 2.2 Angazhohet për respektimin e personalitetit të secilit nxënës.
3. Njeh parimet e komunikimit të mirë në mes nxënësve dhe arsimtarëve dhe nxënësve mes vete.	3.1 U jep mbështetje arsimtarëve për vendosjen e komunikimit më të mirë mes nxënësve dhe arsimtarëve dhe nxënësve mes vete.
4. Njeh rregulla për siguri gjatë punës.	4.1 Zbaton rregulla për siguri gjatë punës në punëtori/laborator. 4.2 U ofron mbështetje përkatëse nxënësve për mbrojtje gjatë punës dhe përdorim të mjeteve dhe pajisjeve mbrojtëse.
5. Njeh rreziqet gjatë punës dhe mjetet dhe pajisjet mbrojtëse.	



SHEMBUJ TË PRAKTIKËS PROFESIONALE



- Demonstron mënyrën e shfrytëzimit të drejtë të resurseve mësimore.
- Intervenon në rast të shfrytëzimit të padrejtë të resurseve mësimore.
- Identifikon nxënës me aftësi të ndryshme të shfrytëzimit dhe manipulimit me resurse mësimore.
- I sugjeron arsimtarit mënyra për zhvillimin e aftësive të nxënësve dhe për motivimin e nxënësve për pjesëmarrje në gara dhe konkurse të karaktereve të ndryshme.
- Përfshin mënyra të reja të punës dhe bashkëpunimit me arsimtarët dhe me nxënësit.
- Ndihmon arsimtarin gjatë punës në kuadër të grupit dhe individualisht me nxënës që kanë faktorë të ndryshëm kulturor dhe social.
- Ndihmon arsimtarin në procedurat për përgatitje dhe punë në paralele në të cilën ka nxënës të kategorive të ndryshme.
- Gjatë formimit të grupit punues, organizon nëngrupe me nxënës me dallime kulturore dhe sociale (grupe të përziera).
- Paraqet model pozitiv për arsimtarët në zbatimin e shkathtësive komunikuese.
- Këshillon arsimtarët për komunikim me një grup të caktuar të nxënësve.
- Përcjellë komunikimin në punëtori, laborator, klasë dhe i jep informacion kthyes arsimtarit.
- Njofton nxënësit me rregullat e sigurisë gjatë punës në punëtori, laborator.
- Jep udhëzime për mbrojtje gjatë punës dhe demonstroi përdorimin e mjeteve dhe pajisjeve mbrojtëse.
- Intervenon në rast të aksidentit.

¹³ Nën-fusha ka të bëjë me bashkëpunëtorët profesional të përfshirë në mësimdhënie

III. ZHVILLIM PROFESIONAL DHE BASHKËPUNIM PROFESIONAL

BASHKËPUNËTORI PROFESIONAL NË PROFESION në pjesën e bashkëpunimit profesional ka rol të rëndësishëm në pjesën e planifikimit dhe realizimit të mësimit praktik. Bashkëpunimi ka të bëjë me përzgjedhjen, përgatitjen e resurseve mësimore, si dhe mirëmbajtjen dhe shfrytëzimin përkatës të të njëjtave. Po ashtu, bashkëpunon me arsimtarin në pjesën e evidentimit dhe mbajtjes së evidencës për suksesin e nxënësve.

III. ZHVILLIM PROFESIONAL DHE BASHKËPUNIM PROFESIONAL

Nën-fusha: ZHVILLIM PERSONAL PROFESIONAL

BASHKËPUNËTORI PROFESIONAL NË PROFESION...



A. KUPTIME DHE NJOHURI PROFESIONALE	B. AFTËSI DHE SHKATHTËSI PROFESIONALE
1. Kupton ndërlikueshmërinë e profesionit bashkëpunëtor profesional në profesion dhe përgjegjësitë që i bartë ai.	1.1 Njohuritë e përvetësuara përmes zhvillim profesional (arsimit dhe mësimi formal, joformal dhe informal) mundësojnë zhvillim të aftësive dhe shkathtësive ekzistuese dhe përvetësim të aftësive dhe shkathtësive të reja të nevojshme për avancimin e punës personale.
2. Kupton rëndësinë e planifikimit të zhvillimit personal profesional.	2.1 Identifikon nevojat për zhvillim personal profesional duke shfrytëzuar kompetencat profesionale, rezultatet nga vetëreflektimi i punës personale, si dhe nevojat e rezultuara nga tendencat e reja të shkencës.
3. I di kompetencat e nevojshme profesionale për profilin e tij të bashkëpunëtorit profesional.	4.1 Përcakton format përkatëse të zhvillimit profesional për përmirësimin e praktikës personale të punës.
4. Njeh mënyrat dhe mundësitë efektive për zhvillim personal dhe profesional.	5.1 Bashkëpunon me bashkëpunëtorët profesional në profesionin përkatës.
5. Njeh burimet e marrjes së informacioneve të rëndësishme për profesionin (revista, etj.).	5.2 Shfrytëzon literaturë nga burime të ndryshme për avancimin e zhvillimit personal dhe profesional.
6. Njeh kodeksin etik të profesionit/shkollës.	6.1 Sillet në pajtim me kodeksin etik të profesionit.





SHEMBUJ TË PRAKTIKËS PROFESIONALE

- Bën vlerësimin e efikasitetit të punës personale.
- Përmirëson vazhdimisht udhëheqjen dhe organizimin e hapësirës së punës (laborator, punëtori, klasë e specializuar, etj.).
- Bën vetëvlerësimin e kompetencave personale dhe identifikon kompetencat e nevojshme për zhvillim të mëtejshëm profesional.
- Në bazë të vetëvlerësimit përpilon plan personal për zhvillim profesional.
- Realizon aktivitete, mban evidencë dhe posedon dëshmi (plan personal, certifikata, trajnime të ndjekura dhe realizuara, shënime nga vetëvlerësimi dhe ngjashëm) për zhvillimin personal profesional.
- Merr pjesë në forma të ndryshme grupore (trajnime, konferenca, seminare, etj.) dhe individuale (kërkim të literaturës, lexim të publikimeve profesionale, hulumtimet të internet resurseve të ndryshme, etj.) të zhvillimit profesional në dhe jashtë shkollës.
- Merr pjesë në aktivitete të ndryshme të shoqatave profesionale, rrjeteve sociale dhe forumeve me qëllim që të përmirësimin të punës së tij.
- Ndjekë informacionet që kanë të bëjnë me zhvillimin tekniko-teknologjik dhe tendencat e reja zhvillimore në shkencë, të rëndësishme për arsimin dhe realizimin e mësimit praktik.
- Zhvillohet vazhdimisht për instrumentet dhe aparatet e reja.
- Paraqet shembull (model) të sjelljes etike.

III. ZHVILLIM PROFESIONAL DHE BASHKËPUNIM PROFESIONAL

Nën-fusha: MBËSHTETJE E ZHVILLIMIT DHE BASHKËPUNIMIT PROFESIONAL NË SHKOLLË

BASHKËPUNËTORI PROFESIONAL NË PROFESION...




A. KUPTIME DHE NJOHURI PROFESIONALE	B. AFTËSI DHE SHKATHTËSI PROFESIONALE
1. Kupton rëndësinë e bashkëpunimit profesional në shkollë.	1.1 Vendosi raporte profesionale në punë.
2. Kupton rëndësinë e bashkëpunimit me arsimtarin dhe aktivin profesional në drejtim të ngritjes së cilësisë së mësimit praktik.	2.1 Shfrytëzon informacione dhe përvoja profesionale, si dhe shfrytëzon këshilla për përmirësimin e punës së tij dhe ngritjen e cilësisë së mësimit praktik.
3. Informohet për përmbajtjet mësimore që kanë të bëjnë me promovimin e resurseve që mund të shfrytëzohen në mësim.	3.1 Propozon resurse të reja (materiale, mjete, instrumente, etj.) në përputhje me zhvillimin tekniko-teknologjik dhe tendencat e reja në shkencë



SHEMBUJ TË PRAKTIKËS PROFESIONALE

- Bashkëpunon me drejtorin, bashkëpunëtorët profesional, arsimtarët, shërbimin profesional dhe të punësuarit tjerë për furnizim të materialeve.
- Bashkëpunon me arsimtarë gjatë planifikimit vjetor dhe tematik të mësimit praktik, me qëllim të realizimit të programit mësimor në mësimin praktik.
- Zbaton inovacione në punë me çka i nxitë dhe motivon arsimtarët.
- Bashkë me arsimtarët bën përzgjedhjen dhe përgatitjen e resurseve mësimore, i mirëmban dhe i shfrytëzon në mënyrë përkatëse.



IV. STRUKTURË, ORGANIZIM DHE KLIMË SHKOLLORE

BASHKËPUNËTORI PROFESIONAL NË PROFESION i di specifikat e mjedisit në të cilin gjendet shkolla, specifikat e nën-sistemit të arsimit në të cilin punon. Kontribuon në promovimin e shkollës, krijon atmosferë pozitive dhe të këndshme në shkollë, laborator, kabinete dhe punëtori për mësim praktik. Me sjelljen e tij shërben si shembull për respektim të rregullave të sigurisë në hapësirat e punës. Punon në mënyrë ekonomike dhe ka në dispozicion resurse përkatëse mësimore.

IV. STRUKTURË, ORGANIZIM DHE KLIMË SHKOLLORE

Nën-fusha: STRUKTURË DHE ORGANIZIM SHKOLLOR KLIMË SHKOLLORE, MJEDIS I SIGURT DHE PJESËMARRJE DEMOKRATIKE

BASHKËPUNËTORI PROFESIONAL NË PROFESION...



A. KUPTIME DHE NJOHURI PROFESIONALE	B. AFTËSI DHE SHKATHTËSI PROFESIONALE
1. Njeh strukturën organizative në shkollë.	1.1 Udhëhiqet sipas parimeve të përgjithshme të sistemit të edukimit dhe arsimit.
2. Njeh lloje të ndryshme të materialeve dhe mjeteve për nxënie dhe për realizimin e planeve dhe programeve mësimore në shkollë.	2.1 Tregon burime për nxënie të formatit të ndryshëm dhe prej mediave të ndryshme.
3. E di se gjatë planifikimit të punës në shkollë duhet të merren parasysh kushtet specifike për punë.	3.1 Organizon ngjarje që kanë të bëjnë me punë në laborator, kabinet ose punëtori për realizimin e mësimit praktik.
4. Njeh metoda dhe mënyra të ndryshme të punës në laborator, kabinet ose punëtori për realizimin e mësimit praktik.	4.1 Di të tregojë mënyrën më adekuatë të shfrytëzimit të metodave gjatë punës në laborator, kabinet ose punëtori për realizimin e mësimit praktik.
5. Njeh mundësitë për shfrytëzimin e teknologjisë së ndryshme informative-komunikuese duke përfshirë edhe teknologjitë e reja.	5.1 Di të shfrytëzojë TIK-un për krijim, ruajtje, gjetje, shkëmbim dhe organizim të informacioneve dhe për komunikim.
6. I di dallimet mes njerëzve dhe mes bashkësive (kulturë, pamje fizike, etj.).	6.1 Promovon ndjeshmëri për pranimin e diversiteteve.
7. I di dhe kupton rregullat për realizimin e mësimit praktik.	7.1 Organizon qasje për realizimin e mësimit praktik.
8. E di rregulloren për siguri në laborator, kabinet ose punëtori për realizimin e mësimit praktik dhe e kupton rëndësinë nga vendosja e sistemit të sigurisë.	7.2 Siguron qasje deri te aparatura, makinat dhe materiali harxhues.
9. Kujdeset për mjedisin e punës.	7.3 Udhëzohet nxënësit se si të sillen në mënyrë të drejtë në laborator, kabinet ose punëtori për realizimin e mësimit praktik.
10. Kupton rëndësinë e sigurimit të atmosferës përkatëse dhe kushteve për shprehje të lirë konstruktive të mendimit të nxënësve për punë në laborator.	8.1 Siguron respektim të kodeksit të sjelljes në laborator, kabinet ose punëtori për realizimin e mësimit praktik.
11. Njeh parimet e komunikimit profesional dhe bashkëpunimit në shkollë.	9.1 Shfrytëzon me ndërgjegje burime të energjisë dhe resurse natyrore.
12. Zbaton standarde ekologjike në punë.	9.2 Kujdeset për kushtet e sigurisë në laborator, kabinet dhe/ose punëtori.
13. Mbështetë bashkëpunimin me prindër.	10.1 Nxitë atmosferë dhe kushte përkatëse për pjesëmarrje demokratike të nxënësve për punë në laborator, kabinate dhe punëtori.
	11.1 Kontribuon në krijimin e klimës së mbështetjes dhe bashkëpunimit.
	12.1 Kujdeset për mbrojtjen e mjedisit jetësor dhe kursimin e energjisë dhe resurseve.
KOMPETENCA SPECIFIKE PËR BASHKËPUNËTORËT PROFESIONAL TË PËRFSHIRË NË MËSIMDHËNIE	
13. Mbështetë bashkëpunimin me prindër.	13.1 Di të formulojë nivelet e ndryshme e të arriturave të nxënësit në mësimin praktik.



SHEMBUJ TË PRAKTIKËS PROFESIONALE

- Në procesin e mësimit praktik, funksionon si ekip me arsimtarin e lëndës profesionale.
- Rekomandon burime përkatëse të informacioneve në lidhje të ngushtë me mësimin praktik, në përputhje me programin mësimor.
- Konsultohet dhe pranon instruksione nga arsimtari i lëndës profesionale për llojet e materialeve dhe mjeteve për nxënie.
- Përfshihet në aktivitetet në nivel të laboratorit, kabinetit ose punëtorisë për realizimin e mësimit praktik.
- Merr pjesë në përpilimin e mjeteve të konkretizimit dhe materialeve promovuese për shkollën.
- Shfrytëzon TIK-un në punën e përditshme.
- Nxënësve ua tregon mundësitë për shfrytëzimin e mediave të ndryshme.
- Rregullon hapësirën e laboratorit, kabinetit ose punëtorisë për realizimin e mësimit praktik ashtu që i afron diversitetet.
- Organizon hapësirën e laboratorit që të jetë lehtë e arritshme për shfrytëzuesit në aspektin fizik.
- Siguron qasje deri te aparatura, makinat dhe materiali harxhues për njësi përkatëse tematike.
- Organizon materialet, makinat dhe aparaturën sipas procesit dhe metodave, nevojave të nxënësve dhe arsimtarit profesional.
- Njofton nxënësit me organizimin e hapësirës,
- Udhëzohet nxënësit se si dhe ku t'i gjejnë materialet e nevojshme.
- Punon në përputhje me rregullat për siguri në shkollë.
- Informon dhe insiston në respektimin e rregullave të sjelljes në laborator, kabinet ose punëtori për realizimin e mësimit praktik.
- Shërben si shembull për respektimin e rregullave të sigurisë.
- Shfrytëzon në mënyrë ekonomike burimet e energjisë (rrymën, flakët) dhe resurset tjera gjatë realizimit të mësimit praktik.
- Përcakton kushtet për realizimin e sigurt të mësimdhënies.
- Jep propozime për shfrytëzimin e mundësive të ndryshme për pjesëmarrjen e nxënësve në mësimin praktik.
- Merr pjesë dhe mbështetë aktivitetet për respekt të ndërsjellë.
- Merr pjesë në ekipe të ndryshme shkollë.
- Tregon respekt ndaj kolegëve dhe nxënësve.
- Merr pjesë në përpilimin e udhëzimeve për shfrytëzim racional të energjisë dhe resurseve.
- Kujdeset për deponimin, ruajtjen dhe mënjanimin e sigurt të mbeturinave.
- Merr pjesë në mbledhje prindërore të organizuara nga kujdestari i klasës me qëllim që t'i informojë për përparimin e nxënësit.

